



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 373 Akti

Nr. 369 Vendimi  
Tiranë, më 21.4.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Pamela Qirko</b>	Kryesuese
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datat 16.4.2021, ora 9:30 dhe 21.4.2021, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Gentiana Xhelili**, me funksion gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

## **TRUPI GJKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Gentiana Xhelili dhe pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

### **V Ë R E N:**

#### **I. RRETHANAT PROCEDURALE**

1. Znj. Gentiana Xhelili është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës Parë Vlorë, në momentin e shortimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar” dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Znj. Gentiana Xhelili, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit duke u shortuar në datën 15.12.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Pamela Qirko, Etleda Çiftja dhe Roland Ilia.

3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31–33 të ligjit nr. 84/2016, nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), sipas neneve 40 – 44 të ligjit nr. 84/2016.

4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni) me vendimin e datës 10.1.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues, komisioneren Pamela Qirko. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

5. Në datën 13.1.2020, me anë të postës elektronike<sup>1</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) fillimin e procesit të rivlerësimit; (ii) anëtarët e trupit gjykues të shortuar për të zhvilluar procesin e rivlerësimit; (iii) deklarin nëse ishte në kushtet e konfliktit të interesit me ndonjë nga anëtarët e trupit gjykues; si dhe (iv) përgjigjet e pyetjeve të pyetësorit standard, me qëllim përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave, që kanë lidhje me procedurat e rivlerësimit.

---

<sup>1</sup>E-mail, datë 13.1.2020, ora 16:48, “Komisioni – njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

6. Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit shtesë dërguar me *e-mail*-in më lart, me anë të postës elektronike<sup>2</sup> dërgoi përgjigje pyetësorit dhe dokumentacion bashkëlidhur.

7. Trupi gjykues, me vendimin nr. 2, datë 2.3.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin administrativ kryesisht për subjektin e rivlerësimit Gentiana Xhelili, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes, vetëm për kriterin e pasurisë; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 për kriterin e pasurisë; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, me të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

8. Në datën 2.3.2021, përmes postës elektronike<sup>3</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 15.3.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit për t'u njohur me dosjen e hetimit.

9. Në datën 4.3.2021, subjekti i rivlerësimit, përmes postës elektronike<sup>4</sup>, kërkoj kohë shtesë për të paraqitur shpjegimet dhe provat në mbështetje të barrës së provës, kaluar me relacionin mbi rezultatet e hetimit kryesisht, për faktin se kishte rezultuar pozitiv me COVID-19. Komisioni, bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, pranoj shtyrjen e afatit të dorëzimit të përgjigjeve deri në datën 24.3.2021.

10. Në datën 24.3.2021, subjekti i rivlerësimit, paraqiti shpjegimet dhe provat për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e pasurisë, duke paraqitur dhe kërkesën për çeljen e hetimit administrativ për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale.

11. Trupi gjykues, bazuar në kërkesën e subjektit të rivlerësimit, me anë të vendimit të datës 2.4.2021, vendosi përfundimin e hetimit kryesisht dhe për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale. Me anë të postës elektronike<sup>5</sup> në datën 2.4.2021, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht për kontrollin e figurës dhe vlerësimin profesional; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 9.4.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40, të Kodit të Procedurave Administrative. Subjekti i rivlerësimit nuk u paraqit për t'u njohur me dosjen e hetimit.

---

<sup>2</sup>*E-mail*, datë 30.1.2020.

<sup>3</sup>*E-mail*, datë 2.3.2021, ora 12:05, “Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

<sup>4</sup>*E-mail*, datë 4.3.2021, ora 9:25, Re: “Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit”.

<sup>5</sup>*E-mail*, datë 2.4.2021, ora 12:39 pm, “Njoftim mbi përfundimin e rezultateve të hetimit mbi figurën dhe profesionalizmin e subjektit”.

12. Në datën 9.4.2021, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike<sup>6</sup>, paraqiti shpjegimet dhe provat për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht për kriterin e kontrollit të figurës dhe vlerësimit profesional.

13. Në vendimin e datës 13.4.2021, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Gentiana Xhelili, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u njoftua përmes postës elektronike se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 16.4.2021, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, kati 0, Tiranë.

14. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gentiana Xhelili, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

15. Në datën 16.4.2021, ora 9:30, u zhvillua seanca dëgjimore në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

16. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

17. Subjekti i rivlerësimit, shprehu qëndrimin e tij, pasi dëgjoi relacionin, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer.

18. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, kërkoi konfirmimin në detyrë. Seanca u ndërpre për të rifilluar në datën 21.4.2021.

19. Në përfundim të seancës së datës 21.4.2021, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, në prani të subjektit të rivlerësimit, vendosi ta konsiderojë të përfunduar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Gentiana Xhelili, si dhe shpalli vendimin.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

20. Subjekti i rivlerësimit Gentiana Xhelili, ka qenë bashkëpunues gjatë procesit në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime

---

<sup>6</sup>E-mail, datë 9.4.2021, ora 14:54.

në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLGj-ja është organi përkatës i vlerësimit profesional, i cili përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pasi përfundon shqyrtimi i dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe përzgjedhja e pesë dokumenteve sipas një sistemi objektiv dhe rastësor.

22. Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>7</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. RIVLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

23. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2009 për herë të parë dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

23.1 Subjekti ka dorëzuar deklaratat e interesave private për vitet 2009 – 2016 dhe referuar ligjit nr. 84/2016 ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar, *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat e prindërve të bashkëshortit dhe për pagesën e tatimit në burim për të ardhurat nga qiradhënia;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

---

<sup>7</sup>Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

## **A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

24. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI për vitet 2009 – 2016 ; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklarimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit dhe, në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; (e) deklarimet e përfaqësueses ligjore me prokurë në seancë dëgjimore.

25. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar në pikën 5, të nenit 33, ligjit nr. 84/2016.

### **Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017 nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

#### **1. Kursime nga paga në vlerën 49.295,5 lekë, llogari në “Tirana Bank”**

26. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga (në llogarinë bankare me nr. \*\*\* në “Tirana Bank”), në emër të znj. Gentiana Xhelili në vlerën 49.295,5 lekë. Pjesa takuese: 50%.

27. Si burim krijimi subjekti deklaron kursimet nga paga. Për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>8</sup>.

28. **Faktet nga hetimi administrativ kryesisht** – referuar dokumentacionit të administruar nga “Tirana Bank”<sup>9</sup>, konfirmohet llogari page në emër të subjektit të rivlerësimit çelur në vitin 2014.

29. Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari kanë të bëjnë me të ardhurat nga pagat, duke filluar nga qershori i vitit 2014 dhe në vijim<sup>10</sup>. Subjekti nuk kryen depozitime në këtë llogari, por vetëm tërheqje. Shtesat dhe/ose pakësimet vjetore të kësaj llogarie janë reflektuar në analizën financiare.

---

<sup>8</sup>Vërtetim datë 23.1.2017, nga “Tirana Bank”, sipas të cilit gjendja e llogarisë së pagës së znj. Gentiana Xhelili, në datën 23.1.2017, është 49.295 lekë, nxjerrje llogarie datë 23.1.2017, në “Tirana Bank”, gjendja e llogarisë në datën 12.1.2017 është 49.295 lekë.

<sup>9</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.1.2020.

<sup>10</sup>Totali i pagave të kredituara në llogari ka qenë në shumën 2.560.892 lekë deri në fund të vitit 2016.

30. Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këtë llogari, nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

31. **Si konkluzion**, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari .

## **2. Kursime nga paga në vlerën 331,9 lekë, llogari në “Raiffeisen Bank”**

32. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga (në llogarinë bankare me nr. \*\*\* “Raiffeisen Bank”), në emër të znj. Gentiana Xhelili në vlerën 331,9 lekë. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi subjekti deklaroi kursimet nga paga. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>11</sup>.

33. **Faktet nga hetimi administrativ kryesisht** – referuar dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>12</sup>, konfirmohet se subjekti ka llogari “page” me gjendje në vlerën 331,9 lekë në datën 27.1.2017, çelur më 28.4.2006

34. Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari kanë të bëjnë me të ardhurat nga pagat<sup>13</sup>, Shkolla e Magjistraturës<sup>14</sup>, sigurimet<sup>15</sup>, depozitime nga të tretë për qiranë<sup>16</sup>, transferata nga shoqëria e sigurimeve INSIG<sup>17</sup>, si edhe disa depozitime në vlera të vogla<sup>18</sup>. Shtesat dhe/ose pakësimet vjetore të kësaj llogarie janë reflektuar në analizën financiare.

35. Nga hetimit administrativ kryesisht në lidhje me këtë llogari, nuk u konstatuan problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit të subjektit.

36. **Si konkluzion**, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari .

## **3. Kursime cash në vlerën 4.000 euro**

37. Në deklaratë *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime *cash* në vlerën 4.000 euro. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi subjekti deklaroi: (a) nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz”, blerë sipas kontratës nr. \*\*\*, datë 15.11.2011 dhe shitur ky automjet me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 5.12.2016, në vlerë 3.100 euro; dhe (b) nga shitja e automjetit me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 19.11.2013, të dhuruar nga Ambasada Belge në datën 25.11.2011, vërtetuar nga vërtetimi i Konsullatës Belge, S. \*\*\* Athinë, në vlerën 2.500 euro. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>19</sup>.

<sup>11</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, sipas të cilit gjendja e llogarisë rrjedhëse së znj. Gentiana Xhelili, në datën 23.1.2017 është 331,9 lekë, nxjerrje llogarie në “Raiffeisen Bank”, gjendja e llogarisë më 10.1.2017 është 331,9 lekë.

<sup>12</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020.

<sup>13</sup>Totali i pagave të kredituara në llogari ka qenë në shumën 4.327.531 lekë.

<sup>14</sup>Totali i të ardhurave të kredituara në llogari nga Shkolla e Magjistraturës ka qenë në shumën 998.799 lekë.

<sup>15</sup>Totali i të ardhurave të kredituara në llogari nga sigurimet ka qenë në shumën 347.545 lekë.

<sup>16</sup>Totali i depozitimeve në llogari nga të tretë ka qenë në shumën 218.800 lekë (trajtuar te të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë).

<sup>17</sup>Shuma 2.025.761 lekë e transferuar në shoqërinë e sigurimeve INSIG.

<sup>18</sup>Kryesisht depozitimet janë kryer përpara fillimit të detyrës e më tej janë kryer: (i) një depozitim në shumën 22.000 lekë gjatë vitit 2010; (ii) pesë depozitime në shumën totale 76.000 lekë gjatë vitit 2011 (njëri prej tyre në shumën 2.00 lekë depozituar nga motra e subjektit); (iii) një depozitim në shumën 2.500 lekë nga motra e subjektit në vitin 2012; (iv) një depozitim në shumën 20.000 lekë gjatë vitit 2014.

<sup>19</sup>Kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\*, datë 5.12.2016, me palë shitëse A.Rr., dhe palë blerëse E.A., kontratë shitjeje nr. \*\*\*, datë 15.11.2011, me palë shitëse D.F., dhe palë blerëse A.Rr.; kontratë shitjeje automjeti nr. \*\*\* kol., datë 19.11.2013, me

38. **Faktet nga hetimi administrativ kryesisht** – nga kontrolli i DPV-së së vitit 2011, subjekti deklaroi blerje automjeti në datën 15.11.2011, në vlerën 300.000 lekë dhe në DPV-në e vitit 2016, subjekti deklaroi shitjen e automjetit tip “Mercedes-Benz”, me kontratën nr. \*\*\*, datë 5.12.2016, në vlerën 3.100 euro, blerë me kontratë \*\*\*, datë 15.11.2011.

#### **Lidhur me analizimin e burimit të krijimit të likuiditetit *cash***

*Për burimin 1 - nga të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” (me targa \*\*\*), në vlerën 3.100 euro*

39. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar blerje automjeti në datën 15.11.2011, nga bashkëshorti në vlerën 300.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në datën 5.12.2016, në vlerën 3.100 euro.

40. Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja<sup>20</sup>, konfirmohet se shtetasi A.Rr. ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\*, deri më 4.1.2017. Nga kontrolli i kryer në AMF, referuar policave të sigurimit, ky automjet ka qenë në pronësi të personit të lidhur A.Rr., deri në vitin 2016 - 2017.

41. Sipas dokumentacionit të dorëzuar në deklaratën *Vetting*, bashkëshorti i subjektit me anë të kontratës nr. \*\*\*, datë 15.11.2011, ka blerë nga shtetasja D.F. automjetin tip “Mercedes-Benz C220D”, viti i prodhimit 1996, në shumën 300.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Më pas, ky automjet është shitur në vlerën 3.100 euro, me kontratën nr. \*\*\*, datë 5.12.2016, me palë shitëse A.Rr. dhe palë blerëse E.A., likuiduar jashtë zyrës noteriale.

42. Komisioni vëren se automjeti është shitur pas 5 vjetësh, me një diferencë prej 121.197 lekësh më shumë nga çmimi i blerjes ( $135,87 * 3.100 = 421.197$  lekë). Për të vërtetuar nëse subjekti ka paguar detyrimet tatimore për këtë shumë të përfituar, Komisioni i kërkoj informacion Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë.

43. Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë<sup>21</sup>, nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca prej 121.197 lekë mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes) dhe, për këtë arsye, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar.

44. Më tej, konstatohet nga dokumentacioni se subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të këtij automjeti .

45. Komisioni kreu analizën financiare për të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit dhe personave të lidhur në datën 19.11.2011. Referuar shpjegimeve të subjektit në pyetësin

---

palë shitëse A.Rr. dhe palë blerëse K.O.; vërtetim Ambasada Belge në Athinë datë 12.12.2011, ku vërtetohet se automjeti tip “Mercedes-Benz 300D” me targa \*\*\* është në pronësi të shtetasit M.V.H., eksportohet përfundimisht nga Greqia dhe t’i kalojë pronësia shtetasit A.Rr.

<sup>20</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020.

<sup>21</sup>Shkresë nr. \*\*\*, datë 13.1.2020.



standard<sup>22</sup>, subjekti ka jetuar me bashkëshortin, fëmijët<sup>23</sup> dhe prindërit e bashkëshortit që prej vitit 2008.

Përshkrim	19.11.2011
Shtesa / pakësime/ likuiditete <i>cash</i> <sup>24</sup>	0
Shtesa / pakësime/ likuiditete bankë	57,114
Ndryshim likuiditete (total shtesa/pakësime)	<b>57,114</b>
Të ardhura nga pagat subjekti <sup>25</sup>	805,984
Të ardhura nga pagat bashkëshorti <sup>26</sup>	236,240
Të ardhura nga qiraja apt. me nr. pasurie ***, Tiranë	0
Të ardhura nga qiraja tokë bujqësore sip. 9.960 m <sup>2</sup> , banesë me sip. 110 m <sup>2</sup> , oborr me sip. 250 m <sup>2</sup> , 30 rrënjë ullinj	0
Total të ardhura	<b>1,042,224</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	607,674
Shpenzime qiraje	66,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi <i>TIMS</i>	51,685
Shpenzime për blerje automjeti me targa ***	300,000
Total shpenzime	<b>1,025,359</b>
Balanca e fondeve (të ardhura-shpenzime-ndryshim likuiditete)	<b>-40,249</b>

46. **Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti në vitin 2016, për vlerën 121.197 lekë; (ii) referuar analizës financiare në datën 19.11.2011, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -40.249 lekë për blerjen e këtij automjeti.*

***Për burimin 2, që ka kontribuar në krijimin e shumës 4.000 euro cash, të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” (me targa \*\*\*), në vlerën 2.500 euro***

47. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti ka deklaruar dhurim automjeti nga Ambasada Belge, në Athinë, në datë 25.11.2011, në favor të bashkëshortit. Pjesa takuese: 100%. Në DPV-në e vitit 2013, personi i lidhur ka deklaruar gjendje *cash* në vlerën 2.500 euro, të ardhura nga shitja e automjetit të dhuruar nga Ambasada Belge, në Athinë, në shumën 2.500 euro<sup>27</sup>.

48. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në deklaratën *Vetting* vërtetim nga Ambasada Belge, në Athinë, datë 25.12.2011, ku vërtetohet se automjeti tip “Mercedez-Benz 300D”, me targa \*\*\* është në pronësi të shtetasit M.V.H., eksportohet përfundimisht nga Greqia dhe t’i kalojë në pronësi shtetasit A.Rr. Gjithashtu, lista e paketimit të artikujve të automjetit, së bashku me vërtetimin do të paraqiten pranë doganës, si dhe leja e qarkullimit dhe targat do të dërgohen

<sup>22</sup>Në përgjigje të pyetjes nr. 2, subjekti ka shpjeguar: “Prej vitit 2008 që kam lidhur martesë me bashkëshortin tim A.Rr. kam jetuar me të dhe prindërit e tij M. dhe S.Rr. dhe shpenzimet e jetesës për secilin vit të deklarimit tim i kemi paguar bashkërisht si familje”.

<sup>23</sup>Fëmija i parë ka lindur në datën 18.12.2009 dhe fëmija i dytë në datën 9.12.2011.

<sup>24</sup>Pa konsideruar deklarinim e subjektit në pyetësor se gjatë këtij viti ka kursyer shumën 300.000 lekë.

<sup>25</sup>Shuma e pagave të subjektit të transferuara në llogarinë e tij në “Raiffeisen Bank” deri më 19.11.2011.

<sup>26</sup>Shuma e pagave të bashkëshortit të subjektit për periudhën janar 2011 – tetor 2011.

<sup>27</sup>Kursi i euros në datën 19.11.2013: 140.24 \* 2.500 euro = 350.600 lekë.

nga Konsullata në Ministrinë e Jashtme. Ndërkohë nga dokumentet e dorëzuara bashkëlidhur pyetësit standard<sup>28</sup>, subjekti ka paraqitur vërtetimin e datës 8.1.2020, të znj. F.G., me funksion Ambasadore e Belgjikës në Athinë, e cila deklaroi se shtetasja L.Xh. (motra e subjektit) së bashku me bashkëshortin e saj janë të punësuar në banesën e ambasadores belge në Athinë.

49. Komisioni konstaton se personi i lidhur nuk provoi me dokumentacion dhurimin e këtij automjeti, por vetëm që ky automjet është eksportuar nga Greqia në emër të personit të lidhur, pa specifikuar nëse është shitje apo dhurim.

50. Në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti dhe në atë të administruar nga Komisioni, nuk evidentohet targa e këtij automjeti. Po kështu, DRSHTRR-ja<sup>29</sup> në përgjigjen e saj nuk konfirmon që ky automjet të ketë figuruar në emër të bashkëshortit të subjektit.

51. Me anë të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2020, është kërkuar informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave lidhur me zhdoganimin e këtij automjeti, duke përcaktuar numrin e shasisë së automjetit (\*\*\*), për sa kohë automjeti nuk figuronte i regjistruar në DRSHTRR.

52. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave në shkresën e saj<sup>30</sup> përcolli deklaratën doganore *Imp4* me nr. \*\*\*, datë 2.12.2011, ku figuron eksportues Konsullata Belge dhe importues shtetasi A.Rr. Në kutinë nr. \*\*\* me emërtim “monedha dhe shuma totale e faturuar” pasqyrohet çmimi prej 300.000 lekësh dhe, më tej, paraqiten detyrime doganore në shumën 62.834 lekë.

53. Me anë të pyetësit nr. 4, Komisioni i kërkoj shpjegime subjektit për sa rezultoi nga dokumentacioni i administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Në përgjigje subjekti deklaroi: *“Lidhur me DPV-në e vitit 2011 dhe në deklaratën Vetting të vitit 2017, kam deklaruar dhurimin e automjetit ‘Mercedes-Benz’ nga Ambasada Belge në Athinë, në datën 25.11.2011, në favor të bashkëshortit tim A.Rr. Sqaroj se këtë automjet të nxjerrë nga përdorimi i Ambasadës Belge në Athinë, Ambasadori i Belgjikës ku punon dhe motra së bashku me familjen e saj na i ka dhuruar në datën 25.11.2011. Ky automjet i markës ‘Mercedes-Benz 300 D’ ka qenë viti i prodhimit 1992, me numër shasie \*\*\*. Ky automjet i është shitur në datën 19.11.2013 në vlerën 2.500 euro blerësit K.O., sipas kontratës së shitblerjes në datën 19.11.2013. Po ju vendos në dispozicion kontratën e shitblerjes, datë 19.11.2013, për këtë automjet së bashku me vërtetimin e Ambasadorit të Mbretërisë së Belgjikës në Athinë M.V.D.R. Automjeti që është blerë në vlerën 300.000 (treqind mijë) lekë është automjet tjetër, i cili është i markës “Mercedes-Benz C 220 D”, ka qenë viti i prodhimit 1996, me numër shasie \*\*\*, e bardhë, siç rezulton si nga kontrata e blerjes, datë 15.11.2011, si dhe kontrata e shitjes së këtij automjeti në datën 5.12.2016 me kontratën e shitblerjes së automjetit me nr. \*\*\*. Pra, bëhet fjalë për dy automjete të ndryshme”.*

54. Duke qenë se subjekti nuk paraqiti dokument ligjor për të provuar dhurimin e këtij automjeti, në analizën financiare u paraqit kosto blerje për këtë automjet në vlerën 362.834 lekë.

---

<sup>28</sup>E-mail datë 30.1.2020, ora 09:49.

<sup>29</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2020.

<sup>30</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021.

55. Referuar analizës financiare, deri në datën 19.11.2011, subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën -40.249 lekë për blerjen e automjetit me targa \*\*\*. Përgjatë periudhës 19.11.2011 – 2.12.2011 nuk u evidentuan të ardhura të tjera të ligjshme që të mund të kenë shërbyer për blerjen e këtij automjeti.

56. Në lidhje me shitjen e këtij automjeti, u konfirmua që ky automjet është shitur në vlerën 2.500 euro, me kontratën nr. \*\*\*, datë 19.11.2013, me palë shitëse A.Rr., dhe palë blerëse K.O., likuiduar jashtë zyrës noteriale.

57. Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë<sup>31</sup>, nuk evidentohet pagesa dhe detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të pretenduar nga subjekti nga shitja e automjetit.

58. Ndërkohë, për sa kohë u pasqyrua çmim blerje në vlerën 362.834 lekë dhe vlera e shitjes rezultoi 350.600 lekë (*pra, më e vogël dhe, si rrjedhojë, nuk rezultoi me fitim*), në analizën financiare të vitit 2013 u pasqyruan të ardhurat nga shitja e këtij automjeti në vlerën 350.600 lekë.

Komisioni vëren se bashkëshorti i subjektit nuk e ka regjistruar këtë automjet pranë DRSHTRR-së që nga data 2.12.2011 (data e zhdoganimit) deri më 19.11.2013 (data e shitjes). Kjo konfirmohet edhe nga kontrolli në AMF, ku nuk rezultojnë policat të prera nga bashkëshorti i subjektit për këtë automjet.

59. Nga sa rezultoi në DPV-në e vitit 2011 dhe në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaroi se ky automjet është i dhuruar, ndërkohë nga hetimi rezultoi se ky automjet është blerë në vlerën 362.834 lekë. Në këto kushte, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë të pasurisë, bazuar në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në germën “b” të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

60. **Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë lidhur me këtë automjet, bazuar në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në germën “b”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, pasi në DPV-në e vitit 2011 dhe në deklaratën Vetting deklaroi se ky automjet është i dhuruar, ndërkohë nga hetimi i Komisionit rezultoi se ky automjet është blerë në vlerën 362.834 lekë; (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 362.684 lekë për blerjen e këtij automjeti në datën 2.12.2011, për sa kohë, që deri në datën 9.11.2011, nuk kanë pasur burime të ligjshme për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive (referuar analizës financiare në pikën 45) dhe për sa kohë, që përgjatë periudhës 19.11.2011 – 2.12.2011, nuk u evidentuan të ardhura të tjera të ligjshme që të mund të kenë shërbyer për blerjen e këtij automjeti; (iii) bashkëshorti i subjektit nuk e ka regjistruar këtë automjet pranë DRSHTRR-së që nga data 2.12.2011 (data e zhdoganimit) deri më 19.11.2013 (data e shitjes), bazuar në pikën 1, të nenit 92, të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë*

---

<sup>31</sup>Shkresë nr. \*\*\*, datë 13.1.2020.

61. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, për konstatimet në lidhje me burimet e krijimit të gjendjes së llogarisë, shpjegon se: (1) Për të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes- Benz” (me targa \*\*\*), në vlerën 3.100 euro: (i) në nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet se: *“Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të paguesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj”*. Pra, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton mjaft qartë se taksat dhe tatimet vendosen vetëm me ligj dhe asnjë organ shtetëror apo publik nuk mund të përcaktojë se cilat janë të ardhurat e tatueshme. Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, nuk parashikohet se të fitimi i realizuar nga individët, nga shitja e automjeteve është një e ardhur e tatueshme, në këtë kuadër Komisioni nuk mund ta kategorizoj këtë të ardhur si të ardhur të tatueshme. Fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve nga individët (pra, jo si veprimtari tregtare), nuk rezulton të jetë parashikuar si e ardhur e tatueshme në asnjë ligj tjetër në fuqi në Republikën e Shqipërisë; (ii) bazuar në analizën e bërë për të ardhurat nga qiraja, si dhe bazuar në aktin e ekspertimit të përgatitur nga audituesi ligjor O.V., rezulton se balanca në momentin e blerjes së këtij automjeti është pozitive; (iii) vlera negative në shumën -40.249 lekë, është shumë e vogël, dhe nuk mund të përbëjë një gjetje sepse përlllogaritjet e Komisionit apo të audituesit ligjor kryhen mbi të dhëna statistikore dhe jo reale, si rrjedhojë, në to ka një marzhë gabimi të lejuar. (2) Për të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” (me targa \*\*\*), në vlerën 2.500 euro, subjekti deklaroi se: (i) ky automjet nuk është blerë nga bashkëshorti i saj A.Rr., po i është dhuruar nga Ambasadori i Republikës Belge në Athinë. Në dokumentin që është paraqitur si provë edhe pse nuk shkruhet saktësisht se është dhurim, ky fakt vërtetohet si nga provat e paraqitura gjatë hetimit administrativ, ashtu edhe nga Deklarata me Përgjegjësi Personale( bashkëlidhur këtyre prapësimeve), që ish-Ambasadori i Belgjikës në Greqi ka nënshkruar në datën 3.3.2021, para autoriteteve greke<sup>32</sup>; (ii) ndërkohë, që subjekti shpjegon se plotësimi i rubrikës 22 është për faktin se Drejtoria e Përgjithshme e Doganave nuk njeh dhurimin si transaksion, por ka përlllogaritur vlerën e TVSH-së që duhej paguar. Si konkluzion, deklaroi subjekti, në analizën financiare të vitit 2011, duhet të mos përlllogaritet shuma prej 300.000 lekësh, pasi automjeti tip *“Mercedes-Benz 300D” me numër shasie \*\*\* është dhuruar nga Ambasada Belge në Athinë dhe nuk është shitur*”.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

62. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

---

<sup>32</sup>Me përgjegjësi personale dhe duke njohur pasojat, që parashikohen nga dispozita e paragrafit 6, të nenit 22, të ligjit nr. 1599/1986, se: *“Me detyrën e ish-Ambasadorit të Belgjikës në Greqi, deklaroi zyrtarisht se automjeti Mercedes 300D me numër shasie: \*\*\* u dha nga z. M.V.H., ish-ndjekës komercial i Ambasadës së Belgjikës në Greqi falas dhe pa asnjë shpërblim të z. A.RR., banues në Shqipëri dhe kunat i znj. L.XH., e cila punonte për mua në rezidencën e ambasadës. Dhurimi u bë për arsye se z. V.H. iku nga Greqia dhe u kthye në Belgjikë, ku merrte pension”*.

***Për të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes-Benz” (me targa \*\*\*), në vlerën 3.100 euro***

63. Në lidhje me pretendimin e subjektit, për të konsideruar në analizën financiare të ardhurat nga shitja e automjetit, pasi nuk mund të kategorizohet si e ardhur e tatueshme, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim nga shitja e këtij automjeti dhe në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se: “*Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë*”.

64. Nën dritën e sa më sipër, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar rezulton të jetë e ardhur e paligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

65. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm dhe paraqiti dokumentacion provues në lidhje me dhurimin e këtij automjeti nga ambasada belge në Athinë. Për këtë arsye, Komisioni ka marrë në konsideratë dhurimin e këtij automjeti sipas deklarimit të subjektit dhe paraqiti në analizën financiare vetëm shpenzimet e kryera për zhdoganimin e këtij automjeti në shumën 62.834 lekë.

66. Në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti në shumën 2.500 euro, në konsideratë të provës së dërguar nga subjekti se i janë dhuruar, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim nga shitja e këtij automjeti dhe në vlerësim të parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se: “*Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë*”. Referuar këtij neni, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti, konkretisht për shumën 287.766 lekë<sup>33</sup> (si diferencë midis të ardhurave nga shitja në vlerën 350.600 lekë<sup>34</sup> me shumën e shpenzimeve doganore në vlerën 62.834 lekë), nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim.

67. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar në shumën 287.766 lekë rezulton të jetë e ardhur e paligjshme, në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

---

<sup>33</sup>Shuma 2.500 euro e vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën 1 euro = 140.24 lekë.

<sup>34</sup>Shuma 2.500 euro e vlerësuar me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën 1 euro = 140.24 lekë.

68. Në këto kushte, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur kanë mungesë financiare në shumën 408.963 lekë<sup>35</sup> nga burime të ligjshme të të ardhurave nga shitja e dy automjeteve, për të kursyer likuiditete *cash* në shumën 4.000 euro, të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

69. **Si përfundim**, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në shumën 4.000 euro, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

#### **4. Kursime nga paga dhe qiraja e apartamentit, në shumën 133.168,87 lekë**

70. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime nga paga dhe qiraja e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit M. dhe S.Rr., në llogarinë bankare nr. \*\*\*, në “Raiffeisen Bank”, në emër të bashkëshortit në vlerën 133.168,87 lekë. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi subjekti deklaron kursimet nga paga dhe qiraja e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit. Për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>36</sup>.

71. **Faktet nga hetimi administrativ kryesisht** – referuar dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>37</sup>, konfirmohet se bashkëshorti i subjektit A.Rr. ka llogari “page” me gjendje në vlerën 133.168,87 lekë, në datën 27.1.2017. Llogaria është çelur në datën 20.1.2012.

72. Komisioni konstaton se kreditimet në këtë llogari kanë të bëjnë me të ardhurat nga pagat<sup>38</sup> dhe nga depozitime nga të tretë për qiranë<sup>39</sup>. Shtesat dhe/ose pakësimet vjetore të kësaj llogarie janë reflektuar në analizën financiare.

#### ***Lidhur me burimin e krijimit***

73. **Të ardhura nga paga** - Komisioni konstaton se në këtë llogari janë transferuar pagat nga punësimi i bashkëshortit pranë OSHEE-së, konfirmuar edhe nga vërtetimi i dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

74. **Të ardhura nga qiraja (apartamenti në pronësi të prindërve në rrugën “\*\*\*”, Tiranë)** - në DPV-në e vitit 2010, subjekti deklaron të ardhura nga qiraja në vlerën 22.000 lekë/muaj, për periudhën 8.10.2010 – 31.12.2010. Në DPV-në e vitit 2011, deklaron kontratën e qirasë së lidhur për periudhën 8.10.2010 – 8.12.2011, me vlerë 22.000 lekë/muaj. Në DPV-në e vitit 2012, vjehtëri i subjektit M.Rr., deklaron dhënien e apartamentit me qira z. J.F., në vlerë 23.000 lekë/muaj, kontrata lidhur më 15.12.2011. Në DPV-në e vitit 2013, vjehtëri i subjektit M.Rr., deklaron dhënien e apartamentit me qira z. A.Sh., në vlerë 22.000 lekë/muaj,

<sup>35</sup>Shuma e vlerës 121.197 lekë me vlerën 287.766 lekë.

<sup>36</sup>Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 23.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, sipas të cilit gjendja e llogarisë rrjedhëse së z. A.Rr. në datën 23.1.2017 është në shumën 133.168 lekë, nxjerrje llogarie “Raiffeisen Bank”, gjendja e llogarisë në datën 17.1.2017 është 133.168 lekë, kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 15.12.2011, kontratë qiraje nr. \*\*\*, datë 24.1.2017, certifikatë pronësie datë 8.9.2005, kontrata nr. \*\*\*, datë 5.9.2005.

<sup>37</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020.

<sup>38</sup>Totali i pagave të kredituara në llogari ka qenë në shumën 1.516.987 lekë, përfshirë pagën e kaluar në llogari në datën 9.1.2017).

<sup>39</sup>Totali i depozitimeve në llogari nga të tretë ka qenë në shumën 1.273.500 lekë, përfshirë transfertën e datës 17.1.2017 (trajtuar te të ardhurat nga qiraja e apartamentit në Tiranë).

kontrata lidhur më 15.12.2011. Në DPV-në e vitit 2014, bashkëshorti i subjektit A.Rr., deklaroi të ardhura nga qiraja me qiramarrësin A.Sh., në total në vlerën 264.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2015, bashkëshorti i subjektit A.Rr., deklaroi të ardhura nga qiraja me qiramarrësin A.Sh., në total në vlerën 147.500 lekë.

75. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga qiraja e apartamentit të ndodhur rrugën “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, kati \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit M. dhe S.Rr., si vijon: (i) shumën 196.500 lekë, për periudhën 8.10.2010 - 8.12.2011 me qiramarrës E.Gj. dhe B.G. Vlera e qirasë ka kaluar në numrin e llogarisë së subjektit; (ii) shumën 230.000 lekë, për periudhën 15.12.2011 – 23.10.2012, me qiramarrës J.F., me kontratën e qirasë nr. \*\*\*, datë 15.12.2011. Vlera e qirasë ka kaluar në numrin e llogarisë së bashkëshortit A.Rr.; (iii) shumën 1.043.500 lekë, për periudhën mars 2013 dhe në vijim, sipas kontratës së qirasë nr. \*\*\*, datë 24.1.2017, me qiramarrës A.B.Sh. Vlera e qirasë ka kaluar në numrin e llogarisë së bashkëshortit A.Rr.

76. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka dorëzuar kontratën qirasë nr. \*\*\*, datë 15.12.2011, me palë qiradhënëse M. dhe S.Rr. dhe palë qiramarrëse J.F. për dhënie me qira të apartamentit me sip. 52 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me afat 1-vjeçar nga 20.12.2011 – 20.12.2012, në vlerën 23.000 lekë/muaj, si dhe kontratën e qirasë nr. \*\*\*, datë 24.1.2017, me palë qiradhënëse M. dhe S.Rr. dhe palë qiramarrëse A.Sh., për dhënie me qira të apartamentit me sip. 52 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, me afat 1-vjeçar, duke filluar nga data 24.1.2017, në vlerën 23.000 lekë/muaj. Palët deklarojnë se qiradhënësi ka qenë edhe më parë me qira në këtë banesë, që nga marsi i vitit 2013 dhe ka paguar rregullisht qiranë, e cila ka qenë në vlerën 22.000 lekë/muaj, kaluar në llogarinë bashkëshortit të subjektit.

77. Në pyetësin standard subjekti deklaroi se për të ardhurat e realizuara nga qiraja, tatimi në burim është paguar sipas llogaritjes së kryer nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Vlorë. Në cilësinë e provës, subjekti ka paraqitur shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28. 1.2019, lëshuar nga Drejtoria e Tatimeve Vlorë, ku rezultoi se shtetasi M.Rr. (vjehtëri), është i regjistruar për përgjegjësinë tatimore të tatimit të mbajtur në burim dhe ka paguar tatimin mbi qiranë në vlerën 362.850 lekë, si dhe nuk ka detyrime të papaguara deri në datën 28.1.2020.

78. *Lidhur me mënyrën e përfutimit të këtyre të ardhurave*, në dokumentacionin e administruar nga “Raiffeisen Bank”<sup>40</sup>, evidentohen këto transaksione: (a) gjatë vitit 2010, në llogarinë e subjektit, është kryer një depozitim në vlerën 20.500 lekë me përshkrim “E.G., derdh në llogari”; (b) gjatë vitit 2011, në llogarinë e subjektit, janë kryer disa depozitime në vlerën totale 198.000 lekë me përshkrim “E.G., derdh në llogari” ose “B.G., derdh në llogari”; (c) gjatë vitit 2012, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, janë kryer 10 depozitime në vlerën 23.000 lekë, në total 230.000 lekë, me përshkrim “J.F., derdh në llogari”; (ç) gjatë vitit 2013, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, janë kryer disa depozitime në vlerën totale 216.000 lekë me përshkrim “A.Sh., derdh në llogari”<sup>41</sup>; (d) gjatë vitit 2014, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, janë kryer disa depozitime në vlerën totale 264.000 lekë me përshkrim “A.Sh., derdh në llogari”; (dh) gjatë vitit 2015, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, janë kryer disa

<sup>40</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020.

<sup>41</sup> Me përjashtim të depozitimit të datës 19.12.2013 ku është specifikuar “pagesë qiraje muaji dhjetor 2013”.

depozitime në vlerën totale 191.500 lekë me përshkrim “A.Sh., derdh në llogari”<sup>42</sup>; (e) gjatë vitit 2016, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit, janë kryer disa depozitime në vlerën totale 350.000 lekë me përshkrim “A.Sh., derdh në llogari”; “A.Sh., derdh në llogari/qira”. Sa më lart, shuma totale e qirasë e paguar nëpërmjet sistemit bankar gjatë periudhës 2010 – 2016 ka qenë në vlerën 1.470.000 lekë.

**79. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës,** Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konstatimin se: *ka mospërputhje midis DPV-së së vitit 2012, ku personi i lidhur M.Rr., deklaron dhënien e apartamentit me qira z. J.F. me anë të kontratës së lidhur në datë, 15.12.2011, gjithashtu, në DPV-në e vitit 2013, deklaron dhënien e këtij apartamentit me qira një tjetër qiramarrësi z. A.Sh., po me anë të kontratës së lidhur në datën 15.12.2011.*

80. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, ka shpjeguar se apartamenti që është në pronësi të prindërve të bashkëshortit është dhënë me qira që në fund të vitit 2010, pasi në shtator të vitit 2010 familjarisht kanë shkuar të jetojnë në Sarandë për arsye të emërimit të subjektit në këtë qytet. Që prej muajit shtator apartamenti është nxjerrë për t’u dhënë me qira për shkak se e kishin të pamundur ta përdornin këtë banesë për shkak të largësisë që kishin për të shkuar nga Saranda në Tiranë dhe, gjithashtu, për të mbuluar edhe shpenzimet. Si fillim qiramarrës kanë qenë bashkëshortët E. dhe B.G., me të cilët vjehri i subjektit nuk ka lidhur kontratë qiraje, por qiranë e ka hedhur në llogarinë bankare të subjektit. Këta qiramarrës kanë vazhduar të mbanin apartamentin me qira deri në vitin 2011. Ky fakt vërtetohet edhe nga deklarata noteriale e shtetasit B.G. që pranon se e ka marrë me qira apartamentin për periudhën tetor 2010 – nëntor 2011. Pasi ata u larguan, apartamentin e ka marrë me qira shtetasi J.F. me të cilin vjehri ka lidhur dhe kontratë qiraje më 15.12.2011. Ky qiramarrës ka vazhduar deri në vitin 2013, ku në muajin mars të vitit 2013, pasi janë larguar këta qiramarrës, e ka marrë me qira shtetasi A.Sh., me të cilin vjehri nuk ka lidhur kontratë qiraje, por ka vijuar që të depozitojë çmimin e qirasë në llogarinë e bashkëshortit të subjektit. Subjekti shpjegon se në DPV-në e vitit 2013 nuk ka mospërputhje, pasi kontrata e cituar e vitit 2011 nuk është shkruar për të treguar qiramarrësin, por është cituar për të treguar se është i njëjti apartament që është dhënë me kontratën e qirasë në vitin 2011 dhe në vazhdimësi.

81. Bazuar në shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni vlerëson se subjekti arriti të shpjegojë bindshëm mospërputhjet që ekzistonin midis deklarimeve në lidhje me qiramarrësit në DPV-në e vitit 2012 dhe 2013.

82. **Si përfundim,** Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratimet vjetore, të cilat nuk ndikojnë të vetme në procesin e rivlerësimit të subjektit.

***Lidhur me verifikimin e tatimit mbi të ardhurat e realizuara nga qiraja, për efekt të ligjshmërisë së të ardhurave***

83. Në dokumentacionin e administruar në dosjen e ILDKPKI-së<sup>43</sup>, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë në datën 19.9.2018, informon se personat e lidhur të subjektit të rivlerësimit

<sup>42</sup> Me përjashtim të depozitimit të datës 29.1.2015 ku është specifikuar “pagesë qiraje”.

<sup>43</sup> E-mail, datë 12.9.2018, ora 15:35.



dhe qiramarrësit e këtij apartamenti nuk kanë likuiduar tatime mbi qiranë për të ardhurat e përfituara.

84. Referuar dokumentacionit të administruar nga DPT-ja<sup>44</sup> dhe Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë<sup>45</sup>, rezulton se shtetasi M.Rr., është objekt i deklaramit individual të tatimit në burim mbi të ardhurat. Ka deklaruar vetëm për muajin dhjetor të vitit 2019, deklarata e dorëzuar në datën 28.1.2020 dhe likuiduar më 30.1.2020. DPT-ja informon se në sistemin C@TS, nuk disponohet kontratë qiraje e depozituar.

85. Referuar kontratës së qirasë, nr. \*\*\*, datë 15.12.2011, lidhur me qiramarrësin J.F., në nenin 6, pika 6.4, përcaktohet se qiradhënësi do të paguajë tatimin mbi fitim nga të ardhurat e realizuara. Në kontratën e qirasë, nr. \*\*\*, datë 24.1.2017, me qiramarrësin A.Sh., nuk është specifikuar detyrimi i pagesës së tatimit mbi fitim nga të ardhurat e realizuara. Komisioni vëren se nuk rezulton të jetë lidhur kontratë qiraje me këta qiramarrës për periudhën mars 2013 – 24.1.2017, por janë deklaruar të ardhurat nga qiraja në deklarata periodike vjetore. Gjithashtu nuk rezulton të jetë lidhur kontratë me qiramarrësit E. dhe B.G. për periudhën tetor 2010 – dhjetor 2011, por janë deklaruar të ardhurat në DPV-në e vitit 2011 dhe 2012.

86. Sipas deklaratës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat, personi i lidhur M.Rr. deklaroi të ardhura nga qiratë në shumën 3.122.500 lekë<sup>46</sup> dhe ka paguar tatimin e mbajtur në burim në vlerën 362.850 lekë. Drejtoria Rajonale Tatimore Vlorë na informon se pagesa prej 332.850 lekësh është kryer në datën 20.1.2020 dhe pagesa prej 30.000 lekë në datën 28.1.2020.

87. Komisioni vëren se pagesa e detyrimeve tatimore është realizuar pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* dhe pas njoftimit nga Komisioni për fillimin e procesit të rivlerësimit me anë të e-mail-it të datës 13.1.2020, ora 9:59.

88. **Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 1.470.000 lekë për të ardhurat e realizuara nga qiraja e apartamentit të ndodhur në Tiranë, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 19, të neni 3, të ligjit nr. 84/2016, në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të ishin shlyer.*

89. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, u shpreh se konkluzioni i Komisionit në lidhje me të ardhurat nga qeraja e apartamentit, nuk është i drejtë për shkak se këto të ardhura:

i) Vijnë nga një burim i ligjshëm i parashikuar si i tillë në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”. Të ardhurat e përfituara nga vjehri janë të ardhura të ligjshme, sepse ato burojnë nga një burim i ligjshëm, i përcaktuar si i tillë edhe në ligjin për tatimin mbi të ardhurat. Në pikën 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 ka përcaktuar se të ardhura të ligjshme do të konsiderohen të ardhurat e

<sup>44</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 30.12.2020.

<sup>45</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., 23.12.2020.

<sup>46</sup> Duket se në këtë vlerë janë përfshirë të ardhurat nga qiraja e apartamentit në shumën totale 1.931.875 lekë për periudhën 2010 – 2018 dhe të ardhurat nga qiraja e tokës bujqësore në shumën totale 1.200.000 lekë (vlera totale 3.131.875 lekë, pra, 9.375 lekë me shumë se vlera e deklaruar në DIVA).

subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”. Pra, edhe ligji nr. 84/2016, të cilin zbatojnë organet e rivlerësimit, i referohet burimit të të ardhurave, sipas legjislacionit tatimor. Qiraja që është përfituar nga kontrata e qirasë për apartamentin e ndodhur në Tiranë në pronësi të prindërve të bashkëshortit tim përbën një burim të ligjshëm pasi kjo qira nuk është përdorur për krijimin e ndonjë pasurie të paluajtshme.

ii) Për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës nuk e lidh pagesën e detyrimeve tatimore me një afat të caktuar. Vjehri i subjektit i ka paguar detyrimet tatimore. Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 114, parashikon pagimin e detyrimit tatimor jashtë afatit të caktuar me ligj, duke përcaktuar sanksionet përkatëse, ndërkohë që neni D i Aneksit të Kushtetutës, nuk e lidh pagimin e detyrimeve tatimore me ndonjë afat kohor të përcaktuar

iii) Detyrimi për pagimin e këtyre të ardhurave nuk ka qenë i subjektit por i prindërve të bashkëshortit dhe subjekti nuk mund të ketë përgjegjësi etike apo ligjore për veprimet që duhet të kryenin prindërit e bashkëshortit. Përgjegjësia në përgjithësi por veçanërisht për sjelljen etike është individuale. Në rastin konkret detyrimi për pagimin e detyrimeve tatimore, ka qenë i vjehrit dhe jo i subjektit të rivlerësimit. Edhe në të drejtën civile ashtu si atë penale, ekziston parimi i rëndësishëm i përgjegjësive individuale. Subjekti dhe prindërit e bashkëshortit kanë jetuar në një shtëpi por bazuar në ligjin nr. 9049, ata nuk kanë pasur statusin e personave të lidhur. Pagesa e detyrimeve tatimore është bërë në momentin kur unë erdha në dijeni të mospagimit të këtij detyrimi, nga vjehri, i cili kishte detyrimin për pagimin e kësaj shume. Në këtë moment u pagua shuma e detyrimit të papaguar dhe dokumentacioni që provonte pagimin e këtij detyrimi iu dërgua Komisionit bashkëlidhur pyetësorit standard, sipas kërkesave të këtij pyetësi<sup>47</sup>. Pagesa e detyrimit tatimor me vonesë është e lejuar nga legjislacioni tatimor dhe me kryerjen e kësaj pagese nuk ka asnjë dëm në buxhetin e shtetit.

iv) Në praktikën vendimmarrëse të institucioneve të rivlerësimit ka një qëndrim të ndryshëm, jo të njëzuar në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore me vonesë.

Nga analiza e sipërcituar – shpjegon subjekti - arrihet në konkluzionin e logjikshëm se të ardhurat e përfituara nga qiraja, nga vjehri M.Rr. duhet të përfshihen në analizën financiare, sepse ato vijnë nga një burim i ligjshëm, në kuptim të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016 ato janë të ardhura sipas përcaktimeve të ligjit, “Për tatimin mbi të ardhurat”, janë deklaruar me vërtetësi në DPV-të vjetore edhe në deklaratën *Vetting* dhe bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, për to janë paguar detyrimet tatimore.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

90. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe

---

<sup>47</sup>Pyetjet e shtruara në pyetësorin standart, u bënë shkak për marjen dijeni të mospagimit të tatimit. Menjeherë sapo mora dijeni kam kërkuar nga vjehri përmbushjen e detyrimit.

provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

91. Në lidhje me pretendimin e subjektit se këto të ardhura vijnë nga një burim i ligjshëm, trupi gjykues vlerëson, se burimi i krijimit të këtyre të ardhurave, bazuar në provat e administruara gjatë hetimit, është shpjeguar dhe provuar bindshëm. Për këtë arsye, në rezultatet e hetimit kryesisht nuk ishte konstatuar një gjë e tillë. Konstatimi i Komisionit në lidhje me legjitimitetin e këtyre të ardhurave, bazohet në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, citon se: “ [...] pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj” [...].

92. Bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, personit të lidhur M.Rr., i lind detyrimi tatimor mbi të ardhurat personale të realizuara nga qiraja e apartamentit në Tiranë. Sipas ligjit, llogaritja e detyrimit tatimor do të bëhet duke u bazuar në kontratën përkatëse të qirasë, ku përcaktohet vlera e qirasë, afati, etj. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8841, datë 11.12.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998”, parashikohet se vetë individi përfitues i të ardhurave nga qiraja duhet të deklarojë dhe të paguajë tatimin mbi të ardhurat personale, sipas afateve të përcaktuara në kontratën e qirasë<sup>48</sup>. Nga viti 2012 e në vijim individi përfitues i të ardhurave nga qiraja, mund të deklarojë dhe të paguajë tatimin mbi të ardhurën personale edhe nëpërmjet deklaratës individuale vjetore të të ardhurave (DIVA), edhe në rast se individi nuk është subjekt deklarimi<sup>49</sup>.

93. Nga hetimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësuar nga trupi gjykues, rezultoi se këto të ardhura të përfituara nga qiraja nuk janë deklaruar në organet tatimore dhe nuk është paguar tatimi në burim i këtyre të ardhurave. Personi i lidhur/vjerrri i subjektit të rivlerësimit i ka deklaruar dhe paguar tatimin mbi këto të ardhura vetëm në momentin e fillimit të hetimit nga Komisioni.

94. Pretendimi i subjektit se pagesa e detyrimeve tatimore është bërë në momentin kur subjekti erdhi në dijeni të mospagimit të këtij detyrimi, nga vjehri, nuk qëndron, pasi bazuar në faktin e provuar që këto të ardhura janë deklaruar rregullisht në DPV-të nga subjekti i rivlerësimit dhe në disa prej tyre me pjesë takuese 100%, provon dijeninë e subjektit mbi përfitimin e këtyre të ardhurave dhe marrëdhënien e subjektit në raport me këto të ardhura. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte kushtuar kujdes në legjitimitetin e këtyre të ardhurave, pasi së bashku me personin e lidhur i ka përdorur këto të ardhura për blerjen e kuotave në fondin e investimit në Raiffeisen Prestigj në datën 10.1.2017.

95. Në lidhje me kohën e pagimit të detyrimeve tatimore pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* 2017, trupi gjykues vlerëson se pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës parashikon qartë kohën e deklaratimit dhe pagimit të detyrimeve, si [...] të jenë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore[...]. Nëse marrim të mirëqenë pretendimin e subjektit se neni D i Aneksit të Kushtetutës, nuk e lidh pagimin e detyrimeve tatimore me ndonjë afat kohor të

<sup>48</sup> Prej viti 2015 e në vijim individi përfitues i të ardhurës e deklaroi dhe pagoi detyrimin e tatimit mbi të ardhurat personale nga qiraja deri në datën 20 të muajit që pason muajin e pagesës nëpërmjet deklaratës së tatimit të mbajtur në burim.

<sup>49</sup> Ligji nr. 20/2012, datë 1.3.2012, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, i ndryshuar.

përcaktuar, atëherë koha e foljes së përdorur në tekstin e pikës 3 të nenit D të aneksit të kushtetutës, do të ishte “do të deklarohen dhe për të cilat do të paguhen detyrimet tatimore”, gjë e cila është përjashtuar qartë në vetë kohën e foljeve të përdorura në tekstin e pikës 3 të nenit D. Gjithashtu, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>50</sup> pagesa e detyrimeve tatimore nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia ligjore për mospagimin e tyre në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të shlyheshin.

96. Në përmbledhje të analizës më lart, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni të plotë mbi të ardhurat e krijuara nga prindërit dhe bashkëshorti, pasi i ka deklaruar ato në DPV-të vjetore dhe si njohëse e ligjit dhe fakti që ishte subjekt deklarues sipas ligjit nr. 9049/2003, duhet të kishte deklaruar dhe të kishte paguar detyrimet tatimore për këto të ardhura në kohën e përfitimit të tyre, për shkak të detyrës dhe funksionit që ajo mbante.

97. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se që të ardhurat e realizuara të kualifikohen si të ardhura të ligjshme, duhet të provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës<sup>51</sup>, si dhe të pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016<sup>52</sup>, në kohën kur ato janë përfituar. Për pasojë, të ardhurat e realizuara nga qiraja e apartamentit të ndodhur në Tiranë, nuk do të konsiderohen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

98. **Në konkluzion**, të ardhurat e përfituara nga qiraja e apartamentit, pavarësisht bindjes së trupit gjykues se ato kanë ardhura nga qiraja, nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit, për shkak se nuk kalojnë testin e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Mbi legjitimitetin e këtyre të ardhurave, që kanë shërbyer për blerje kuotash në vitin 2017.

99. **Si përfundim**, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e apartamentit në shumën 1.470.000 lekë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e blerjes së kuotave në fondin e Investimit Raiffeisen Prestigj, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## 5. Kursime cash në vlerën 900.000 lekë

100. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kursime cash në vlerën 900.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Si burim krijimi subjekti deklaron: (a) të ardhura të krijuara nga: (i) paga e subjektit; (ii) paga e bashkëshortit të subjektit; (b) pensionet e prindërve të bashkëshortit; si dhe (c) dhënia me qira e pasurisë së paluajtshme me natyrë bujqësore përfituar nga prindërit e bashkëshortit në të njëjtën përbërje familjare në bazë të AMTP-së nr. \*\*\*, datë 13.4.1992, në emër të kryefamiljarit M.Rr. me sip. 9.960 m<sup>2</sup> tokë bujqësore dhe banesë me sip. 110 m<sup>2</sup>, oborr me sip. 250 m<sup>2</sup> dhe 30 rrënjë ullinj, regjistruar kjo pasuri në

<sup>50</sup> Vendimi nr. 8/2019 dhe nr. 5/2020.

<sup>51</sup> “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

<sup>52</sup> “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”.

regjistrat e ZVRPP-së Fier, vol. \*\*\*, f. \*\*\* dhe vol. \*\*\*, f. \*\*\*, *kontratë qiraje lidhur me marrëveshje të palëve kontraktore me qiramarrës shtetasin N.Sh.Rr. dhe qiradhënës M.Sh.Rr. në datën 1.1.2011, me afat trevjeçar deri më 1.1.2013*. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>53</sup>.

101. **Faktet nga hetimi administrativ kryesisht** – në deklaratën para fillimit të detyrës, viti 2009, subjekti deklaroi gjendje *cash* në vlerën 200.000 lekë, burimi i krijimit të ardhura nga bursa gjatë Shkollës së Magjistraturës për periudhën tetor 2006 – tetor 2008, bursa mujore 40.000 lekë/muaj.

102. Në DPV-në e vitit 2009, subjekti deklaroi: *“Shumën 4.000.000 lekë kursime nga paga e marrë për periudhën 7.1.2009 – 31.12.2009, së paguar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë cash, vlera 400.000 lekë (katër milion lekë të vjetra)”*. Ndërkohë bashkëshorti i subjektit deklaroi: *“Kursime nga paga si punonjës pranë kompanisë private ‘\*\*\*’ sh.a. në vlerën 300.000 (tre milion lekë të vjetra)”*. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti nuk deklaroi shtesa, pakësime apo gjendje të likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar. Në DPV-në e vitit 2011, subjekti nuk deklaroi shtesa, pakësime apo gjendje të likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar. Në DPV-në e vitit 2012, subjekti deklaroi gjendje *cash* nga të ardhurat në vlerën 500.000 lekë. Gjithashtu, vjehri i subjektit M.Rr., deklaroi gjendje *cash* nga të ardhurat e qirasë, në vlerën 500.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2013, subjekti deklaroi gjendje *cash* nga të ardhurat në vlerën 500.000 lekë. Bashkëshorti i subjektit deklaroi gjendje *cash* në vlerën 2.500 euro. Gjithashtu, vjehri i subjektit M.Rr., deklaroi gjendje *cash* nga të ardhurat e qirasë, në vlerën 500.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti deklaroi gjendje *cash* në vlerën 7.000.000 lekë (shtatë milionë). Në DPV-në e vitit 2015, subjekti deklaroi gjendje *cash* në shumën 8.000.000 lekë (tetë milionë). Në DPV-në e vitit 2016, subjekti nuk deklaroi shtesa, pakësime apo gjendje të likuiditeteve *cash* jashtë sistemit bankar.

103. Komisioni vëren se subjekti nuk ka deklaruar qartë gjendjen e likuiditeteve *cash* dhe me anë të pyetësorit nr. 2<sup>54</sup>, i është kërkuar të deklarojë se sa ka qenë gjendja e likuiditeteve *cash* (jashtë sistemit bankar) në fund të çdo viti përkatës.

104. Nga analizimi i përgjigjeve të subjektit gjatë hetimit<sup>55</sup>, ku në kolonën me emërtim *“gjendje cash në fund të çdo viti”*, subjekti pasqyron shumën e pretenduar si të shtuar gjatë vitit, si dhe bazuar në deklarin e vlerave në rubrikën *“shtesa dhe pakësime”*, në DIPP-të vjetore, vërehet se sipas logjikës së deklarimeve të subjektit, fjala *“gjendje”* nënkupton shtimin e likuiditeteve *cash*.

105. Në vijim të sa më lart, Komisioni konstaton mospërputhje midis deklaratave periodike vjetore dhe shpjegimeve të dhëna në pyetësin nr. 2 dhe gjatë hetimit subjekti ka deklaruar, se: *“Për vitin 2010 dhe vitin 2011 për arsye se në këto dy vite kam pasur ngarkesë psikologjike, pasi kam sjellë në jetë dy fëmijët e mi dhe kam harruar të deklaroj kursimet siç i kam deklaruar çdo vit, kursime të cilat janë pasqyruar në deklaratën Vetting të vitit 2017, kur është pasqyruar*

---

<sup>53</sup> Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 27.4.2015, për tokë arë me sip. 1500 m<sup>2</sup>, në pronësi të M.Rr., AMTP nr. \*\*\*, datë 13.4.1992.

<sup>54</sup> E-mail, datë 23.12.2021, ora 11:15.

<sup>55</sup> E-mail, datë 6.1.2021, ora 13:17.

*kursimi total që unë dhe familja ime kishim bërë ndër vite. Konkretisht, në vitin 2010 kursimet cash janë në vlerën 200.000 lekë. Në vitin 2011 kursimet cash janë në vlerën 300.000 lekë*". Ndërkohë, duke analizuar deklaratat periodike të këtyre dy viteve, vërehet se subjekti nuk ka deklaruar shtesa, pakësime apo gjendje likuiditetesh *cash* në fund të vitit. Referuar germës "d", të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë "vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj", subjekti duhet të kishte deklaruar shumën e kursimeve të tij në deklaratën periodike vjetore përkatëse. Sa më sipër, Komisioni nuk i mori në konsideratë deklaratimet e subjektit lidhur me kursimet e vitit 2010 dhe 2011.

### ***Lidhur me kursimet cash të deklaruara në deklaratat periodike vjetore për vitet 2014 dhe 2015***

106. Subjekti ka deklaruar gjatë hetimit se kursimet për vitet 2014 dhe 2015 janë shënuar gabimisht në "lekë të vjetra", konkretisht për vitin 2014 kursimet *cash* janë në total në vlerën 700.000 lekë dhe për vitin 2015 janë në vlerën 800.000 lekë. Në përfundim, subjekti deklaroi se gjatë çdo viti ka deklaruar vetëm të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit dhe jo kursimet që kanë pasur prindërit e bashkëshortit para martesë, pasi nuk ishte detyrim që të deklaronte kursimet e tyre para lidhjes së martesës. ***Ndërkohë që*** nga deklaratat periodike të vitit 2014 dhe 2015 konstatohet se subjekti ka deklaruar "gjendje *cash*, në vlerën 7.000.000 lekë (shtatë milion)" në deklaratën periodike/vjetore 2014 dhe "gjendje *cash*, në vlerën 8.000.000 lekë (tetë milion)", në deklaratën periodike/vjetore 2015.

107. Duke qenë se Komisioni konstatoi se në të njëjtat deklarata periodike, subjekti ka deklaruar në "lekë të rinj" gjendjet e llogarive bankare, të ardhurat nga pagat, qiraja apo pensione, e gjithashtu, në dy deklaratat periodike të viteve paraardhëse<sup>56</sup>, subjekti i ka deklaruar kursimet në "lekë të rinj", dy rrethana nga të cilat duket se e ka pasur të qartë konceptin e monedhës zyrtare, me anë të pyetësorit nr. 3, iu kërkuan shpjegime lidhur me deklarin e kursimeve *cash* në "lekë të vjetër" për vitet 2014 dhe 2015.

108. Në përgjigje, subjekti ka shpjeguar: "*Në lidhje me pyetjen 1 ju sqaroj se është e vërtetë se për vitin 2014 dhe vitin 2015 gabimisht kam deklaruar kursimet me lekë të vjetra, lapsus që të gjithë mund ta bëjnë. Kursimet për vitin 2014 dhe vitin 2015 dukshëm kuptohen se janë shënuar gabim pasi unë vlerën 7 milionë lekë nëse do të ishin të rinj nuk kisha si t'i kurseja kur të ardhurat e mia nuk e arrinin këtë shumë. E njëjta gjë dhe për vitin 2014*".

109. Komisioni vlerësoi të marrë në konsideratë në analizën financiare si shtesa kursimesh vlerën 7.000.000 lekë të deklaruar në DPV-në e vitit 2014 dhe vlerën 8.000.000 lekë të deklaruar në DPV-në e vitit 2015. Arsyetim ky i bazuar në pikën 5<sup>57</sup>, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit institucionet e rivlerësimit shqyrtojnë deklaratat periodike vjetore të subjektit për të konfirmuar vërtetësinë dhe saktësinë e deklarimeve lidhur me gjendjen reale financiare të tij, si dhe për të vërtetuar nëse ka pasur burime të mjaftueshme dhe të ligjshme për krijimin e pasurisë.

<sup>56</sup> Konkretisht deklaratat periodike vjetore të vitit 2012 dhe 2013.

<sup>57</sup> "Deklarinet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimt".

110. Gjithsesi, Komisioni në rezultate e hetimit, lidhur me mundësinë e kursimeve nga likuiditet *cash* që janë paraqitur në analizën financiare duke u bazuar në deklarin e subjektit në DPV-të për vitet 2014 dhe 2015, i kërkoi shpjegime subjektit.

111. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet e saj me shkrim në përgjigje të rezultateve të hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore, i qëndron të njëjtit shpjegim të dhënë gjatë hetimit se: “[...] është e vërtetë se për vitin 2014 dhe vitin 2015 gabimisht kam deklaruar kursimet me lekë të vjetra, lapsus që të gjithë mund ta bëjnë. Kursimet për vitin 2014 dhe vitin 2015 dukshëm kuptohen se janë shënuar gabim pasi unë vlerën 7 milion lekë nëse do të ishin të rinj nuk kisha si t’i kurseja kur të ardhurat e mija nuk e arrinin këtë shumë. E njëjta gjë dhe për vitin 2014”.

112. Në përfundim të analizimit të këtij deklarimi, Komisioni çmon se në rastin konkret, duhen marrë në konsideratë në analizën financiare shpjegimet e subjektit lidhur me kursimet e vitit 2014 dhe 2015, pra, respektivisht shumat 700.000 lekë për vitin 2014 dhe 800.000lekë për vitin 2015, kjo për shkak të ndërthurjes së elementeve të analizës së deklarimeve të subjektit, shpjegimeve të tij, si dhe një vlerësimi logjik e të arsyeshëm të të gjitha rrethanave të renditura në vijim: (i) nëse ndjekim logjikën e deklarimeve të subjektit, gjendja nënkupton shtimin dhe pakësimin pasurisë, konfirmuar kjo edhe nga deklarimi në rubrikën “shtesa dhe pakësime”. Në rast se në përllogaritjen e gjendjes progresive të kursimeve *cash* do të konsiderohej shuma 7.000.000 lekë dhe 8.000.000 lekë, gjendja në datën e plotësimit të deklaratës *Vetting* do të ishte 14.900.000 lekë, përkundrajt shumës 900.000 lekë të deklaruar nga subjekti; (ii) shtesat e pretenduara nga subjekti si kursime për vitet 2014 dhe 2015 duket të jenë në *trendin* e kursimeve të deklaruara në vitet e mëparshme, konkretisht ka deklaruar kursime vlerat 700.000 lekë për vitin 2009; 1.000.000 lekë për vitin 2012; dhe 1.000.000 lekë për vitin 2013; (iii) gjatë viteve 2014 dhe 2015, nuk duket të kenë ndodhur fenomene financiare të tilla që mund të passillnin rritje të fluksit monetar dhe që të mund të kishin një ndikim domethënës në likuiditetet e subjektit, si për shembull shitje e pasurive të paluajtshme, huamarrje, kredi etj.; (iv) në deklaratën periodike të vitit 2009, subjekti ka deklaruar shumën 400.000 lekë dhe, më tej, në kolonën vlera dhe shifra me fjalë deklaroi me shifra 4.000.000 dhe me fjalë “katër milionë lekë”. Po kështu, në të njëjtën deklaratë subjekti deklaroi të ardhura nga paga 8.070.000 lekë dhe me fjalë “tetë milionë e shtatë mijë lekë të vjetra”. Po kështu, bashkëshorti deklaroi vlerën 300.000 lekë dhe me fjalë “tre milionë lekë të vjetra”, rrethana të cilat tregojnë konfuzion prej subjektit.

113. Si konkluzion, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pasaktë në deklaratat periodike vjetore 2014 dhe 2015, duke u gjendur në kushtet e gërmës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

***Lidhur me të ardhurat nga qiraja e pasurisë së paluajtshme me natyrë bujqësore (tokë bujqësore me sip. 9960 m<sup>2</sup>; banesë me sip. 110 m<sup>2</sup>, oborr me sip. 250 m<sup>2</sup>; si dhe 30 rrënjë ullinj)***

114. Referuar deklarimeve periodike vjetore të subjektit në ILDKPKI, rezulton se: (1) në DPV-në e vitit 2011, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar kontratën e qirasë së pasurisë së paluajtshme me natyrë bujqësore (tokë bujqësore me sip. 9.960 m<sup>2</sup>; banesë me sip. 110 m<sup>2</sup>, oborr me sip. 250 m<sup>2</sup>; si dhe 30 rrënjë ullinj) në bashkëpronësi me prindërit, me vlerë 300.000 lekë në vit; (2) në DPV-në e vitit 2012, personi i lidhur/vjehri i subjektit M.Rr., ka deklaruar

kontratën e qirasë, datë 1.1.2011, për pasurinë e paluajtshme me natyrë bujqësore (tokë bujqësore me sip. 9.960 m<sup>2</sup>; banesë me sip. 110 m<sup>2</sup>, oborr me sip. 250 m<sup>2</sup>; si dhe 30 rrënjë ullinj), me vlerë 300.000 lekë në vit; (3) në DPV-në e vitit 2013, personi i lidhur/vjehri i subjektit M.Rr., ka deklaruar kontratë qiraje, datë 1.1.2011, për pasurinë e paluajtshme me natyrë bujqësore (tokë bujqësore me sip. 9.960 m<sup>2</sup>; banesë me sip. 110 m<sup>2</sup>, oborr me sip. 250 m<sup>2</sup>; si dhe 30 rrënjë ullinj), me vlerë 300.000 lekë në vit; (4) në DPV-në e vitit 2014, subjekti deklaron të ardhura nga kontrata e qirasë së pasurisë së paluajtshme me natyrë bujqësore (tokë bujqësore me sip. 9.960 m<sup>2</sup>; banesë me sip. 110 m<sup>2</sup>, oborr me sip. 250 m<sup>2</sup>; si dhe 30 rrënjë ullinj), me vlerë 300.000 lekë në vit.

115. Në deklaratën *Vetting*, subjekti deklaron të ardhura në vlerën 900.000 lekë nga dhënia me qira e pasurisë tokë bujqësore me sip. 9960 m<sup>2</sup>; banesë me sip. 110 m<sup>2</sup>, oborr me sip. 250 m<sup>2</sup>; si dhe 30 rrënjë ullinj, përfituar me AMTP në vitin 1992, në emër të kryefamiljarit M.Rr. (trajtuar në seksionin e pasurive të deklaruara nga prindërit e bashkëshortit të subjektit).

116. Subjekti në deklaratën *Vetting* ka paraqitur një kontratë qiraje të thjeshtë (jo e lidhur para noterit publik), me qiramarrës shtetasin N.Sh.Rr. dhe qiradhënës M.Sh.Rr. për dhënie me qira të tokës bujqësore me sip. 9.960 m<sup>2</sup>, banesës me sip. 110 m<sup>2</sup>, së bashku me oborrin me sip. 250 m<sup>2</sup> dhe 30 rrënjë ullinj, të ndodhur në V., C., Fier. Qëllimi i përdorimit të tokës së dhënë me qira do të jetë për kultivim bujqësor, kontrata është lidhur në datën 1.1.2011, me afat trevjeçar, me të drejtë rinovimi. Vlera e qirasë është në masën 300.000 lekë/vit dhe në natyrë 100 litra vaj ulliri. Pagesa në të holla do të bëhet në çdo datë 20-25 të muajit shtator të çdo viti, ndërsa pagesa në natyrë në muajin janar të çdo viti. Sipas nenin 6 të kontratës, detyrimet tatimore do të mbulohen nga qiradhënësi.

117. Në pyetësin standard, subjekti deklaron se shuma e qirasë e përfituar në 4 vjet është 1.200.000 lekë (300.000 lekë/vit).

118. Sikundër u trajtuar dhe analizua, pagesa e detyrimeve tatimore e realizuar jo në momentin dhe vitin përkatës, kur ato duhej të shlyheshin, por për efekt të procesit të rivlerësimit, nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia ligjore për mospagimin e tyre në kundërshtim me ligjin ndër vite. Për pasojë, të ardhurat e realizuara nga qiraja e pasurisë së paluajtshme me natyrë bujqësore, nuk do të konsiderohen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

**119. Nga faktet e analizuar më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *ka mospërputhje ndërmjet deklaratës Vetting nga njëra anë dhe deklaratave periodike dhe pyetësorit standard nga ana tjetër, lidhur me vlerën e të ardhurave nga qiraja e tokës bujqësore pasi: Në deklaratën Vetting ka deklaruar vlerën 900.000 lekë dhe në deklaratat periodike vjetore dhe në pyetësin standard ka deklaruar vlerën 1.200.000 lekë; (ii) subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 900.000 lekë për të ardhurat e realizuara nga qiraja e pasurisë së paluajtshme me natyrë bujqësore, pasi nuk provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të ishin shlyer.*



120. **Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës,** deklaroi se konkluzioni i Komisionit nuk është i drejtë për shkak se këto të ardhura: (i) vijnë nga një burim i ligjshëm i parashikuar si i tillë në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”; (ii) për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës nuk e lidh pagesën e detyrimeve tatimore me një afat të caktuar; (iii) detyrimi për pagimin e këtyre të ardhurave nuk ka qenë i subjektit por i prindërve të bashkëshortit dhe subjekti nuk mund të këtë përgjegjësi etike apo ligjore, për veprimet që duhet të kryenin prindërit e bashkëshortit. Përgjegjësia në përgjithësi por veçanërisht për sjelljen etike është individuale; (iv) në praktikën vendimmarrëse të institucioneve të rivlerësimit ka një qëndrim të ndryshëm, jo të njehsuar në lidhje me pagesën e detyrimeve tatimore me vonesë. Në vijim do të analizojmë një pjesë të këtyre vendimeve, por theksoj se Komisioneri Publik, në një ankimin të tij ka kërkuar njehsimin e praktikës në këtë drejtim sipas parashikimeve të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016.

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

121. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

122. Lidhur me pretendimin e subjektit se të ardhurat nga dhënia me qira e tokës bujqësore vijnë nga një burim i ligjshëm, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi dhe provoi bindshëm burimin e krijimit. Subjekti paraqiti vetëm një kontratë të thjeshtë, jo noteriale midis palëve, e cila nuk ishte e besueshme për trupin gjykues duke pasur parasysh se: (i) kontrata e qirasë ishte me vëllain e babait të bashkëshortit, i cili jetonte në të njëjtin vend ku është edhe prona; (ii) subjekti nuk provoi se xhaxhai i bashkëshortit/qiramarrësi kishte një interes të ligjshëm në marrjen me qira të kësaj pasurie; (iii) subjekti i rivlerësimit i kishte deklaruar si të ardhura të tij me pjesë takuese 100%, në disa DPV vjetore; dhe (iv) pagesa e qirasë ishte bërë *cash* jashtë sistemit bankar.

123. Në lidhje me legjitimitetin e këtyre të ardhurave, i analizuar në interpretim të pikës , të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, e cila citon se: “ [...] *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.*Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm burimin nga vinin të ardhurat”, trupi gjykues vlerëson se fakti që nuk është paguar tatimi mbi burim i të ardhurave nga qiraja e tokës bujqësore në kohën e përfitimit të tyre, këto të ardhura nuk e kalojnë testin e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

124. Nga hetimi dhe shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësuar nga trupi gjykues, rezultoi se këto të ardhura të përfituara nga qiraja e tokës bujqësore nuk janë deklaruar në organet tatimore dhe nuk është paguar tatimi në burim i këtyre të ardhurave nga personi i lidhur dhe/ose subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar dhe paguar tatimin mbi këto të ardhura vetëm në momentin e fillimit të hetimit nga Komisioni.

125. Fakti që këto të ardhura janë deklaruar rregullisht në DPV të subjektit të rivlerësimit, provon dijeninë e subjektit mbi përfitimin e këtyre të ardhurave dhe nuk mbështet pretendimin e subjektit se pagesa e detyrimeve tatimore është bërë në momentin kur subjekti erdhi në dijeni të mospagimit të këtij detyrimi, nga vjehtëri. Për më tepër, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte kushtuar kujdes në legjitimitetin e këtyre të ardhurave, pasi së bashku me personin e lidhur i ka përdorur këto të ardhura për blerjen e kuotave në fondin e investimit në Raiffeisen Prestigj në datën 10.1.2017.

126. Në lidhje me kohën e pagimit të detyrimeve tatimore, pas dorëzimit të deklaratës *Vetting* në vitin 2017, trupi gjykues vlerëson se pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës parashikon qartë kohën e deklarimit dhe pagimit të detyrimeve, si [...] *të jenë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore* [...]. Nëse marrim të mirëqenë pretendimin e subjektit se neni D i Aneksit të Kushtetutës, nuk e lidh pagimin e detyrimeve tatimore me ndonjë afat kohor të përcaktuar, atëherë koha e foljes së përdorur në tekstin e kushtetutës, do të ishte ‘*do të deklarohen dhe për të cilat do të pagohen detyrimet tatimore*’, gjë e cila është përjashtuar qartë në vetë kohën e foljeve të përdorura në tekstin e pikës 3 të nenit D. Gjithashtu, referuar edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>58</sup> pagesa e detyrimeve tatimore nuk e shmang subjektin nga përgjegjësia ligjore për mospagimin e tyre në momentin dhe vitin përkatës kur ato duhej të shlyheshin.

127. Në përmbledhje të analizës më lart, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur dijeni të plotë mbi të ardhurat e krijuara nga prindërit e bashkëshortit, pasi i ka deklaruar ato në DPV-të vjetore dhe si njohëse e ligjit, duhet të kishte njohuri mbi detyrimeve tatimore që duhet të paguheshin për këto të ardhura, për shkak të detyrës dhe funksionit që mbante.

128. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se që të ardhurat e realizuara të kualifikohen si të ardhura të ligjshme, duhet të provohet pagesa e detyrimeve tatimore në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës<sup>59</sup>, si dhe të pikës 19, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016<sup>60</sup>, në kohën kur janë përfituar. Për pasojë, të ardhurat e realizuara nga qiraja e tokës bujqësore, nuk do të konsiderohen në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur.

129. **Në konkluzion**, të ardhurat e përfituara nga qiraja e tokës bujqësore, nuk konsiderohen të ardhura të ligjshme për efekt të procesit të rivlerësimit, për shkak se nuk kalojnë testin e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, të ardhura të cilat kanë shërbyer për blerje kuotash në fondin e Raiffeisen Prestigj në vitin 2017, në pjesë takuese 50% të subjektit të rivlerësimit.

130. **Si përfundim**, Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë gjendjen *cash* në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, në lidhje me këto të ardhura dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e tokës bujqësore në vlerën 1.200.000 lekë, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e blerjes së kuotave

---

<sup>58</sup> Vendimet nr. 8/2019 dhe nr. 5/2020.

<sup>59</sup> “Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj”.

<sup>60</sup> “Të ardhura të ligjshme” janë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur të tij/saj, sipas përcaktimeve të burimit të të ardhurave, të parashikuara në ligjin “Mbi tatimin mbi të ardhurat”.

në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj, duke u gjendur brenda parashikimeve të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

## **6. Blerje kuotash në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj, në vlerën 7.556.000 lekë**

131. **Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar** blerjen e kuotave në Fondin e Investimit Raiffeisen Prestigj pranë “Raiffeisen Bank” në datën 10.1.2017 në vlerën 7.556.000 lekë. Pjesa takuese: 50%.

132. Si burim krijimi subjekti deklaroi të ardhurat: (1) në shumën prej 4.000.000 lekë, depozituar në “Raiffeisen Bank” në datën 10.1.2017, që rrjedh nga kursimet familjare, ndër vite, nga marrëdhëniet e punës së deklaruesit dhe bashkëshortit të deklaruesit, kursim nga paga dhe qiraja e apartamentit në pronësi të prindërve të bashkëshortit M. dhe S.Rr. në llogarinë bankare nr. 0000200956 në “Raiffeisen Bank” të bashkëshortit A.Rr.; (2) në shumën prej 2.025.761 lekësh, përfituar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë nr. \*\*\*, datë 22.1.2016, për të cilin është lëshuar urdhërkzekutimi nr. \*\*\*, datë 22.1.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë me objekt “pagim dëmi pasuror dhe jo pasuror nga pala e paditur shoqëria INSIG sh.a”, ku një nga palët paditëse për të cilën është pranuar padia është dhe deklaruesja Gentiana Xhelili, e ka kaluar në llogari nga një prej paditësve në këtë gjykim, znj. Z.M., sipas njoftim debitimi, datë 20.10.2016, nga “Raiffeisen Bank”, e cila me prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 3.8.2016, ka autorizuar motrën e saj Z.M. që të pranojë ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, vendim gjyqësor nr. \*\*\*, datë 22.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe të depozitojë në emrin e deklarueses Gentiana Xhelili pjesën e saj takuese në llogarinë e saj bankare, vendim i cili është ekzekutuar dhe për të cilën nga përmbaruesi gjyqësor privat “\*\*\*\*” është marrë vendimi për pushimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv; (3) në shumën prej 1.500.000 lekësh, nga kursimet e bashkëshortit në llogarinë e tij me nr. \*\*\* në “Raiffeisen Bank”, në datën 10.1.2017, sipas njoftim debitimit, datë 10.1.2017, kurtime që rridhnin nga paga nga marrëdhëniet e punës ndër vite dhe qiraja e apartamentit me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, pall. nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, Tiranë, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, në pronësi të prindërve të bashkëshortit M. dhe S.Rr. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>61</sup>.

133. **Nga hetimi i Komisionit, ka rezultuar se** në deklaratën *Vetting*, subjektit ka paraqitur vërtetimin nr. \*\*\*, datë 23.1.2017, të “Raiffeisen Invest”, sipas të cilit vlera e investimit në datën 11.1.2017, është në vlerën 7.556.000 lekë dhe urdhër për blerje kuotash në fondin e investimit “Raiffeisen Prestigj”, në shumën 7.556.000 lekë, datë 10.1.2017.

134. Sipas dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Invest”<sup>62</sup>, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka investuar në fondin prestigj, marrëdhënie e përfunduar në datën 15.10.2019, duke kryer shlyerje të kuotave dhe ka realizuar një fitim *neto* në shumën 612.313,22 lekë.

135. Komisioni, më tej, analizoi burimet e blerjes së këtyre kuotave, si më poshtë:

---

<sup>61</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 23.1.2017, nga Raiffeisen Invest sipas të cilit gjendja e depozitës në datën 11.1.2017 është në shumën 7.556.000 lekë, depozitim në llogari “Raiffeisen Bank” në datën 10.1.2017, ku Gentiana Xhelili depoziton shumën prej 4.000.000 lekësh, njoftim debitimi “Raiffeisen Bank”, datë 10.1.2017, ku z. A.Rr. kalon në llogarinë e bashkëshortes shumën prej 1.500.000 lekësh, urdhër për blerje kuotash Raiffeisen Prestigj nga Gentiana Xhelili, shuma e pagesës 7.556.000 lekë.

<sup>62</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020.

**Burimi 1** - shuma 4.000.000 lekë, nga kursimet familjare ndër vite; paga e subjektit dhe bashkëshortit; qiraja e apartamentit në qytetin e Tiranës

136. Në deklaratën *Vetting*, subjektit ka paraqitur vërtetimin, datë 10.1.2017, sipas të cilit ka depozituar në llogarinë në “Raiffeisen Bank”, shumën 4.000.000 lekë.

137. Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave<sup>63</sup> konfirmon se në datën 10.1.2017, në emër të subjektit të rivlerësimit ka raportime të transaksioneve bankare në vlerën 4.000.000 lekë, në “Raiffeisen Bank”, me përshkrim “*Gentiana Xhelili kursime familjare ndër vite*”.

138. Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar burimin e ligjshëm të kursimeve *cash* të deklaruara, ndër vite, për periudhat: (i) 2006 – 2008, duke konsideruar të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit, periudhë për të cilën subjekti ka deklaruar 200.000 lekë kursime *cash*; dhe (ii) 2009 – 2016, duke konsideruar për çdo vit të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit dhe personave të lidhur (bashkëshortit, fëmijëve, prindërve të bashkëshortit), periudhë gjatë së cilës subjekti dhe personat e lidhur kanë kursyer në total shumën 4.200.000 lekë.

139. Në analizën financiare janë përfshirë të ardhurat dhe shpenzimet si në vijim:

140. Të ardhurat e subjektit janë pasqyruar në vlerën *neto* bazuar në lëvizjet e llogarive bankare në “Raiffeisen Bank” dhe “Tiranës Bank”, si edhe në vërtetimet përkatëse<sup>64</sup>. Të ardhurat nga paga e bashkëshortit janë pasqyruar në vlerën *neto* bazuar në lëvizjet e llogarive bankare “Intesa Sanpaolo Bank” dhe “Union Bank” (për pagat e përfituara nga “A.Group”), “Raiffeisen Bank”, konfirmuar edhe me vërtetimet përkatëse<sup>65</sup>. Të ardhurat nga pensioni i vjehrrit dhe vjehrrës u bazuan në dokumentacionin e administruar nga hetimi<sup>66</sup>.

141. Lidhur me të ardhurat e realizuara nga qiraja, nuk janë konsideruar në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, sikurse është arsyetuar më lart. Të ardhurat nga shitja e automjeteve janë konsideruar referuar arsyetimit më lart

142. Në analizë u konsideruan të ardhurat e vjehrrit nga shpronësimi, të ardhurat nga shoqëria e sigurimeve INSIG, si dhe të ardhurat nga Bashkia për lindjen e fëmijëve (transferta bankare në llogaritë e fëmijëve në “ABI Bank”).

143. Referuar shpjegimeve të subjektit në pyetësorin standard<sup>67</sup>, subjekti ka jetuar me bashkëshortin, fëmijët<sup>68</sup> dhe prindërit e bashkëshortit që prej vitit 2008 (lidhur martesë datë

<sup>63</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020.

<sup>64</sup> Vërtetim të ardhurash Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë; vërtetim të ardhurash Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë nr. \*\*\*prot., datë 11.10.2016, periudha 2010 – 2014 së bashku me lejelindje; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 19.3.2013, të DRSSH-së Sarandë; vërtetim të ardhurash Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2017; vërtetim të ardhurash Posta Shqiptare; vërtetim të ardhurash Shkolla e Magjistraturës nr. \*\*\* prot., datë 14.10.2016.

<sup>65</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 22.12.2020, nga ISSh-ja; vërtetim, datë 25.10.2016, lëshuar nga Posta Shqiptare; vërtetim të ardhurash nga OSHEE-ja.

<sup>66</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 26.1.2021, nga ISSh-ja.

<sup>67</sup> Në përgjigje të pyetjes nr. 2, subjekti ka shpjeguar: “Prej vitit 2008 që kam lidhur martesë me bashkëshortin tim A.Rr. kam jetuar me të dhe prindërit e tij M. dhe S.Rr. dhe shpenzimet e jetesës për secilin vit të deklaramit tim i kemi paguar bashkërisht si familje”.

<sup>68</sup> Fëmija i parë ka lindur në datën 18.12.2009 dhe fëmija i dytë në datën 9.12.2011.

14.7.2008) dhe, për rrjedhojë, Komisioni përlllogaritë shpenzime jetese bazuar në shkresën e ILDKPKI me nr. \*\*\*, datë 4.3.2019, për periudhën 2006 – 2016<sup>69</sup>. Në vitin e lindjes së fëmijëve u konsideruan vetëm muajt që nga muaji i lindjes deri në fund të vitit.

144. Shpenzimet e qirasë u bazuan: (i) për periudhën e qëndrimit në Sarandë në deklaratimet e subjektit dhe në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 18.1.2020, në certifikatën familjare që vërteton lidhjen e deklaruësës me pronarin e banesës K.Gj., në kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 28.5.2004 me shoqërinë ndërtuese; dhe (ii) për periudhën e qëndrimit në Vlorë në deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 15.1.2020, në kontratën e qirasë me pronarin e banesës E.D. nr. \*\*\*, datë 23.03.2017, dhe në prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 23.3.2017.

145. Shpenzimet mjekësore<sup>70</sup> dhe të shkollimit<sup>71</sup> u bazuan në dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti.

146. Shpenzime për automjete (*TPL AMF*) u bazuan në primet e evidentuara në AMF për secilin automjet.

147. Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit u analizuan bazuar në lëvizjet hyrje-dalje nëpërmjet sistemit *TIMS* të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, si dhe u krahasuan/plotësuan me deklaratimet e subjektit/dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti, sipas metodikës së shpjeguar në Aneks 02.

#### 148. **Analiza financiare për periudhën 2006 – 2016**

149. Referuar analizës financiare të mësipërme, duket se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën në kursime, respektivisht në shumën -446.021 lekë për vitin 2011; në shumën -757.872 lekë për vitin 2012; -677.226 lekë për vitin 2013; në shumën -7.426.578 lekë për vitin 2014; në shumën -7.510.286 lekë për vitin 2015 dhe në shumën -239.403 lekë për vitin 2016, në total në shumën -17.057.386 lekë.

**Burimi 2** - shuma 2.025.761 lekë, përfituar nga vendimi gjyqësor i formës së prerë me nr. \*\*\*, datë 22.1.2016

150. Subjekti i rivlerësimit ka përfituar shumën prej 2.025.761 lekësh, në bazë të vendimit nr. \*\*\*, datë 22.1.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, i formës së prerë, për të cilin është lëshuar urdhërekzekutimi nr. \*\*\*, datë 22.1.2016, me objekt “pagim dëmi pasuror dhe jo pasuror nga pala e paditur shoqëria INSIG sh.a.”, ku një nga palët paditëse për të cilën është pranuar padia është dhe znj. Gentiana Xhelili. Me prokurën e posaçme nr. \*\*\*, datë 3.8.2016, subjekti i rivlerësimit ka autorizuar motrën Z.M. të pranojë ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv vendim gjyqësor dhe të depozitojë pjesën e saj takuese në llogarinë e saj bankare (*kaluar shuma 2.025.761 lekë, me anë të njoftim debitimi, datë 20.10.2016, në “Raiffeisen Bank”*).

<sup>69</sup> Vlera për vitin 2007 është saktësuar sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2008, të INSTAT-it, drejtuar ILDKPKI-së (174.072 lekë/vit për person)

<sup>70</sup> Dëftesë dhëniesh shërbimesh me pagesë nr. \*\*\*, datë 13.7.2018; dëftesë arkëtimi nr. \*\*\*, datë 12.7.2018; dhe dëftesë arkëtimi nr. \*\*\*, datë 24.7.2018.

<sup>71</sup> Vërtetim nr. \*\*\*, datë 14.1.2020; vërtetim nr. \*\*\*, datë 14.1.2020; vërtetim nr. \*\*\*, datë 14.1.2020.

151. Komisioni vëren se këto të ardhura përjashtohen nga tatimi mbi të ardhurat, referuar pikës 9, të nenit 8/1\*, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku parashikohet se: *“Përfitimet për dëmshpërblime, të marra nëpërmjet vendimeve të formës së prerë të gjykatave, si dhe kompensimet e caktuara për kostot gjyqësore”*.

152. Sipas dokumentacionit të administruar nga noteri publik R. S.<sup>72</sup>, Komisioni vëren se me anë të prokurës nr. \*\*\*, datë 9.5.2015, anëtarët e familjes së origjinës së subjektit Z., V., A., M. dhe L.Xh., kanë autorizuar subjektin e rivlerësimit Gentiana Xhelili, për t’i përfaqësuar në: (a) Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë, çdo gjykatë tjetër dhe në Prokurorinë e Rrethit Lushnjë, në gjykimin e çështjes me objekt “kërkim dëmshpërblimi”, si dhe në gjykime të çdo lloji tjetër; (b) përfaqësimin përpara AKKPT-së, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, Gjykatën e Apelit, Gjykatën e Lartë, apo çdo gjykatë tjetër, ZVRPP-së Tepelenë, Noterit Publik, Bashkisë Tepelenë, apo çdo institucioni tjetër publik ose privat, për çdo çështje të njohjes, kthimit e kompensimit të pronave për pasuritë e paluajtshme tokë truall, tokë bujqësore, kullota, pyll etj., në fshatin Sh., Tepelenë, si dhe pasuri trashëgimore të familjes S.Q.Xh.

153. Sa më sipër, rezultoi se subjekti i i rivlerësimit ka qenë përfaqësuese e palëve paditëse në këtë proces sipas prokurës së përgjithshme, pavarësisht se në vendimin përfundimtar evidentohet se palët janë përfaqësuar në gjykim nëpërmjet avokatit M.M., sipas tagrit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit me anë të prokurës nr. \*\*\*, datë 13.7.2015. Mbështetur në nenin 96 *“Pajisja me prokurë e përfaqësuesit”*, në pikën “ç”, të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohet se gjyqtarët nuk mund të jenë përfaqësues të palëve. Megjithatë, Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë se subjekti nuk e ka ushtruar këtë përfaqësim për përfitime monetare dhe as ka pretenduar të ardhura nga përfaqësimi, por subjekti ka qenë vetë palë në gjykim së bashku me anëtarët e familjes dhe për shkak të marrëdhënies së posaçme familjare ka përfaqësuar ata dhe veten. Por, pavarësisht kësaj, vetë funksioni i magjistratit dhe fakti që subjekti mund të ketë qenë përfaqësuese dhe prezent në seancat gjyqësore mund të ketë ndikuar në intimidimin e palës paditëse në këtë gjykim, fakt ky që do të mbahet në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin etik të subjektit të rivlerësimit.

**Burimi 3** - shuma 1.500.000 lekë, kursimet nga paga e bashkëshortit dhe qiraja e apartamentit në Tiranë

154. Sipas vërtetimit të datës 10.1.2017, të “Raiffeisen Bank” (dorëzuar në deklaratën *Vetting*), rezulton se bashkëshorti i subjektit, në këtë datë, ka kaluar në favor të subjektit shumën prej 1.500.000 lekësh me përshkrim *“kalim në llogarinë e bashkëshortes, burim paga + qira mujore”*.

155. Kjo llogari bankare është trajtuar më lart dhe shtesat dhe pakësimet e saj janë reflektuar në analizën financiare të kryer në pikën 149 të këtij vendimi.

156. **Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës**, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të

---

<sup>72</sup> Shkresë e protokolluar në Komision me nr. \*\*\*, datë 22.12.2020.

provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën në kursime, respektivisht në shumën -446.021 lekë për vitin 2011 ; në shumën -757.872 lekë për vitin 2012; në shumën -677.226 lekë për vitin 2013; në shumën -7.426.578 lekë për vitin 2014; në shumën -7.510.286 lekë për vitin 2015; si dhe në shumën -239.403 lekë për vitin 2016.*

**157. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës,** deklaroi se *Komisioni nuk ka gjykuar drejtë për shkak se këto të ardhura: (i) vijnë nga një burim i ligjshëm i parashikuar si i tillë në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”; (ii) për këto të ardhura janë paguar detyrimet tatimore dhe neni D i Aneksit të Kushtetutës nuk e lidh pagesën e detyrimeve tatimore me një afat të caktuar; (iii) detyrimi për pagimin e këtyre të ardhurave nuk ka qenë i subjektit, por i prindërve të bashkëshortit dhe subjekti nuk mund të këtë përgjegjësi etike apo ligjore, për veprimet që duhet të kryenin prindërit e bashkëshortit. Përgjegjësia në përgjithësi por veçanërisht për sjelljen etike është individuale.*

#### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

158. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

159. Duke qenë se trupi gjykues për të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e apartamentit në Tiranë dhe ato të realizuara nga qiraja e tokës bujqësore, nuk i vlerëson si të ardhura të ligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe këto të ardhura kanë shërbyer si burim për blerjen e kuotave në fondin e investimit, atëherë edhe burimit i krijimit të këtij fondi është me burime të paligjshme.

160. Në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, citon se: “[...] *Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm burimin nga vinin të ardhurat*”.

161. **Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë të burimeve të ligjshme, shoqëruar me dokumentacion justifikues për të krijuar këtë pasuri/fond investimesh në shumën 3.552.438 lekë, e paraqitur në tabelën në vijim.

Përshkrim	2006 - 2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
Shtesa / pakësime likuidite cash (lekë dhe euro)	200,000	700,000	0	0	1,000,000	1,350,600	700,000	800,000	421,197
Shtesa / pakësime likuidite cash (lekë dhe euro)	-103	-33,289	-41,707	131,413	-31,753	66,906	450,880	273,197	2,831,585
<b>Ndryshim likuidite (total shtesa/pakësime)</b>	<b>199,897</b>	<b>666,711</b>	<b>-41,707</b>	<b>131,413</b>	<b>968,247</b>	<b>1,417,506</b>	<b>1,150,880</b>	<b>1,073,197</b>	<b>3,252,782</b>
Të ardhura nga pagat subjekti	1,234,173	738,406	842,204	882,458	520,468	885,828	1,042,386	1,003,540	990,557
Të ardhura nga sigurimet shoqërore subjekti	0	0	0	0	347,545	0	0	0	0
Të ardhura nga pagat bashkëshorti	0	479,334	156,473	283,488	310,676	310,937	176,665	652,671	799,943
Të ardhura nga pensioni vjehtëri	0	0	0	0	0	144,857	265,893	270,745	274,385
Të ardhura nga pensioni vjehtëri	0	0	0	0	0	0	0	132,424	188,895
Të ardhura nga shpronësimi vjehtëri	0	0	0	0	0	0	0	175,929	0
Të ardhura nga qiraja apt. me nr. pasurie *** Tiranë	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga qiraja tokë bujqësore sip. 9,960 m2, banesë me sip. 110 m2 ob.	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Të ardhura nga shitja e automjetit të dhuruar, me shasi ***	0	0	0	0	0	62,384	0	0	0
Të ardhura nga shitja e automjetit, me targa ***	0	0	0	0	0	0	0	0	300,000
Të ardhura nga INSIG SHA	0	0	0	0	0	0	0	0	2,025,761
Të ardhura nga bashkia (transferata në llogaritë e fëmijëve)	0	0	5,000	0	5,000	0	5,000	0	0
<b>Total të ardhura</b>	<b>1,234,173</b>	<b>1,217,740</b>	<b>1,003,677</b>	<b>1,165,946</b>	<b>1,183,689</b>	<b>1,404,006</b>	<b>1,489,944</b>	<b>2,235,309</b>	<b>4,579,541</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT	420,249	557,865	683,100	694,485	846,144	846,144	1,319,988	1,345,656	1,410,552
Shpenzime për kopshin/shkollën e fëmijëve	-	-	-	-	-	-	-	-	60,000
Shpenzime qiraje Sarandë/Vlorë	-	-	24,000	72,000	72,000	72,000	64,500	60,000	60,000
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TMS	32,020	-	62,465	51,685	40,566	27,198	64,254	50,933	16,624
Shpenzime për automjete (TPL AMF)	-	-	-	-	14,604	6,600	16,900	15,810	18,985
Shpenzime për blerje automjeti me targë ***	-	-	-	300,000	-	-	-	-	-
Shpenzime për blerje automjeti me nr. shasie ***	-	-	-	62,384	-	-	-	-	-
<b>Total shpenzime</b>	<b>452,269</b>	<b>557,865</b>	<b>769,565</b>	<b>1,180,554</b>	<b>973,314</b>	<b>951,942</b>	<b>1,465,642</b>	<b>1,472,399</b>	<b>1,566,161</b>
<b>Balanca e fondeve (Të ardhura-Shpenzime-Ndryshim likuidite)</b>	<b>582,007</b>	<b>-6,836</b>	<b>275,819</b>	<b>-146,021</b>	<b>-757,872</b>	<b>-965,442</b>	<b>-1,126,578</b>	<b>-310,286</b>	<b>-239,403</b>

162. **Si konkluzion** Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kuotave në fondin e investimeve, në vlerën -3.552.438 lekë, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

### **Banesë me qira në vlerën 5.000 lekë/muaj ndodhur në qytetin e Vlorës**

163. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar - në përdorim një banesë për të cilën nuk është përpiluar kontratë qiraje, pasi pronari i apartamentit z. E.Rr. D. disponon vetëm një kontratë premtim shitje me nr. \*\*\*, datë 7.2.2013, të lidhur me shoqërinë e ndërtimit si sipërmarrës “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe nuk disponon certifikatë pronësie (bashkëngjitur kontratë premtim-shitje për shtetasin E.Rr.D.). Qiraja për përdorim është 5.000 lekë/muaj. Përdorimi i banesës me të dhëna: apartamenti \*\*\*, kati \*\*\*, nga toka e kullës \*\*\*, 2+1, me sip. 95 m<sup>2</sup> dhe verandë me sip. 52.2 m<sup>2</sup>, ndodhur në Vlorë, marrëveshje midis zotëruesit dhe përdoruesit të banesës për banim. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>73</sup>.

164. **Faktet nga hetimi administrativ kryesisht** – Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, me shkresën datë 12.1.2021, na informon se subjekti dhe personat e lidhur, figurojnë të regjistruar si banorë të Bashkisë Vlorë, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, me adresë vendbanimi rruga “\*\*\*\*”, pall. “\*\*\*\*”, hyrja nr. \*\*\*, kati \*\*\*, ap. \*\*\*, Vlorë.

165. Në DPV-në para fillimit të detyrës të vitit 2009 dhe DPV-në e vitit 2009, subjekti deklaron si adresë në Gjendjen Civile apartamentin e ndodhur rrugën “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, kati \*\*\*, ap. \*\*\*, Tiranë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit. Në DPV-të e vitit 2010 deri më 2013, deklaron adresë tjetër, rruga Nr. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Sarandë. Në DPV-të e vitit 2014 deri në DPV-të e vitit 2015, deklaron adresë tjetër, lagjja “\*\*\*\*”, Vlorë. Në DPV-të e vitit 2016 dhe në vazhdim, deklaron si adresë në Gjendjen Civile, Lagjja “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, Vlorë dhe si adresë tjetër: lagjja “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, kompleksi “\*\*\*\*”, Vlorë.

166. Në pyetësorin standard, subjekti deklaron se nga momenti që ka marrë detyrën ka jetuar në tri adresa: (a) për periudhën 2008 – shtator 2010, në banesën e prindërve të bashkëshortit në

<sup>73</sup> Kontratë premtim shitje nr. \*\*\*, datë 7.2.2013, me palë shitëse të ardhshme shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe palë blerëse e ardhshme E.D. për shitje apartamenti me sip. 95 m<sup>2</sup> dhe verandë me sip. 52.2 m<sup>2</sup>, Vlorë + praktika e shoqërisë.



Tiranë; (b) për periudhën shtator 2010 – 15 maj 2014, lagja “\*\*\*\*”, Sarandë, në banesën e z. K.Gj., të cilën e ka marrë me qira nga motra e tij e quajtur S.C., me qira 6.000 lekë/muaj (si dokumentacion provues, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 18.1.2020, certifikatë familjare të deklarueses me pronarin e banesës K.Gj., kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 28.05.2004); (c) për periudhën 15 maj 2014 dhe aktualisht, jeton në Vlorë, në banesën e marrë me qira nga z. E.D., me të cilin fillimisht nuk ka pasur kontratë, pasi ky shtetas jetonte në Itali dhe banesën me qira e ka dhënë motra e tij V.B. (si dokumentacion provues, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 15.1.2020). Me prokurën e posaçme, nr. \*\*\*, datë 23.3.2017, është caktuar motra e qiradhënësit për lidhjen e kontratës së qirasë nr. \*\*\*, datë 23.3.2017, me palë qiramarrës A.Rr. (afati 1 vit), rinovuar përsëri me kontratën nr. \*\*\*, datë 15.1.2020. Qiraja mujore për të gjithë periudhën që kanë jetuar dhe aktualisht është në shumën 5.000 lekë/muaj dhe i është shlyer znj. V.B.

Subjekti deklaron se prej vitit 2008, që ka lidhur martesë<sup>74</sup> ka jetuar me bashkëshortin dhe prindërit e tij dhe shpenzimet e jetesës janë mbuluar bashkërisht.

167. Nga hetimi i Komisionit<sup>75</sup> nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit të gjendej në kushtet e konfliktit e interesit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe qiradhënësit e këtij apartamenti.

168. **Lidhur me apartamentin në Tiranë** - Komisioni vëren se subjekti në deklarinimin para fillimit të detyrës të vitit 2009 dhe në DPV-në e vitit 2009, si adresë banimi deklaron këtë apartament. Gjithashtu, në pyetësorin standard deklaron se nga viti 2008 – shtator 2010, ka banuar në banesën e regjistruar në emër të prindërve të bashkëshortit M. dhe S.Rr., me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

Sa më sipër, Komisioni vëren se subjekti duhet të kishte deklaruar përdorimin e kësaj pasurie prej tij, bazuar në pikën 1, germa “a”, në nenin 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, mbart detyrimin të deklarojë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil.

169. **Lidhur me apartamentin në qytetin e Sarandës**, Komisioni vëren se sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 18.1.2020, znj. S.C., deklaron se prej shtator 2010 – 14.5.2014, ka marrë *cash* çdo muaj nga bashkëshorti i subjektit shumën prej 6.000 lekësh për llogari të vëllait K.Gj. dhe nuk kanë lidhur kontratë qiraje.

170. **Lidhur me apartamentin në qytetin e Vlorës**, Komisioni vëren se referuar kontratës së qirasë, çmimi është 5.000 lekë/muaj, në pikën C2 noteri publik ka specifikuar se çmimi i referencës për këtë apartament është 17.427 lekë/muaj. Sipas kontratës, qiraja do të likuidohet *cash* çdo muaj. Sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\*, datë 15.1.2020, znj. V.B., deklaron se prej datës 15.5.2014 – 28.2.2017, ka marrë *cash* çdo muaj nga bashkëshorti i subjektit shumën prej 5.000 lekësh për llogari të vëllait E.D. dhe se nuk kanë lidhur fillimisht kontratë qiraje.

171. Në pyetësorin nr. 2<sup>76</sup>, subjekti është pyetur lidhur me çmimin e qirasë në vlerën 5.000 lekë, duke qenë se bëhet fjalë për një apartament me sip. 94 m<sup>2</sup> dhe 52 m<sup>2</sup> verandë, i ndodhur

<sup>74</sup> Lidhja e martesës, datë 14.7.2008.

<sup>75</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 3.2.2021.

<sup>76</sup> E-mail, datë 23.12.2021, ora 11:15.

në një kompleks ndërtimesh të reja, nuk janë deklaruar shpenzime mobilimi dhe çmimi referencës për dhënie me qira në vitin 2015 është 16.751 lekë<sup>77</sup>.

172. Në përgjigje<sup>78</sup>, subjekti deklaroi se qiradhënësi kërkonte njerëz të besuar dhe vlera e qirasë është caktuar 5.000 lekë/muaj, pa tarifën e administrimit me kushtin kryesor që qiraja të paguhej në fillim të muajit dhe të mos lihej asnjë faturë e energjisë elektrike dhe ujit pa paguar. Megjithatë çmimi i referencës së qirave për qytetin e Vlorës në vitin 2015 ishte 16.751 lekë, shtëpia është marrë në vitin 2014, kur nuk kishte hyre në fuqi VKM-ja nr. 469, datë 3.6.2015, por edhe sikur kjo vlerë të ishte në fuqi edhe në vitin 2014, është vendosur për shkak të pagesës së fitimit mbi këtë burim fitimi dhe kurrsesi nuk zëvendëson vullnetin e palëve në lidhjen e kontratave. Mobilimi i shtëpisë është shumë modest, edhe pse banesa është në një kompleks ndërtimesh të reja, duke qenë se qyteti i Vlorës është kthyer në një kantier ndërtimi, ka shumë komplekse të reja dhe ½ e banesave janë të pashitura, pasi nuk ka kërkesë. Më tej, subjekti citon se fakti që kjo banesë ka verandë me sip. 52 m<sup>2</sup>, nuk është një element që rrit vlerën e qirasë së banesës por vlerën e shitjes, pasi nuk ka pasur luksin që apartamentin me qira ta kërkoj me verandë.

173. Sipas kontratës premtim shitje nr. \*\*\*, datë 7.2.2013, me palë shitëse e ardhshme shoqëria e ndërtimit “\*\*\*” sh.p.k. dhe palë blerëse e ardhshme z. E.D., apartamenti me sip. 94 m<sup>2</sup> dhe verandë me sip. 52.2 m<sup>2</sup>, në Vlorë, jepet kundrejt çmimit 47.864 euro (apartamenti shitet në vlerën 41.600 euro, veranda 6.264 euro). Në datën e lidhjes së kontratës, është likuiduar vlera prej 42.919 euro dhe brenda datës 6.2.2014, do të likuidohet diferenca prej 4.945 euro.

174. Komisioni konstatoi pasaktësi në deklarin e adresave të deklaruara në DPV-të vjetore në lidhje me shtëpitë me qira gjatë ushtrimit të funksionit dhe mosdeklarimin si adresë banimi të apartamentit në Tiranë në pronësi të prindërve të bashkëshortit.

175. Subjekti i rivlerësimit, gjatë shpjegimeve me shkrim në lidhje me këto konstatime deklaroi se: *“Në çdo deklaratë është e njëjta adresë, lagjja ‘\*\*\*’ Vlorë. Në DPV-në 2014, 2015, ndërsa gjendjen civile e kam pasur në Tiranë, Njësia Bashkiake nr. \*\*\*. Në vitin 2016 jam regjistruar edhe në Zyrën e Gjendjes Civile në Vlorë ku nga shpjegimet që ka dhënë vjehri, i cili ka bërë regjistrimin në Zyrën e Gjendjes Civile në Vlorë, banesa jonë përfshihej në Njësine Administrative Vlorë \*\*\*, lagjja ‘\*\*\*’, Vlorë, rruga ‘\*\*\*’ dhe unë e kam shënuar rruga ‘\*\*\*’, ndërsa nga Zyra e Gjendjes Civile rezulton vetëm lagjja ‘\*\*\*’, Vlorë. Pra, në rastin konkret ka vetëm një pasaktësi, për shkak të keqinformimit lidhur me rrugën ku unë banoj. Theksoj se familjarisht nuk kemi pasur lidhje me qytetin e Vlorës dhe si çdo person që nuk njeh qytetin, jemi orientuar sipas objekteve dhe vendeve. Kjo ka qenë edhe arsyeja pse ka ndodhur dhe ngatërresa në emrin e rrugës. Theksoj se unë dhe familja ime kemi jetuar prej muajit maj 2014 dhe në vazhdim në të njëjtën banesë, siç vërtetohet edhe nga deklaratat noteriale e qiradhënësit dhe motrës së tij, që e kemi paraqitur si provë gjatë hetimit administrativ. Po kështu, disponoj dhe një kërkesë që bashkëshorti im A.Rr. i ëshë drejtuar OSHEE-së në datën 18.12.2014, për*

<sup>77</sup> Referuar VKM-së nr. 469, datë 3.6.2015.

<sup>78</sup> E-mail, datë 6.1.2021, ora 13:17.

vërtetim debie për kontratën \*\*\* në emër të qiradhënësit E.D. që fakton se në këtë banesë kemi jetuar prej muajit maj 2014 dhe aktualisht”.

176. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (ii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iii) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton se:

177. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi dhe provoi bindshëm mospërputhjet që janë konstatuar nga Komisioni, duke pasur parasysh dhe faktin që gjatë hetimit nuk u gjetën *indicie* apo prova që të vërtetonin se subjekti ka jetuar në ndonjë adresë tjetër, përveç asaj të deklaruar. Subjekti ka bërë deklarin në DPV bazuar në njohuritë e saja mbi rrugën në të cilën ndodhej apartamenti, pa pasur parasysh faktin që adresa duhet të jetë e saktë dhe sipas regjistrimit pranë njësisë administrative përkatëse.

178. **Si konkluzion**, Komisioni vlerëson se subjekti ka bërë deklarin të pasaktë të adresës në DPV-të vjetore përkatëse, deklarime, të cilat sipas trupit gjykues nuk mund të përbëjnë të vetme shkak për shkarkim, bazuar në procesin e rivlerësimit.

## **PASURITË E PRINDËRVE TË BASHKËSHORTIT TË SUBJEKTIT**

### **1. Apartament me sip. 52 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.000.000 lekë, në Tiranë**

179. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit kanë deklaruar apartament me sip. 52 m<sup>2</sup>, rruga “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, k. \*\*\*, ap. \*\*\*, 1+1, z. k. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, Tiranë. Kjo pasuri është në bashkëpronësi të shtetasve M. dhe S.Rr., blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 5.9.2005, në vlerën 2.000.000 lekë, nga shitësit H. dhe S.M. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. Për vërtetimin e deklaratimeve subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>79</sup>.

180. Nga hetimi i Komisionit rezulton se referuar certifikatës së pronësisë, datë 8.9.2005 (dorëzuar në deklaratën *Vetting*), pasuria me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, e llojit apartament me sip. 52 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë, është e regjistruar në emër të shtetasve M. dhe S.Rr. Ky apartament është blerë me kontratën nr. \*\*\*, datë 5.9.2005, me palë shitëse shtetasit H. dhe S.M. dhe blerës M. dhe S.Rr., me çmimin 2.000.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

181. Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja<sup>80</sup>, rezulton se në emër të shtetasve M. dhe S.Rr., është i regjistruar apartamenti me sip. 52 m<sup>2</sup>, blerë në vlerën 2.000.000 lekë, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

182. Me anë të pyetësorit nr. 2<sup>81</sup>, bazuar në pikën 7, të udhëzimit nr. \*\*\*, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, subjektit i është kërkuar të deklarojë burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe dokumentacion justifikues lidhur me ligjshmërinë e këtij burimi.

---

<sup>79</sup>Kontratë shitblerjeje nr. \*\*\*, datë 5.9.2005, me palë shitëse H. e S.M. dhe palë blerëse M. e S.Rr., certifikatë për vërtetim pronësie datë 8.9.2005.

<sup>80</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.2.2020.

<sup>81</sup>E-mail datë 23.12.2021, ora 11:15.

183. Në përgjigje<sup>82</sup>, subjekti deklaron se meqenëse kjo pasuri është blerë nga prindërit e bashkëshortit, nuk e ka deklaruar në vitin 2009 kur ka filluar detyrën.

184. Apartamenti është blerë në vitin 2005 nga kursimet e prindërve të bashkëshortit, ndërkohë që subjekti është martuar në vitin 2008 dhe ka jetuar në këtë apartament kur është martuar, duke e deklaruar si vendbanim dhe vendqëndrim së bashku me bashkëshortin dhe prindërit e tij. Më tej, subjekti deklaron se në vitin 2009, kur është emëruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë për të kryer praktikën profesionale, megjithëse ishte në trungun familjar me prindërit e bashkëshortit nuk ishte detyrim që të deklaronte pasuritë e prindërve të bashkëshortit, por ka deklaruar vetëm pasuritë që ishin fituar me ligjin nr. 7501/1991, “Për tokën”, ku bashkëshorti ishte bashkëpronar me ¼ pjesë.

185. Lidhur me burimin e krijimit, subjekti deklaron: (i) kursimet, ndër vite, nga paga e vjehrrit M.Rr., si mësues; (ii) kursimet, ndër vite, nga paga si punonjëse librari e nënës së bashkëshortit S.Rr.; (iii) aktiviteti si fermer i të dy prindërve gjatë periudhës 1991 dhe në vazhdim (plantacione me ullinj, sera me perime etj.), pasi kanë pasur rreth 10 dynym tokë bujqësore të cilën e kanë shfrytëzuar gjithmonë për aktivitet bujqësor duke shitur prodhime bujqësore në njësinë e shërbimit që kanë pasur në pronësi në Komunën C., dyqan të cilin e kanë shitur në vitin 2006; (iv) depozitë në firmën piramidale “\*\*\*”, ku kanë përfituar shumën 600.000 lekë sipas mandatarkëtimit përkatës; (v) të ardhurat nga puna e bashkëshortit dhe prindërve të tij prej vitit 2005, kur janë transferuar në Tiranë, megjithëse jo për faj të tyre, por për shkak të informalitetit, nuk kanë qenë të siguruar. Bashkëshorti ka punuar pranë shoqërisë “\*\*\*” dhe “\*\*\*” sh.p.k. me pagë mujore 50.000 lekë/muaj, ndërsa prindërit e tij kanë punuar pranë shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

186. Si dokumentacion provues, subjekti ka dorëzuar librezat e punës së prindërve të bashkëshortit, librezën e kontributeve shoqërore, privatizimin e njësisë së shërbimit librari në Komunën C. nga nëna e bashkëshortit si ish-punonjëse librari, të cilën e ka shitur në datën 13.4.2006, në vlerën 1.400.000 lekë.

187. Në pyetësin nr. 3, subjekti ka dorëzuar: vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën *neto* mesatare, përfituar nga punësimi i vjehrrit gjatë periudhës 1994 – 2004, si mësues; vërtetim ku rezulton si i vetëpunësuar në bujqësi për periudhën 1994 – 2007<sup>83</sup>; dhe vërtetim për pagesën e taksave për tokën bujqësore që nga përfitimi i saj dhe aktualisht<sup>84</sup>.

188. Komisioni konstaton se bazuar në kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, provohet se ky apartament është blerë në datën 5.9.2005, kohë në të cilën subjekti ende nuk kishte filluar Shkollën e Magjistraturës dhe ende nuk kishte lidhur martesë me bashkëshortin. Më tej, referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti provohet se personat e lidhur/vjehrrit dhe vjehrra kanë qenë respektivisht në marrëdhënie punësimi dhe vetëpunësimi gjatë periudhës 1994 – 2004.

<sup>82</sup>E-mail datë 6.1.2021, ora 13:17.

<sup>83</sup>Vërtetim të datave 13.11.2014 dhe 23.4.2015, lëshuar nga ISSH-ja Fier.

<sup>84</sup>Vërtetim nr. \*\*\*, datë 20.1.2021, lëshuar nga Bashkia Fier.

189. Në përfundim të analizimit të kësaj pasurie në emër të personave të lidhur/babait dhe nënës së bashkëshortit, Komisioni vlerëson se nuk ka *indicie*, të cilat mund të ngrenë dyshime për pasuri të fshehur/a të subjektit të rivlerësimit dhe nuk ndikojnë në procesin e tij të rivlerësimit.

## **2. Banesë private me sip. 110 m<sup>2</sup> dhe truall me sip. 250 m<sup>2</sup>, në V., Fier**

190. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit/ M.Rr. ka deklaruar banesë private me sip. 110 m<sup>2</sup> dhe truall me sip. 250 m<sup>2</sup>, në fshatin V., Fier, regjistruar në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme me nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, sipas certifikatës së pronësisë datë 27.4.2015, fituar me AMTP-në nr. \*\*\*, datë 13.4.1992, dhënë nga Komisioni i Ndarjes së Tokës për fshatin V., Fier. Kjo pasuri është në bashkëpronësi me anëtarët e tjerë, të cilët rezultojnë të regjistruar në gjendjen civile datë 1.8.1991. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>85</sup>.

191. Nga hetimit i Komisionit rezultoi se kjo pasuri është deklaruar nga bashkëshorti i subjektit si truall me sip. 250 m<sup>2</sup>, ndodhur në Komunën C., Fier. Pjesa takuese ¼, në DPV-në para fillimit të detyrës, viti 2009.

192. Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja<sup>86</sup>, rezulton se në emër të shtetasit M.Rr. është regjistruar pasuria e llojit “truall” me sip. 250 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, i pajisur me certifikatë pronësie datë 27.4.2015.<sup>87</sup> Kjo pasuri është fituar me AMTP-në nr. \*\*\*, datë 13.4.1992. Në dokumentacionin bashkëlidhur administrohet lista e trojeve nr. \*\*\*, e fshatit V., Komuna C./Fier, shoqëruar me vërtetimin se banesa e z. M.Rr. në fshatin V., Komuna C., është ndërtuar para vitit 1991 (pra, banesa e fituar me ligjin nr. 7501 është ndërtuar para vitit 1991).

193. Në përfundim të analizimit të kësaj pasurie, Komisioni konkludon se kjo pasuri është deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe është përfituar në një nga mënyrat e parashikuara në ligj. Nuk konstatohen problematika për procesin e rivlerësimit.

## **3. Tokë bujqësore me sip. 9.960 m<sup>2</sup>, fituar me AMTP, në V., Fier dhe 130 rrënjë ullinj**

194. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, babai i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit/ M.Rr. ka deklaruar: (i) tokë bujqësore me sip. 9.960 m<sup>2</sup> (nga e cila 347 m<sup>2</sup> shpronësuar me VKM-në nr. 1680, datë 24.12.2008), fituar me AMTP-në nr. \*\*\*, datë 13.4.1992, nga e cila sip. prej 1500 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, është e regjistruar në regjistrat hipotekorë vol. \*\*\*, f. \*\*\*, në ZVRPP Fier, në bashkëpronësi të pandarë; (ii) 130 rrënjë ullinj të blerë me 180 lekë/ulliri, me vlerë 23.400 lekë, në bashkëpronësi. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues<sup>88</sup>.

---

<sup>85</sup>Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 27.4.2015, për truall me sip. 250 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 110 m<sup>2</sup>, në V., Fier, në pronësi të shtetasit M.Rr., AMTP nr. \*\*\*, datë 13.4.1992, ku z. M.Rr. merr 250 m<sup>2</sup> truall në V., Fier.

<sup>86</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2020.

<sup>87</sup>Referuar dokumentacioni të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se ASHK-ja Fier<sup>87</sup> konfirmon se në emër të shtetasit M.Rr. rezulton i regjistruar trualli me sip. 250 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 110 m<sup>2</sup>.

<sup>88</sup>Certifikatë për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 27.4.2015, për tokë arë me sip. 1500 m<sup>2</sup>, në pronësi të shtetasit M.Rr., AMTP nr. \*\*\*, datë 13.4.1992, ku shtetasi M.Rr. merr gjithsej 9.960 m<sup>2</sup> tokë bujqësore në V., Fier.

195. Nga hetimi i Komisionit rezulton se në DPV-në para fillimit të detyrës, viti 2009, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar tokë bujqësore me sip. 9.960 m<sup>2</sup> dhe 8 rrënjë ullinj, përfituar nga ligji nr. 7501, në Komunën C., Fier. Pjesa takuese: ¼.

196. Sipas dokumentacionit të administruar nga ASHK-ja<sup>89</sup>, rezulton se në emër të shtetasit M.Rr. janë të regjistruara pasuritë: (i) tokë arë me sip. 1.500 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, vërtetuar me certifikatë pronësie datë 27.4.2015. Kjo pasuri është fituar me AMTP-në nr.\*\*\*, datë 13.4.1992, ku shtetasi M.Rr. merr gjithsej 9.960 m<sup>2</sup> tokë bujqësore në V., Fier; (ii) ullishte me sip. totale 34.720 m<sup>2</sup>, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me nr. \*\*\* pasurie, në emër të shtetasit M.Sh.Rr. +33 bashkëpronarë, e papajisur me certifikatë pronësie.

197. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur VKM-në nr. 1680, datë 24.12.2008, të listës së pronarëve që shpronësohen për efekt të ndërtimit të superstradës Levan – Tepelenë, nga ku rezulton se shtetasi M.Rr., për pasurinë e paluajtshme të llojit “tokë arë” me sip. 347 m<sup>2</sup>, ka përfituar shumën 175.929 lekë.

198. “Raiffeisen Bank”<sup>90</sup> ka konfirmuar transfertën e shumës 175.929 lekë nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve Tiranë në llogarinë e shtetasit M.Rr., në datën 8.7.2015. Komisioni e përfshiu këtë shumë si të ardhur në analizën financiare të vitit 2015.

199. **Në përfundim të analizimit të kësaj pasurie**, Komisioni konkludon se kjo pasuri është deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin dhe është përfituar në një nga mënyrat e parashikuara në ligj. Nuk konstatohen problematika për procesin e rivlerësimit.

### **Konstatime të tjera gjatë hetimit**

#### ***Lidhur me transfertën në vlerën 2.000.000 lekë në llogarinë e subjektit nga motra e saj***

200. Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se ka transferuar shumën prej 2.000.000 lekësh në llogarinë e motrës së saj Z.Xh., në datën 7.5.2010. Subjekti shpjegon se ky transferim ka ndodhur për arsye se motra e saj ka pasur në llogarinë bankare këtë shumë deri më 18.1.2010, datë në të cilën asaj i është vjedhur portofoli së bashku me kartën e bankës dhe PIN-in e kartës dhe, po në këtë datë, personi që ka vjedhur kartën e bankës ka kryer edhe tërheqje nga llogaria bankare e motrës. Për këtë arsye, për të siguruar shumën që kishte në llogari, motra ia ka transferuar atë subjektit, dhe ky i fundit shpjegon se për këtë vjedhje është bërë kallëzim penal dhe është vendosur pezullimi i hetimeve pasi nuk u gjet autori i vjedhjes.

201. Subjekti ka bashkëlidhur si provë deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 22.1.2020, të motrës, znj. Z.M., së bashku me vendimin e datës 28.10.2010, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për pezullimin e hetimeve për procedimin penal nr. \*\*\*, të vitit 2010, si edhe lëvizje llogarie bankare në emër të motrës së subjektit për periudhën 26.11.2009 – 12.5.2010.

202. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se në lëvizjet e llogarive të subjektit dhe të motrës janë kryer këto transaksione: (a) në datën 28.12.2009 është kryer depozitim në vlerën 2.000.000 lekë me përshkrim “të ardhura nga emigracioni”; (b) në datën 18.1.2010 është transferuar shuma prej 2.000.000 lekësh në favor të subjektit të rivlerësimit me përshkrimin “kalim fondi në llogari të motrës”; (c) po në datën 18.1.2010, subjekti kryen një investim në bono thesari, i

<sup>89</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 14.2.2020.

<sup>90</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.1.2021.

cili maturohet më 15.4.2010; (ç) në datën 7.5.2010, subjekti i kthen motrës shumën 2.000.000 lekë më anë të një transfertë bankare me përshkrimin “kalim fondesh për kthim huaje”; (d) në datën 12.5.2010, motra e subjektit investon shumën 2.503.500 lekë në bono thesari.

203. Në vendimin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, datë 28.10.2010, për pezullimin e hetimeve citohet se: “[...] në veprimet hetimore të kryera në kuadër të këtij procedimi, ka rezultuar se në datën 18 janar 2010, në Komisariatit e Policisë nr. \*\*\* është paraqitur shtetasja Z.M. dhe ka paraqitur kallëzimin për faktin e vjedhjes së portofolit të saj. Referuar akteve të fashikullit të këtij procedimi rezulton se kallëzuesja në datën 18 janar 2010 ka qenë duke udhëtuar me autobusin urban [...]” e më tej “[...]në portofol ajo ka pasur dy karta debiti dhe konkretisht një të ‘Raiffeisen Bank’ dhe një të Bankës Popullore [...]”.

204. Me anë të pyetësorit nr. 4<sup>91</sup>, subjektit iu kërkua të shpjegojë mospërputhjet në deklaratimet e saj dhe atyre të konstatuara në përshkrimin e transfertës bankare lidhur me transferimin e shumës prej 2.000.000 lekësh. Në përgjigje<sup>92</sup>, subjekti sqaron se i përmbahet deklaratimeve në pyetësorin standard dhe se shënimi “kalim fondesh për kthim huaje” është një shënim i përmbledhur shkurt (për shkak se veprimet bankare nuk lejojnë të shënohen shumë fjalë duke qenë se nuk ka hapësirë), vendosur nga punonjësja e bankës dhe që nuk tregon se ka marrë hua shumën prej 2.000.000 lekësh, por ishte vetëm një transferim i përkohshëm nga llogaria e motrës te llogaria e subjektit.

205. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkuan shpjegime në lidhje me konstatimin se *ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit dhe atyre të konstatuara në përshkrimin e transfertës bankare lidhur me transferimin e shumës prej 2.000.000 lekësh.*

206. Subjekti, në përgjigjet e saj me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, në lidhje me këtë konstatim, sqaroi se nga provat e paraqitura provohet plotësisht se shuma prej 2.000.000 lekësh është transferuar në datën 18.1.2010, nga llogaria e motrës Z.M. (Xh.) te llogaria e saj për shkak se motrës i ishte vjedhur portofoli, në të cilin ndodhej kartën e bankës dhe kodi PIN i saj. Kjo provohet edhe nga informacioni për kallëzimin penal dhe vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe nga deklarata noteriale nr. \*\*\*, datë 22.1.2020, e motrës Z.M., që ky transferim ka ndodhur për arsyen e sipërcituar. Në datën 7.5.2010, me transfertë bankare, subjekti i ka kthyer motrës shumën 2.000.000 lekë që i ishte transferuar si më lart. Shënimi që ka bërë punonjësja e bankës “kalim fondesh për kthim huaje” është një shënim i përshkruar shkurtimisht (për shkak se veprimet bankare nuk lejojnë të shënohen shumë fjalë, për shkak hapësire). Ky shënim i palidhur me prova të tjera (provat e tjera mbështesin deklaratimet e subjektit) i vendosur nga punonjësja e bankës nuk tregon se ka marrë hua shumën prej 2.000.000 lekësh – transferimi i përkohshëm ka ndodhur për shkak të fakteve të shpjeguara hollësisht gjatë hetimit administrativ, të cilat subjekti i ka mbështetur edhe me provat e paraqitura. Transferimi i fondeve ka ndodhur vetëm për efekt sigurie dhe për asnjë arsye tjetër. Si konkluzion, subjekti shpjegon se në këto transaksione të kryera prej saj dhe motrës, nuk ka asgjë të kundërligjshme apo të pasaktë.

---

<sup>91</sup>E-mail datë 17.2.2021, ora 15:09.

<sup>92</sup>E-mail datë 19.2.2021, ora 09:38.

207. Komisioni, duke pasur në konsideratë: (i) përgjigjet në pyetësonin standard të subjektit; (ii) përgjigjet e subjektit gjatë hetimit; (iii) provat e administruara gjatë hetimit dhe shqyrtimit të kësaj çështjeje; si dhe (iv) shpjegimet dhe provat e subjektit me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

208. Në analizë të të gjitha deklarimeve dhe provave të administruara, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm mospërputhjet që ekzistojnë.

209. Është e vërtetë që ekziston një përshkrim i qartë në transfertën e bërë për motrën se është kthim huaje, por në vlerësim të të gjitha provave të tjera të depozituara nga subjekti për të provuar se kjo shumë është e motrës së saj, së cilës i kishte humbur karta e debitit, trupi gjykues vlerëson se tej çdo dyshimi të arsyeshëm, subjekti provoi bindshëm se shuma prej 2.000.000 lekësh nuk është e saj.

### **Konkluzioni përfundimtar në lidhje me rivlerësimin e pasurisë**

210. Në përfundim të shqyrtimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues i Komisionit, bazuar në analizën e mësipërme, arrin në këto konkluzione:

- i. Në lidhje me kursimet *cash*, me vlerë 4.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes së likuiditeteve *cash* në vlerën 408.963 lekë, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- ii. Lidhur me kursimet nga paga dhe qiraja e apartamentit, në shumën 133.168,87 lekë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e apartamentit në shumën 1.470.000 lekë, në pronësi të prindërve të bashkëshortit, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e blerjes së kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iii. Lidhur me kursimet *cash* në shumën 900.000 lekë, të krijuara me burim të ardhurat nga qiraja e tokës bujqësore – subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë gjendjen *cash* në deklaratën *Vetting* të vitit 2017 dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e të ardhurave nga qiraja e tokës bujqësore në vlerën 1.200.000 lekë, të ardhura që kanë shërbyer si burim për krijimin e blerjes së kuotave në fondin e Investimit Raiffeisen Prestigj, duke u gjendur brenda parashikimeve të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- iv. Lidhur me blerjen e kuotave në fondin e investimit Raiffeisen Prestigj, vlera 7.556.000 lekë – subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kuotave në fondin e investimeve, në vlerën 3.552.438 lekë, duke u gjendur brenda parashikimeve të germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.
- v. Në përmbledhje të konkluzioneve më lart, bazuar në analizën financiare për pasuritë, shpenzimet dhe të ardhurat e ligjshme të subjektit dhe personave të lidhur, për vitet 2009 – 2016, subjekti i rivlerësimit ka balancë negative për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vlerën – 3 545 602 lekë, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.



Për rrjedhojë, bazuar në pikat 1, 3 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe në geramat “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33 dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në kriterin e pasurisë.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

211. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

212. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*v , datë 16.1.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

213. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit Gentiana Xhelili: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara prej saj në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**214. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili.**

215. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

216. Më tej, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo *indicie* që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo cenim të figurës dhe se nuk ka të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

217. Nga hetimi administrativ i Komisionit nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë subjekti është e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.

218. Në përfundim të hetimit administrativ, si dhe të vlerësimit të provave dhe shpjegimeve të subjektit, Komisioni vlerëson se subjekti ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, si dhe nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit Gentiana Xhelili, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

219. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016, nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

220. Subjekti i rivlerësimit Gentiana Xhelili ka marrë titullin “Jurist” nga Universiteti i Tiranës në datën 30.6.2004 dhe titullin “Magjistrat gjyqtar” nga Shkolla e Magjistraturës në vitin 2009. Pas studimeve, në datën 25.6.2010, është emëruar gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë. Në vijim, në datën 23.4.2014, është emëruar gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ku vazhdon edhe aktualisht.

221. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

222. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në rregulloren “Për vlerësimin etik e profesional të subjekteve në proces rivlerësimi” ka miratuar këtë raport të hollësishëm dhe të arsyetuar të përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Veprimtarisë Etike për përshkrimin dhe analizën e dokumenteve të vlerësimit profesional të subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

223. Ky raport vlerësimi ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të mëposhtme të vlerësimit: (a) aftësive profesionale; (b) aftësive organizative; (c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale; (d) aftësive personale dhe angazhimit profesional. Bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, KLGJ-ja ka vlerësuar si vijon:

224. **Aftësitë profesionale** – subjekti i rivlerësimit Gentiana Xhelili ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara është konstatuar se, në përgjithësi, subjekti identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në një nga rastet e analizuara subjekti e ka trajtuar kërkimin në padi si të natyrës administrative dhe ka gjykuar çështjen, ndërkohë që mbi ankimin e palës, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë e ka prishur vendimin dhe e ka kthyer çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë me arsyetimin se kërkimi është i natyrës civile. Subjekti ka njohuri edhe për ligjet e veçanta dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre, të cilat i interpreton në zgjidhjen e çështjeve, kur është rasti bën interpretimin logjik dhe literal të ligjit, por nuk i referohet praktikës unifikuese të Gjykatës së Lartë.

225. Tri dokumentet e përzgjedhura dhe pesë dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e saj në të drejtën administrative, ku bien në sy konceptet e shterimit të ankimit administrativ dhe pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, fitimi i pronësisë me parashkrim fitues, e drejta e detyrimeve, marrëdhëniet e punës dhe sigurimin e padisë.

226. **Arsyetimi ligjor** - vendimet gjyqësore të hartuara prej subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili janë të qarta, të plota dhe të kuptueshme. Struktura e vendimeve përfundimtare është organizuar sipas kërkesave të legjislacionit procedural dhe e standardizuar. Në dispozitivin e vendimit, në rastet e vëzhguara, është konstatuar se është i plotë dhe rrjedhojë e fakteve dhe analizës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

227. **Aftësitë organizative** - subjekti i rivlerësimit, në periudhën 8.10.2013 – 2.5.2014, ka kryer detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ndërsa në periudhën 2.5.2014 – 8.10.2016 e në vazhdim kryen detyrën e gjyqtarës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, ku vazhdon dhe aktualisht. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë, për periudhën 3.5.2014 – 8.10.2016, konstatohet se subjekti ka përfunduar gjithsej 2052 çështje. Në bazë të germës “c”, të pikës 3, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior gjyqtari administrativ i shkallës së parë, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 450 gjykime çështjesh të tilla për tre vjet. Duke zbatuar këtë rregull, në rastin e subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili konstatohet lehtësisht se ka pasur ngarkesë sasiore tepër të lartë – thuhet 5-fishin e standardit minimal.

228. Subjekti Gentiana Xhelili ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore, zhvillon seancë përgatitore dhe në përgjithësi kur vlerëson se janë kryer veprimet e plota vendos kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Duhet evidentuar se ndër tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara, vetëm një vendim është cenuar nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, por edhe në këtë rast çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë. Ky fakt nënkupton se gjykatat më të larta, me përjashtim të këtij rasti, nuk kanë evidentuar gabime gjyqësore të subjektit.

229. Nga vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura, në përgjithësi, nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në një rast saktësia e fletëthirrjes për orën e seancës është e ndryshme me atë të vendimit për caktimin e seancës. Në dosje gjenden të gjitha aktet e procesit gjyqësor të zhvilluar, si kërkesëpapia, vendimi për kryerjen e veprimeve paraprake, procesverbali i seancave përgatitore apo gjyqësore, fletëthirrjet, provat dhe vendimet përfundimtare. Në një rast është konstatuar mungesa e vendimit të arsyetuar për caktimin e detyrave ekspertit dhe nuk ka deklaratë të plotësuar e nënshkruar nga ekspertja për dijeninë për përgjegjësinë penale për ekspertim të rremë për betimin. Në përgjithësi aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale.

230. **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale** - nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Gentiana Xhelili dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm. Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili, si dhe

nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Në dosjet e vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

**231. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional** - në pesë dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor është konstatuar se gjyqtarja Gentiana Xhelili komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, shfaq sjellje etike, respekton solemnitetin e gjykimit, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve. Subjekti Gentiana Xhelili i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit ka marrë pjesë në 8 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës për një periudhë trevjeçare. Krahas këtyre, subjekti ka deklaruar se ka botuar në revistën “Jeta Juridike” punimin me temë “Padia civile dhe elementët e saj”.

**232. Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së:** sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për subjektin Gentiana Xhelili janë paraqitur 19 ankesa (1 në vitin 2013, 8 ankesa në vitin 2014, 5 në vitin 2015 dhe 5 ankesa në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së; 13 ankesa (4 të vitit 2014, 5 të vitit 2015 dhe 4 të vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, ndër të cilat 3 ankesa me arsyetimin se nuk ka fakte apo rrethana për verifikim të ankesave, 3 ankesa me arsyetimin se mund të zgjidhen përmes apelimit gjyqësor dhe 7 ankesa me arsyetimin se është ankesë e përsëritur më parë; 6 ankesa janë verifikuar dhe rezultoi 1 ankesë e vitit 2013, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, pas verifikimit është vendosur evidentimi për efekt vlerësimi profesional dhe etik të gjyqtarës – 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për zvarritje të gjykimit dhe është vendosur “tërheqje vëmendje me shkrim” dhe evidentim për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës – 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për ligjshmëri vendimi dhe zvarritje të gjykimit nga ana e gjyqtarës, pas verifikimit është sugjeruar evidentim i të dhënave për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës – 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar informacioni ardhur nga kryetari i Gjykatës mbi vendimet e cenuara, pas verifikimit nuk ka rezultuar shkelje nga gjyqtarja – 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për zvarritje gjykimi, pas verifikimit është vendosur evidentimi për efekt të vlerësimit etik dhe profesional dhe 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, pas verifikimit nuk rezultuan shkelje nga gjyqtarja.

233. Gjithashtu rezulton që ministri i Drejtësisë ka paraqitur një kërkesë për procedim disiplinor për gjyqtaren (kërkesë me nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2016, protokolluar në ish-Këshill me nr. \*\*\* prot., datë 4.3.2016) “vërejtje me paralajmërim” (vërejtje publike). Kjo kërkesë është trajtuar në mbledhjen e ish-Këshillit të Lartë të Drejtësisë datë 24.1.2018, ku edhe është rrëzuar dhe nuk është propozuar masë tjetër në seancën plenare (vendimi nr. \*\*\*, datë 24.1.2018, i ish-Këshillit).

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

234. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv dhe ankesave të paraqitura pranë Inspektoratit të KLD-së. Pas analizimit të tyre u konstatuan këto problematika dhe u kërkuan shpjegime e prova për sa vijon.

235. Kohëzgjatja e gjykimit të çështjeve të gjykuara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë<sup>93</sup>, të përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.9.2014, është 3 muaj e 12 ditë, gjithashtu për çështjen e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.10.2014, është 3 muaj e 3 ditë, jashtë standardit kohor 1-mujor të parashikuar në germën “c”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.

236. Lidhur me sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet duke sqaruar se çështja administrative e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.9.2014, është regjistruar në datën 10.6.2014 dhe po këtë datë i është nënshtruar shortimit manual. Pas 4 ditësh, në datën 16.6.2014, pasi ka konstatuar se paditësi nuk ka paguar taksën gjyqësore, me vendim të ndërmjetëm i ka lënë afat për ta paguar deri në datën 30.6.2014. Pasi është paguar taksa e padisë, më 30.6.2014, ka marrë vendimin për kryerjen e veprimeve paraprake duke caktuar seancën e veprimeve përgatitore në datën 10.7.2014. Në afatin e llogaritur është edhe muaji gusht 2014 që është leje vjetore 35 ditë për çdo gjyqtar dhe, për këtë arsye, afati brenda të cilit ka gjykuar këtë çështje në raport me ngarkesën e lartë në punë nuk është afat i gjatë dhe nuk ka krijuar asnjë pasojë te palët ndërgjyqëse.

237. Më tej, subjekti arsyeton se afati i përcaktuar në Aneksin nr. 1 të Sistemit të Vlerësimit i përcaktuar nga KLD-ja në vitin 2010, është vendosur para se të miratohej ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative”. Kohëzgjatja e gjykimit mbi tre muaj për këto çështje, referuar ngarkesës që ka një gjyqtar i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, gjykatë e cila ka pasur gjithmonë mungesë organike në gjyqtarë është një afat i shkurtër dhe jo i gjatë. Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative”, ka parashikuar afate të caktuara lidhur me veprime të veçanta procedurale, por nuk ka përcaktuar afate për përfundimin e gjykimit të një çështjeje administrative. Edhe kur respektohet afati 7-ditor nga gjyqtari për të kryer veprime përgatitore, përsëri gjyqtari ka të drejtë të nxjerrë urdhrin për seancën gjyqësore, e cila mund të caktohet deri në 15 ditë. Pra, deri në seancën gjyqësore, gjykimi shkon 22 ditë minimale për një çështje që nuk ka nevojë që për zgjidhjen e saj të kërkohen njohuri të posaçme me ekspert, pasi në këtë rast eksperti ka të drejtë të kërkojë 20 ditë afat për kryerjen e aktekspertimit. Po kështu, subjekti vijon të shpjegojë se kur palët kërkojnë kohë për pretendime përfundimtare gjykata u jep 5 ditë afat, pra në total minimumi i afatit që një gjyqtar administrativ ka mundësi të gjykojë çështjen është 47 ditë.

238. Lidhur me çështjen administrative nr. \*\*\*, datë 5.5.2014 regjistrimi, që i përket paditësit L. T. kundër të paditurit DRSSH Vlorë, me objekt “detyrimin e palës së paditur të më njohë periudhën 1.12.2000 – 21.7.2009 si mësuese në shkollën PLM Vlorë ...”, përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.6.2014.

239. Çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, në datën 5.5.2014 dhe me shortin manual të datës 12.5.2014, i është caktuar subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili. Veprimi 1 përgatitor është zhvilluar në datën 15.5.2014 (jashtë afatit 7-ditor nga paraqitja e padisë së parashikuar në pikën 1, të nenit 25, të ligjit nr. 49/2012), në dhomë këshillimi, pa praninë e palëve dhe është dokumentuar me procesverbal të mbajtur nga

---

<sup>93</sup>Dokumentet nr. 1 dhe nr. 2, pjesë e 3 dokumneteve të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit.

sekretarja gjyqësore M. M. Në këtë rast është me vend të nënvizohet fakti se ky veprim përgatitor është kryer nga subjekti 3 ditë pas datës së shortimit.

240. Pasi ka konstatuar se padia është pa të meta, gjyqtarja ka vendosur të caktojë seancën përgatitore më 26.5.2014, ora 13:30, duke urdhëruar njoftimin e palëve dhe njoftimin e të paditurit padinë dhe kopje të akteve shoqëruese, si dhe për depozitimin në sekretari, brenda 10 ditëve nga njoftimi, të prapësimeve me shkrim dhe akteve të plota shkresore, listës së dëshmitarëve, ekspertëve dhe adresat e tyre, si dhe t'u bëhej e ditur palëve se mosparaqitja në veprimet përgatitore nuk bëhet shkak për moszhvillimin e gjykimit. Procesverbal i është nënshkruar rregullisht nga gjyqtarja dhe sekretarja gjyqësore. Planifikimi i seancës gjyqësore është bërë brenda afatit 15-ditor, të parashikuar në nenin 27/1 të ligjit nr. 49/2012.

241. Seanca 1 përgatitore e datës 26.5.2014 është çelur në orën 11:30 (në aktin e njoftimit dhe në procesverbalin e veprimit përgatitor është planifikuar në orën 13:30) dhe është dokumentuar me procesverbal. Seanca është zhvilluar në prani të palës paditëse. Pala e paditur nuk është paraqitur, në procesverbalin gjyqësor është pasqyruar se ka dijeni rregullisht me fletëthirrjen e datës 15.5.2014 (në dosje është kopja e letërthirrjes datë 15.5.2014, në të cilën është shënuar për t'u paraqitur në orën 13:30). Gjyqtarja, në referim të nenit 25 e vijues të ligjit nr. 49/2012 ka vendosur vazhdimin e seancës përgatitore, ku i jepet fjala palës paditëse, e cila lexon kërkesëpadinë. Gjykata, pasi shqyrton pretendimet e palës paditëse, vendos të caktojë ekspertin kontabël M.S. pala paditëse dakord. Gjykata cakton detyrat për ekspertin dhe tarifën që duhet të parapaguhet për kryerjen e ekspertimit dhe cakton datën e seancës gjyqësore më 5.6.2014, ora 11:30 dhe urdhëron palët ndërgjyqëse se 3 ditë para seancës gjyqësore të depozitojnë në sekretari provat në dobi të gjykimit, duke i paralajmëruar për pasojat sipas nenit 27/3 të ligjit nr. 49/2012. Në dosje ndodhet urdhri "Për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore", edhe vendimi i arsyetuar për caktimin e ekspertit. Nuk është pasqyruar ora e mbylljes së seancës. Planifikimi i seancës është pas 9 ditëve, brenda afatit 15-ditor, të parashikuar në nenin 27/1 të ligjit nr. 49/2012. Seanca 2 gjyqësore datë 5.6.2014 është çelur në orën 11:30 dhe është dokumentuar me procesverbal. Është paraqitur pala paditëse dhe nuk është paraqitur pala e paditur, ka njoftim (në dosje është akti i njoftimit). Gjykata ka vendosur vazhdimin e seancës gjyqësore referuar pikës 2, të nenit 34, të ligjit nr. 49/2012. Pasi i shpjegohen të drejtat dhe detyrimet procedurale është shpallur përbërja e trupit gjykues dhe e sekretares dhe nuk ka pasur kundërshtime dhe as kërkesa paraprake. I jepet fjala palës paditëse për të dhënë shpjegime në lidhje me kërkesën dhe provat. Paditësi lexon kërkesëpadinë dhe paraqet provat, duke i listuar ato. Pyetet pala paditëse në lidhje me aktekspertimin, e cila deklaron se është njohur me aktin dhe është dakord. Gjykata ka vendosur të lejojë marrjen e provave shkresore. Në vijim, gjykata ka vendosur të administrojë provat e lejuara të merren për shqyrtim, duke i listuar, i jepet fund hetimit gjyqësor dhe i jepet fjala palës paditëse për të paraqitur diskutimin përfundimtar. Pala paditëse deklaron se i qëndron kërkesëpadisë dhe përfundimisht kërkon pranimin e padisë.

242. Gjykata është tërhequr për vendim dhe në kthim ka shpallur vendimin nr. \*\*\*, datë 5.6.2014, me të cilin është vendosur pranimi i kërkesëpadisë. Procesverbal i është nënshkruar rregullisht nga gjyqtarja dhe sekretarja asistuese. Nuk është pasqyruar ora e mbylljes së seancës.

243. Pala e paditur ka paraqitur ankim kundër vendimit gjyqësor. Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.6.2016, ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 5.6.2014, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, me arsyetimin se kërkimi në padi është i natyrës civile, për rrjedhojë gjykata administrative nuk ka kompetencë lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje në bazë të nenit 8 të ligjit nr. 49/2012. Pala e paditur ka paraqitur rekurs dhe çështja është regjistruar në nr. \*\*\*, datë 27.3.2019, në Gjykatën e Lartë. Dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar nga gjyqtarja në sekretarinë gjyqësore në datën 9.6.2014, pas 4 ditëve nga shpallja e vendimit, brenda afatit 7-ditor të përcaktuar nga pika 3, e nenit 42, të ligjit nr. 49/2012. Gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit është realizuar për 1 muaj, në intervalin kohor 5.5.2014 - 5.6.2014. Kohëzgjatja e gjykimit është brenda afatit standard 1-mujor, të përcaktuar nga germa “c”, e pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit<sup>94</sup>.

244. Procesverbali i seancës gjyqësore është i plotë, me të gjitha të dhënat dhe përshkrimet për veprimet procedurale të kryera, sipas kërkesave të nenit 118 të Kodit të Procedurave Civile. Dosja paraqitet e inventarizuar rregullisht. Mënyra e komunikimit është në përputhje me etikën gjyqësore dhe e qartë. Vendimi gjyqësor përmban elementët e nenit 41 të ligjit nr. 49/2012 dhe të nenit 310 të Kodit të Procedurave Civile. Ai është i ndarë në pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe në dispozitivin e gjykatës.

245. Komisioni vëren se Gjykata Administrative e Apelit e ka prishur vendimin dhe e ka dërguar çështjen për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, *me arsyetimin se kërkimi në padi është i natyrës civile, për rrjedhojë gjykata administrative nuk ka kompetencë lëndore për gjykimin e kësaj çështjeje*. Vendimi në shkallë të parë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit. Subjekti nuk ka përcaktuar drejt natyrën juridike të mosmarrëveshjes dhe nuk ka bërë një identifikim të elementeve dhe/ose kritereve ligjore që për rastin konkret shërbejnë për përcaktimin e kompetencës lëndore.

246. **Komisioni konstatoi në rezultatet e hetimit se:** (i) ora e çeljes së seancës përgatitore (11:30) nuk korrespondon me orën e përcaktuar në vendimin e datës 15.5.2015 dhe aktin e njoftimit (13:30); (ii) nuk është përcaktuar drejt natyra juridike e mosmarrëveshjes nga ana e subjektit lidhur me përcaktimin e kompetencës lëndore për gjykimin e çështjes.

247. **Në prapësime, subjekti deklaroi se:** (i) lidhur me gjetjen e Komisionit se ora e çeljes së seancës përgatitore (11:30) nuk korrespondon me orën e përcaktuar në vendimin e datës 15.5.2015 dhe aktin e njoftimit (13:30), është një lapsus nga sekretarja gjyqësore për shkak të ngarkesës së madhe që ka pasur në atë muaj dhe atë ditë, konkretisht 20 gjyqe, thjesht është vendosur gabim ora në procesverbal, pasi gjyqi zhvillohet gjithmonë në orën kur janë njoftuar palët me fletëthirrje, edhe njoftimi sipas procesverbalit të posaçëm të njoftimit për paditësen është në datën 26.5.2014, ora 13:30; (ii) lidhur me faktin se nuk është përcaktuar drejt natyra juridike e mosmarrëveshjes për përcaktimin e kompetencës lëndore, subjekti sqaroi se kjo çështje është ende në gjykim në Gjykatën e Lartë për shkak të rekursit që ka bërë pala e paditur DRSSH Vlorë kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

---

<sup>94</sup>Për qëllime të këtij raporti, Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, të KLD-së “Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”, së bashku me Aneksin I “Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”.

248.Pasi ka tërhequr një kopje të dosjes në Gjykatën e Lartë, rezulton se në dosje janë dy vendime të Gjykatës së Apelit Administrativ lidhur me këtë çështje, konkretisht vendimi nr. \*\*\*, datë 16.6.2016, e cila ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 5.6.2014, dhe kthimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, si dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 14.11.2018, i po të njëjtës gjykatë (pra, i njëjti trup gjykues) që ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 5.6.2014. Subjekti deklaron se ka përcaktuar drejt natyrën juridike të mosmarrëveshjes, por është Gjykata e Apelit Administrativ që ka gabuar në vendimin nr. \*\*\* datë 15.6.2016, por e ka lënë në fuqi vendimin e subjektit me vendimin nr. \*\*\*, datë 14.11.2018. Rasti objekt gjykimi nuk është para vërtetimit të faktit të qenies në marrëdhënie pune, për arsye se fakti i marrëdhënies së punës vërtetohet dhe pranohet nga DRSSH-ja Vlorë, por nuk llogaritet kjo vjetërsi sepse interpretohej jo drejt nga pala e paditur DRSSH Vlorë.

249.Më tej, subjekti sqaron se të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. \*\*\*, datë 15.12.2020, ku ka marrë në shqyrtim kërkesën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për konfliktin e kompetencës me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Objekti i kësaj çështjeje është njohja e viteve të punës për efekt pensioni, të kryera gjatë vuajtjes së dënimit penal në institucionin e ekzekutimit penal. Në vendimin e saj, Gjykata e Lartë ka përcaktuar Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë si gjykatë kompetente dhe jo Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me argumentin se *në rastin konkret kërkimi i palës paditëse nuk është vërtetimi i faktit juridik, por refuzimi i palës së paditur DRSSH Vlorë për të njohur vjetërsinë e punës për periudhën nga vitit 1992 deri në vitin 2002 që ka punuar në IEVP*, si në rastin e paditëses L. T., e cila kundërshton refuzimin e DRSSH-së Vlorë që të përfshijë në llogaritje në masën e pensionit periudhën që ka punuar si mësuese në shkollën P.L.M Vlorë.

250.Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit pranoi që është një lapsus nga ana e sekretarisë gjyqësore në lidhje me orën e çeljes së seancës gjyqësore, me atë të përcaktuar në vendimin përfundimtar dhe aktin e njoftimit. Në lidhje me konstatimin e dytë, pasi u analizua vendimi nr. \*\*\*, datë 15.12.2020, i Kolegjit të Gjykatës së Lartë, i paraqitur nga subjekti për analogji me rastin objekt gjykimi, Komisioni vlerëson se fakti që subjekti paraqiti një vendim të unifikuar të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë në lidhje me çështje analoge, tregon se subjekti ka interpretuar drejt ligjin në lidhje me këtë çështje.

251.Lidhur me çështjen administrative nr. \*\*\*, datë 13.11.2014 regjistrimi, me palë paditëse Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë kundër të paditurit O.L., me objekt “shlyerje detyrimi monetar”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.1.2015, Komisioni konstatoi gjatë hetimit se: *Kohëzgjatja e gjykimit është 1 muaj e 28 ditë, jashtë standardit kohor 1-mujor të parashikuar në germën “c”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit.*

252.Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se shorti për këtë çështje është hedhur në datën 13.11.2014 dhe në datën 17.11.2014 brenda 4 ditëve nga hedhja e shortit dhe e regjistrimit të padisë ka caktuar seancën për veprime përgatitore në datën 4.12.2014, ora 11:30. Kjo seancë është shtyrë pasi pala e paditur O. L. nuk kishte dijeni për gjykimin. Për këtë arsye është caktuar një seancë tjetër, në datën 17.12.2014, brenda 13 ditësh, ku është vendosur kalimi në seancë gjyqësore. Seanca gjyqësore është caktuar në datën 8.1.2015, ora 10:30, pasi në fund të vitit dhe në fillim të vitit pasardhës kryhet procesi i mbartjeve të dosjeve gjyqësore. Në raport me



ngarkesën e punës, subjekti deklaroi se afati i gjykimit 1 muaj e 28 ditë nuk është afat i gjatë dhe nuk ka krijuar asnjë pasojë të palët ndërgjyqëse.

**253. Arsyetimi ligjor i Komisionit** - subjekti arriti të shpjegojë bindshëm se nuk ka pasur menaxhim të dobët lidhur me gjykimin dhe përfundimin e kësaj çështjeje dhe asnjë nga seancat nuk është shtyrë si rezultat i neglizhencës së tij.

254. Lidhur me çështjen administrative nr. \*\*\*, datë 28.10.2014 regjistrimi, që i përket paditësit D.H. kundër të paditurve ZVRPP Vlorë dhe Komuna B., me objekt “detyrimin e të paditurit të korigjojë sipërfaqen e tokës në pronësi të paditësit dhe regjistrimin e saj në regjistrat përkatës në pronësinë e të paditurit; detyrimin e Komunës B. të njohë paditësin pronar mbi një sipërfaqe toke prej 2616 m<sup>2</sup>”, e përfunduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 22.1.2015, Komisioni konstatoi se: (i) referuar akteve në dosje nuk ka të dhëna në lidhje me caktimin e detyrave të ekspertit, afatin e kryerjes së ekspertimit, deklaratën e nënshkruar nga eksperti për dijeninë e tij për përgjegjësinë penale për ekspertim të rremë, betimin për detyrat që i janë besuar, për rrjedhojë nuk janë zbatuar parashikimet e nenit 25/c të ligjit nr. 49/2012; (ii) kohëzgjatja e gjykimit është 2 muaj e 25 ditë, jashtë standardit kohor 1-mujor të parashikuar në germën “c”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit; (iii) dosja gjyqësore dhe vendimi gjyqësor janë depozituar në sekretarinë gjyqësore në datën 10.2.2015, pas 19 ditëve nga shpallja e vendimit, jashtë afatit 7-ditor të përcaktuar nga pika 3, e nenit 42, të ligjit nr. 49/2012; (iv) seanca gjyqësore e datës 22.12.2014 për paraqitjen e diskutimeve përfundimtare është caktuar pas 1 muaji, pra jashtë afatit 15-ditor të parashikuar në nenin 27/1 të ligjit nr. 49/2012.

**255. Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se:** (i) lidhur me konstatimin e parë, sipas nenit 25 të ligjit nr. 49/20123, në cilësinë e kryetares së seancës ka urdhëruar kryerjen e ekspertimit në seancën e veprimeve përgatitore të datës 18.11.2014. Kjo seancë është shtyrë dhe është zhvilluar përsëri seancë e veprimeve përgatitore në datën 10.12.2014, ku dhe janë caktuar pyetjet për ekspertin, por gabimisht nga sekretarja gjyqësore për shkak të ngarkesës shumë të madhe në punë nuk është cituar në procesverbal se ekspertja ka qenë prezent dhe ka marrë detyrat. Fakti që ka marrë detyrat vërtetohet edhe nga pyetjet që pala paditëse ka bërë për ekspertin në datën 10.12.2014, pyetje të cilat gjenden në faqen 22 të dosjes së listuar. Në aktekspertimin në faqen nr. 2, citohet: “Pyetjet e drejtuara nga trupi gjykues janë: 1. Të hartohet planvendosja e pasurisë sipas dok. të ndodhur në dosje, certifikatës së pasurisë për objektin me nr. pasurie \*\*\*, me sipërfaqe 115 m<sup>2</sup> dhe truall 300 m<sup>2</sup>, ndodhur në z. k. nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*. 2...”. Po kështu, edhe fakti se në dispozitivin e vendimit është parashikuar detyrimi i palës së paditur ZVRPP-ja Vlorë të regjistrojë pasurinë në emër të palës paditëse sipas planrilevimit të ekspertes, pjesë përbërëse e këtij vendimi, çka tregon faktin se jemi para një lapsusi të sekretares gjyqësore, e cila nuk ka përshtetur veprimet procedurale të caktimit të detyrave të ekspertes dhe betimit para gjykatës. Për të provuar deklaratimet e saj, subjekti paraqiti në cilësinë e provës kërkesën e palës paditëse për pyetjet e ekspertes topografe (faqe nr. \*\*\* e dosjes së numërtuar), faqen nr. \*\*\* të aktekspertimit ku ekspertja citon detyrat e lëna nga gjykata (faqe nr. \*\*\* e dosjes së numërtuar); (ii) lidhur me konstatimin e dytë subjekti sqaroi se dosja është regjistruar në datën 28.10.2014 dhe i është nënshtruar shortit më 30.10.2014. Në datën 4.11.2014, brenda afatit, ka kryer veprimet paraprake për çështjen duke caktuar si seancë të veprimeve përgatitore datën 18.11.2014. Në datën 18.11.2014 ka çelur

seancën e veprimeve përgatitore dhe për të njoftuar përfaqësuesen e Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Vlorë, ka shtyrë seancën për në datën 10.12.2014. Në këtë datë është kërkuar nga pala paditëse rregullimi i ndërgjyqësisë, gjykata e ka pranuar kërkesën, si dhe ka caktuar kryerjen e ekspertimit duke përcaktuar detyrat. Në datën 22.12.2014 është zhvilluar seanca gjyqësore dhe mbi kërkesën e palës paditëse i është lënë afat për paraqitjen e pretendimeve përfundimtare. Data për pretendime përfundimtare është caktuar në janar të vitit 2015, pasi në fund të muajit dhjetor dhe në fillim të muajit janar të çdo viti gjykata ka më shumë ngarkesë pasi të gjithë vendimet e shpallura duhet të arsyetohen brenda vitit dhe në çdo fundvit kryhet procesi i mbartjeve të dosjeve që zgjat rreth 20 ditë. Sa më sipër, në raport më të gjithë ngarkesën, subjekti deklaroi se afati i gjykimit 2 muaj e 25 ditë nuk është afat i gjatë dhe nuk ka krijuar asnjë pasojë te palët ndërgjyqëse; (iii) lidhur me konstatimin e tretë, subjekti sqaroi se afati 19 ditë përfshin edhe afatin që sekretarja gjyqësore e ka dorëzuar në sekretarinë e gjykatës pasi nuk është shënuar data kur subjekti e ka dorëzuar te sekretarja gjyqësore. Po kështu, afati 7-ditor është vendosur për një ngarkesë mesatare 150 çështje në vit dhe jo për 770 çështje në vit që ka gjykuar subjekti. Gjithashtu, nuk ka ardhur asnjë pasojë nga kjo vonesë; (iv) lidhur me konstatimin e fundit të Komisionit, subjekti shpjegoi se seanca gjyqësore është caktuar pas një muaji si rezultat i ngarkesës që ka pasur në muajin dhjetor dhe për shkak të procesit të mbartjeve që kryente çdo gjykatë në fund dhe fillim të vitit, gjë e cila kërkon një afat rreth 20 ditë. Për të provuar këtë fakt, subjekti dorëzoi urdhrin nr. \*\*\* prot., datë 11.1.2016, të kryetarit të Gjykatës Administrative së Shkallës së Parë Vlorë.

**256. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – subjekti arriti të provojë faktin se gjatë gjykimit të kësaj çështjeje janë kryer procedurat e nevojshme për caktimin e ekspertit dhe detyrat e lëna nga gjykata, vërtetuar kjo me kërkesën e palës paditëse datë 10.12.2014, ku janë drejtuar pyetjet ndaj ekspertit topografe (faqe nr. \*\*\* e dosjes së numërtuar), si dhe aktekspertimin ku ekspertja citon detyrat e lëna nga gjykata (faqe \*\*\* e dosjes së numërtuar). Lidhur me konstatimet e tjera të Komisionit, subjekti, gjatë të gjitha fazave të gjykimit deri në shpalljen e vendimit përfundimtar, ka pasur vonesa në ndjekjen e procedurave, vonesa të cilat tregojnë një organizim jo të mirë të punës së subjektit. Gjithsesi, të analizuar më vete, këto vonesa nuk mund të ngrihen në nivelin e një shkakut për shkarkimin e subjektit.

257. Komisioni kërkoi informacion pranë Ministrisë së Drejtësisë<sup>95</sup>, në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj saj, nga periudha 2006 e deri më sot. Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 29.12.2020, të Ministrisë së Drejtësisë, vërehet se ndaj subjektit Gentiana Xhelili janë depozituar 4 ankesa<sup>96</sup>, në të cilat ngrihen pretendime që konsistojnë në zgjidhjen në themel të çështjes dhe që janë objekt shqyrtimi nga një gjykatë më e lartë.

258. Më tej, Komisioni vëren se Ministria e Drejtësisë ka iniciuar një procedim disiplinor në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, lidhur me shkeljet e konstatuara në gjykimin e çështjes administrative me palë paditëse: E. K., E. B., V. B., K. B., palë e paditur ZVRPP-ja Vlorë, ZQRPP-ja Tiranë; person i tretë Avokatura e Shtetit Vlorë, me objekt “kundërshtim akti

---

<sup>95</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2020.

<sup>96</sup>Ankesa e vitit 2009 e shtetasit B.P.; ankesa e vitit 2016 e shtetasit G.M.; ankesa e vitit 2018 e shtetasit E.B.; ankesa e vitit 2018 e shtetasit Th.D.

administrativ nr. \*\*\* prot., datë 2.10.2014, të ZVRPP-së Vlorë dhe aktin administrativ me nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2014, të ZQRPP-së. Detyrimin e ZVRPP-së Vlorë të kryejë regjistrimin fillestar të pronës – për trashëgimtarët sipas AMTP-së në emër të babait tonë të ndjerë A.B. dhe vendimit nr. \*\*\*, datë 20.1.2000, të Bashkisë Himarë, z. k. \*\*\*, Gj., si dhe të pajisem me certifikatë pronësie”. Ky inspektim u iniciua mbi bazën e ankesës së paraqitur pranë Ministrisë së Drejtësisë nga Task-Forca për Verifikimin e Ligjshmërisë dhe Mënyrës së Tjetërsimit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, pranë Kryeministrisë. Ministri i Drejtësisë i ka propozuar KLD-së iniciimin e procedimit disiplinor ndaj subjektit Gentiana Xhelili, si dhe marrjen e masës disiplinore “vërejtje me paralajmërim (vërejtje publike)”. KLD-ja, me vendimin nr. \*\*\*, datë 24.1.2018, “Për shqyrtimin e kërkesës për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarës Gentiana Xhelili”, ka vendosur rrëzimin e kërkesës.

259. Nga hetimi i Komisionit rezultuan problematika në gjykimin e kësaj çështjeje<sup>97</sup>, tregues të keqmenaxhimit dhe administrimit jo të rregullt ligjor të këtij procesi gjyqësor nga subjekti

---

<sup>97</sup>Analiza e çështjes - në përfundim të gjykitimit, subjekti me anë të vendimit nr. \*\*\*, datë 19.2.2015, ka vendosur pranimin e padisë. Vendimi u është komunikuar palëve në mungesë sipas vendimit, respektivisht: Zyrës së Avokatit të Shtetit Vlorë, ka marrë dijeni më 13.3.2015 dhe ZQRPP-ja Tiranë, që ka marrë dijeni më 16.3.2015. Ndaj tij nuk është ushtruar ankim dhe vendimi ka marrë formë të prerë më 31.3.2015. Në këtë gjykim është zhvilluar 1 seancë përgatitore dhe 4 seanca gjyqësore. Subjekti në datën 17.11.2015, datë në të cilën çështja i ka kaluar me short, ka marrë vendim mbi kryerjen e veprimeve paraprake dhe caktimi i seancës në datën 11.12.2014. Seanca e fundit gjyqësore është mbajtur më 19.2.2015, në prezencë të palës paditëse, përfaqësuar me prokurë të posaçme nga paditësi K.B. dhe avokati; në mungesë të palëve të paditura dhe palës së tretë Avokatura e Shtetit Vlorë. Në procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 19.2.2015, datë në të cilën është shpallur dhe vendimi përfundimtar, citohet shprehimisht se: “U thirr dhe nuk u paraqit ZVRPP-ja Vlorë, në mungesë”, pra pala ka qenë në mungesë. Ndërkohë në pjesën hyrëse të vendimit të arsyetuar, citohet se: “... të paditur: Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, përfaqësuar në gjykim me autorizimin nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2014, nga S.K. dhe nga E.R., me autorizimin nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2015..., dëgjoi përfaqësuesen e palës së paditur ZVRPP Vlorë, e cila kërkoi rrëzimin e kërkesëpadisë”, pra sipas vendimit pala ka qenë e pranishme në gjykim. Rezulton mospërputhje e plotë midis fakteve të pasqyruara në procesverbalin e seancës së shpalljes së vendimit dhe atyre të pasqyruara në vendimin e arsyetuar dhe të zbardhur, të administruar në dosjen gjyqësore.

Subjekti, në prapësimet e tij, pas aktit të inspektimit nga Ministria e Drejtësisë, pretendon se pasqyrimi në vendim i prezencës së ZVRPP-së Vlorë, është një lapsus. Por Komisioni vëren se kjo gjë ka bërë që vendimi të marrë formë të prerë pa u njoftuar pala e paditur ZVRPP Vlorë, me pasojë humbjen e së drejtës kushtetuese e ligjore për ushtrimin e ankimit. Rezulton se pas marrjes dijeni në rrugë jo zyrtare, pala e paditur ZVRPP Vlorë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë me kërkesën nr. \*\*\* prot., datë 22.4.2015, me objekt “Kundërshtimin e vendimit me nr. \*\*\*, datë 19.02.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë”. Lidhur me këtë kërkesë, subjekti me vendimin nr. \*\*\*, vendosi pushimin e çështjes pasi ZVRPP-ja Vlorë rezultoi të ketë hequr dorë nga kërkesa. Për sa rezultoi, Komisioni vëren se subjekti edhe pasi ka rënë në dijeni të gabimit material në vendim, nuk rezultoi që ta ketë korrigjuar kryesisht atë, sipas parashikimeve të nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile.

Gjithashtu, në vendim paraqiten të dhëna të pasakta nëpërmjet referimit në akte shkresore që nuk kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi. Konkretisht, në pjesën hyrëse të vendimit pasqyrohet prezenca e të paditurit, ZVRPP Vlorë, përfaqësuar në gjykim me autorizimin nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2014, nga shtetasit S. K. dhe nga E. R., me autorizimin nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2015. Ndërkohë që ky autorizim (i administruar në faqen 42 të dosjes gjyqësore) është në emër të paditësit F.K., që i përket një tjetër çështjeje gjyqësore dhe jo çështjes me paditëse E.K. Po kështu edhe autorizimi nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2014, i cituar më sipër, është lëshuar për seancën e datës 11.12.2014 dhe jo seancës së datës 19.2.2015. Komisioni vëren se ZVRPP-ja Vlorë bën me dije se autorizimet i lëshon vetëm për seancën gjyqësore të një date të caktuar, pra autorizimi ka vlerë vetëm për një seancë. Referuar dokumenteve bashkëlidhur ankesës së paraqitur nga Task-Forca për Verifikimin e Ligjshmërisë dhe Mënyrës së Tjetërsimit të Pronave të Paluajtshme Shtetërore, pranë Kryeministrisë, ka rezultuar edhe prezenca e një tjetër procesverbali gjyqësor të datës 19.2.2015, ndryshe nga ai i administruar në dosjen gjyqësore. Pra, rezultojnë dy procesverbale me të dhëna të kundërta lidhur me prezencën e ZVRPP-së Vlorë në seancën e dhënies së vendimit, datë 19.2.2015. Sipas ankesës, të dyja procesverbalet përmbanin të dhëna të ndryshme. Konkretisht: në datën 20.4.2015, ditën kur ZVRPP-ja Vlorë vihet në dijeni, në mënyrë jozyrtare, për vendimin nr. \*\*\*, datë 19.2.2015, ka tërhequr procesverbalin e datës 19.2.2015, i njehsuar me origjinalin, sipas të cilit shprehimisht citohet: “... u thirr u paraqit Zyra Vendore e Regjistrimit të Paluajtshme Vlorë përfaqësuar me autorizimin nr. \*\*\* prot., datë 5.2.2015, nga E.R., ...”. Ndërsa, në datën 5.5.2015, ZVRPP-së Vlorë i është vënë në dispozicion dosja e kërkuar, në formën e kopjes së njehsuar me origjinalin. Në dosje ndodhet procesverbali i datës 19.2.2015, nga ku rezultoi e shënuar: “U thirr nuk u paraqit ZVRPP-ja Vlorë me autorizimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2015”.

Gentiana Xhelili, në kundërshtim me nenin 4 të Kodit të Procedurës Civile, të tilla si mospërputhja e procesverbalit me vendimin; administrimi dhe referimi në akte përfaqësimi që nuk kanë lidhje me çështjen; ekzistenca e dy procesverbaleve me përmbajtje të kundërta, mosmbajtja e procesverbalit gjyqësor në 1 seancë; dorëzimi me vonesë i vendimit të arsyetuar në kryesekretari.

**260. Komisioni kërkoi shpjegime** për këto konstatime: (i) ka mospërputhje të plotë midis fakteve të pasqyruara në procesverbalin e seancës së shpalljes së vendimit dhe atyre të pasqyruara në vendimin e arsyetuar dhe të zbardhur, të administruar në dosjen gjyqësore; (ii) subjekti edhe pasi ka rënë në dijeni të gabimit material në vendim nuk rezulton që ta ketë korrigjuar kryesisht atë, sipas parashikimeve të nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile; (iii) në vendim paraqiten të dhëna të pasakta nëpërmjet referimit në akte shkresore që nuk kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi; (iv) rezultojnë dy procesverbale me të dhëna të kundërta lidhur me prezencën e ZVRPP-së Vlorë në seancën e dhënies së vendimit, datë 19.2.2015; (v) nuk është mbajtur procesverbal për seancën e pazhvilluar të datës 12.2.2014, e cila ishte planifikuar për diskutimet përfundimtare të palëve, në kundërshtim me parashikimet e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile; (vi) vendimi i arsyetuar së bashku me dosjen gjyqësore është dorëzuar në sekretarinë gjyqësore datë 2.3.2015, pas 11 ditësh, pra 4 ditë jashtë afatit të parashikuar nga neni 42/3 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar sipas të cilit: *“Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore”*; (vii) mospasqyrimi i saktë në vendim i prezencës së ZVRPP-së Vlorë ka bërë që vendimi të marrë formë të prerë pa u njoftuar kjo palë, me pasojë humbjen e së drejtës kushtetuese dhe ligjore për ushtrimin e ankimit.

**261. Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se:** (i) në rastin kur ka mospërputhje midis një procesverbali gjyqësor dhe vendimit të zbardhur nuk jemi para një shkeljeje, por një gabimi material që Kodi i Procedurës Civile e parashikon. Ky gabim material nuk i ka sjellë palës së paditur humbjen e së drejtës kushtetuese të ankimit, pasi pala e paditur në momentin që e ka konstatuar këtë gabim ka paraqitur në gjykatë kërkesën për ndreqje gabimi të vendimit. Kjo kërkesë është regjistruar në gjykatë në datën 24.4.2015 dhe vetëm 4 ditë më vonë ZVRPP-ja Vlorë ka bërë kërkesë për heqje dorë nga korrigjimi i gabimit. Në këto kushte, gjykata, bazuar në nenet 25 dhe 39 të ligjit nr. 49/2012, ka vendosur pushimin e gjykimit. Megjithatë, gjykata kryesisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 7.10.2016, ka vendosur të korrigjojë vendimin nr. \*\*\*,

---

Pra rezulton se të dyja procesverbalet e datës 19.2.2015 janë të firmosura nga subjekti Gentiana Xhelili dhe nga sekretarja gjyqësore, kanë të njëjtin numër faqe \*\*\*, si dhe të njëjtin numër rendor të administrimit të dosjes gjyqësore \*\*\*. E pyetur nga grupi i inspektimit lidhur me ekzistencën e dy procesverbaleve të datës 19.2.2015 dhe nënshkrimin e tyre, subjekti në prapësime shprehet se nuk i kujtohej nëse përfaqësuesja e ZVRPP-së Vlorë ka qenë apo jo prezent në seancën e datës 19.2.2015, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe mbingarkesës së madhe, ndërsa lidhur me nënshkrimin e këtyre dy procesverbaleve sqaroi se nga ana vizuale i ngjason si nënshkrimi i tij, por nuk ishte në gjendje të saktësonte se si kanë dalë 2 procesverbale të ndryshme. Komisioni vëren se në aktin e inspektimit, Ministria e Drejtësisë lidhur me ekzistencën e dy procesverbaleve të datës 19.2.2015, me përmbajtje të ndryshme, shprehet se është vlerësim i organit të prokurorisë dhe gjykatës për hetimin e faktit penal dhe të përgjegjësisë penale.

Më tej, rezulton edhe një tjetër parregullsi në administrimin e akteve të këtij gjykimi, pasi për seancën e pazhvilluar të datës 12.2.2014, e cila ishte planifikuar për diskutimet përfundimtare të palëve, nuk është mbajtur procesverbal me shtypshkrim, dorëshkrim apo regjistrim audio nga sekretarja gjyqësore, në kundërshtim me parashikimet e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile. Vendimi i arsyetuar së bashku me dosjen gjyqësore janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore datë 2.3.2015, pas 11 ditësh, pra 4 ditë jashtë afatit të parashikuar nga neni 42/3 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar sipas të cilit: *“Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore”*.

datë 19.2.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke e saktësuar mungesën e palës së paditur në seancën e fundit të shpalljes së vendimit përfundimtar. Pasi ky vendim ka marrë formë të prerë, ZVRPP-ja Vlorë ka bërë ankim në datën 2.3.2017, kjo çështje është regjistruar në Gjykatën e Apelit Administrativ, pra palës së paditur ZVRPP-ja Vlorë nuk i është mohuar dhe as shkelur e drejta e ankimit. Aktualisht kjo çështje ka përfunduar dhe Gjykata e Apelit Administrativ me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.12.2018, ka vendosur të pushojë gjykimin pasi pala e paditur ZVRPP-ja Vlorë e ka paraqitur ankimin jashtë afatit 15-ditor duke marrë formë të prerë vendimi nr. \*\*\*, datë 19.2.2015, i dhënë prej subjektit. Aktualisht kjo çështje është në Gjykatën e Lartë. Po ashtu, rezulton se vendimi nr. \*\*\*, datë 19.2.2015, i Gjykatës Administrative Vlorë, meqenëse këto palë kanë qenë në mungesë u është komunikuar përkatësisht palës së paditur ZQRPP-së Tiranë<sup>98</sup> dhe Avokaturës së Shtetit Zyra Vendore Vlorë<sup>99</sup> dhe rezulton se nuk kanë paraqitur ankim kundër këtij vendimi, çka prezumon faktin se kanë qenë dakord me vendimin e gjykatës. Në cilësinë e provës, subjekti depozitoi vendimin nr. \*\*\*, datë 7.10.2016, vendimin nr. \*\*\*, datë 10.11.2016, për pranimin e ankimit të ZVRPP-së Vlorë dhe vendimin nr. \*\*\* akti, datë 23.1.2019, “Për pranim rekursi”; (ii) sipas subjektit autorizimi është vendosur gabimisht nga sekretarja gjyqësore M. M. gjatë administrimit të dosjes, pasi edhe çështja me palë paditëse F. K. është gjykuar prej saj si gjyqtare me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2015. Administrata gjyqësore ka qenë e emëruar rishtazi dhe nuk ishte e trajnuar për t’ju përgjigjur në mënyrë profesionale ngarkesës që ka pasur gjykata; (iii) për sa i përket faktit se rezultojnë dy procesverbale të datës 19.2.2015 me përmbajtje të ndryshme, subjekti deklaroi se në dosjen e dorëzuar në sekretarinë gjyqësore rezulton se ekziston vetëm një procesverbal i datës 19.2.2015, ku është pasqyruar mosprezenca e palës së paditur ZVRPP Vlorë dhe është i vetmi procesverbal i mbajtur për seancën gjyqësore të datës 19.2.2015, ekzistenca e një procesverbali fotokopje ku rezulton se pala e paditur ZVRPP-ja Vlorë është prezente në seancën e datës 19.2.2015, nuk tregon se janë mbajtur dy procesverbale të ndryshme për të njëjtën seancë. I vetmi procesverbal origjinal i nënshkruar nga subjekti dhe sekretarja gjyqësore është procesverbal i ndodhur në dosjen gjyqësore; (iv) është e vërtetë se mungon procesverbal i datës 12.2.2015, por kjo ka ndodhur jo sepse nuk është zhvilluar seanca, por sepse sekretarja gjyqësore gabimisht ka harruar ta printojë për shkak të ngarkesës së madhe në atë ditë (16 seanca gjyqësore) dhe subjekti për shkak të ngarkesës së madhe nuk e ka vënë mungesën në listim; (v) rezulton se dosja gjyqësore është dorëzuar ditën e 11-të, pra vetëm 4 ditë me vonesë dhe kjo vonesë vjen si shkak i volumit të madh të çështjeve. Nuk rezulton se ka ardhur ndonjë pasojë si në aspektin material (zgjidhjes në themel të çështjes) ashtu edhe në atë procedural.

262. Subjekti deklaroi se prej momentit që është emëruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë ka gjykuar një numër shumë të lartë dosjesh gjyqësore, kjo gjykatë është evidentuar dhe nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë për ngarkesë shumë të lartë. Vetëm për 6-mujorin e dytë të vitit 2014, subjekti deklaroi se ka gjykuar me vendim përfundimtar 466 çështje administrative, duke mos përfshirë këtu edhe vendimet e pranimit ose

---

<sup>98</sup>Në datën 3.3.2015, vërtetuar nga dëftesa e komunikimit me nr. \*\*\* akti dhe për këtë vendim kjo palë ka marrë dijeni në datën 16.3.2015.

<sup>99</sup>Ka marrë dijeni për vendimin nr. \*\*\*, datë 19.2.2015, në datën 13.3.2015, vërtetuar nga dëftesa e komunikimit me nr. \*\*\* akti, datë 3.3.2015.

mospranimit të ankimit për çdo vendim të dhënë. Kjo ngarkesë shumë e lartë ka vijuar dhe në vitin 2015, ku ka gjykuar 770 çështje administrative, duke mos përfshirë këtu edhe vendimet e pranimit ose mospranimit të ankimit për çdo vendim të dhënë, numër ky shumë i lartë për t'u gjykuar objektivisht nga një gjyqtar, duke pasur parasysh që gjykimi në Gjykatën Administrative duhet të përfundojë brenda një afati të shkurtër dhe të dorëzohet i arsyetuar po brenda një afati të shkurtër, ndërkohë që nga KLD-ja është pranuar se ngarkesa mesatare për çdo gjyqtar është 150 çështje gjyqësore dhe jo 770 çështje. Në cilësinë e provës, subjekti depozitoi vërtetimin e datës 29.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

**263. Arsyetimi i Komisionit** – neni 74 i ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ligj tek i cili bazohet edhe vlerësimi profesional për efekt të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në republikën e Shqipërisë”, në pikat 2 dhe 3 citohet se: *“Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor. [...] Në rastin e gjyqtarit, aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u bazuar në treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit. [...] Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore ose të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes”*.

264. Në rastin e analizuar nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit në rastin konkret ka shfaqur aftësi jo të mira organizative pasi rezulton: (i) mospërputhje e plotë midis fakteve të pasqyruara në procesverbalin e seancës së shpalljes së vendimit dhe atyre të pasqyruara në vendimin e arsyetuar dhe të zbardhur, të administruar në dosjen gjyqësore; (ii) subjekti edhe pasi ka rënë në dijeni të gabimit material në vendim nuk rezulton që ta ketë korrigjuar kryesisht atë, sipas parashikimeve të nenit 312 të Kodit të Procedurës Civile; (iii) në vendim paraqiten të dhëna të pasakta nëpërmjet referimit në akte shkresore që nuk kanë lidhje me çështjen objekt gjykimi; (iv) dy procesverbale me të dhëna të kundërta lidhur me prezencën e ZVRPP-së Vlorë në seancën e dhënies së vendimit, datë 19.2.2015; (v) nuk është mbajtur procesverbal për seancën e pazhvilluar të datës 12.2.2014, e cila ishte planifikuar për diskutimet përfundimtare të palëve, në kundërshtim me parashikimet e nenit 118 të Kodit të Procedurës Civile; (vi) vendimi i arsyetuar së bashku me dosjen gjyqësore janë dorëzuar në sekretarinë gjyqësore datë 2.3.2015, pas 11 ditësh, pra 4 ditë jashtë afatit të parashikuar nga neni 42/3 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar sipas të cilit: *“Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore”*.

265. Për më tepër, që nga hetimi dhe shqyrtimi i kësaj çështjeje rezulton se është shkelur e drejta e njëjës palë për të ankimuar vendimin e marrë, duke qenë në kushtet e mosnjoftimit nga ana e gjykatës. Pra, mospasqyrimi i saktë në vendim i prezencës së ZVRPP-së Vlorë ka bërë që vendimi të marrë formë të prerë pa u njoftuar kjo palë, me pasojë humbjen e së drejtës kushtetuese dhe ligjore për ushtrimin e ankimit.

266.Pretendimit të subjektit,, në tërësi në lidhje me gjetjet e Komisionit, nuk janë bindëse dhe nuk provojnë të kundërtën e rezultateve të hetimit.

267.**Si përfundim**, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka aftësi të mira organizative dhe ka shkelur të drejtën e palës për t'u ankuar ndaj këtij vendimi me pasoja në kohë për palën, duke u gjendur në kushtet e pikave 2, 3 dhe 5, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

268.**Në vijim të hetimit**, Komisioni kërkoi informacion pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor<sup>100</sup>, në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masave disiplinore të marra ndaj saj, nga periudha 2006 e deri më sot. Pas administrimit të shkresës nr. \*\*\* prot., datë 24.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, rezultoi se ndaj subjektit Gentiana Xhelili janë depozituar 26 ankesa. Komisioni vëren problematika në ankesat e mëposhtme:

269.Lidhur me ankesën e Komunës Livadhja, e cila ankohet për mosrespektim formal të ligjit dhe zvarritje të gjykimit nga subjekti i rivlerësimit në shqyrtimin e çështjes civile me objekt “Pavlefshmëri të pjesshme të vendimit të ish-KKKP-së Sarandë ...”. Ankuesi pretendon se kjo çështje është zvarritur pambarimisht, nuk është miratuar masa e sigurimit të padisë, si dhe është vendosur shpallja e moskompetencës me qëllim zvarritjen e gjykimit të çështjes. Pas analizimit, Komisioni konstatoi se: (i) ka zvarritje të procesit gjyqësor, çështja ka zgjatur 1 vit e 2 muaj, në tejkalim të afatit të parashikuar nga germa “e”, e nenit 5, të vendimit të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”, ku afati i parashikuar për këto këtë kategori çështjesh është 6 muaj; (ii) shpallja e moskompetencës nga subjekti me vendimin përfundimtar jo themeli nr. \*\*\*, datë 24.1.2014, ka ndikuar në zvarritjen e procesit gjyqësor; (iii) subjekti nuk ka respektuar afatin ligjor për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë. Kjo kërkesë ka qenë pjesë e objektit të padisë dhe subjekti e ka shqyrtuar në seancën e datës 6.3.2013, pas 3 muajsh e 12 ditë, ndërkohë që afati për shqyrtimin e kërkesës për sigurimin e padisë, i parashikuar në nenin 202 të Kodit të Procedurës Civile është 5 ditë; (iv) organizimi dhe planifikimi i dobët i punës nga subjekti kanë ndikuar në zvarritje të gjykimit dhe mosrespektim formal të ligjit.

270.**Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se:** (i) rezultoi se kjo çështje është regjistruar në datën 5.11.2012 dhe i ka rënë për gjykim gjyqtarit E. P., kërkimi për sigurim padie ka qenë në objektin e padisë që me paraqitjen e kërkesëpadisë dhe ishte detyrim i këtij gjyqtari të shprehej për kërkimin e masës së sigurimit të padisë, ndërkohë që pas 17 ditësh ai ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi. Kjo çështje është rishortuar në datën 22.11.2012 dhe i është caktuar subjektit Gentiana Xhelili. Është urdhëruar caktimi i seancës për veprimet përgatitore në datën 19.12.2012 dhe subjekti pasi ka verifikuar prezencën e palëve dhe ka marrë shpjegimet e tyre ka rënë në dijeni se masa e sigurimit të padisë nuk ishte shqyrtuar dhe e ka pyetur palën paditëse nëse i qëndronte kërkesës për sigurim padie. Pala paditëse, nëpërmjet përfaqësuesit të saj, ka deklaruar se kërkon që gjykata të shprehet në seancë gjyqësore lidhur me masën e sigurimit të padisë, pasi të sjellë provat që e legjitimojnë këtë kërkim. Në cilësinë e provës, subjekti ka dorëzuar kopje të procesverbalit të veprimeve përgatitore, ku pala paditëse shpreh vullnetin që kërkesa për sigurim padie të merret në shqyrtim në seancë gjyqësore<sup>101</sup>. Në

<sup>100</sup>Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 11.12.2020.

<sup>101</sup>Seanca e parë gjyqësore është zhvilluar në datën 10.1.2013 dhe është shtyrë me kërkesë të vetë palës paditëse, e cila nëse do të kishte qenë urgjente shqyrtimi i kërkesës për sigurim padie do të ishte paraqitur në gjykim. Dy seancat e radhës janë

seancë gjyqësore është kërkuar nga pala paditëse që gjykata të shprehet lidhur me kërkesën e sigurimit të padisë dhe gjykata me vendim ka vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë. Subjekti deklaroi se është në disponibilitetin e palës paditëse për të kërkuar në çdo fazë të gjykimit marrjen e masës së sigurimit të padisë dhe në momentin që e ka kërkuar dhe ka menduar se duhet të merret masa e sigurimit të padisë gjykata ka disponuar me vendim; (ii) subjekti pretendon se shpallja e moskompetencës nuk ka ndikuar në zvarritjen e gjykimit pasi kompetenca e një gjykate përbën një parim të rëndësishëm të procesit të rregullt gjyqësor. Hyrja në fuqi e ligjit nr. 49/2012 solli një konfuzion në gjithë trupën gjyqësore lidhur me kompetencën lëndore të Gjykatës Administrative për kundërshtimin e vendimeve të Komisionit të Pronave. Vendimi unifikues nr. \*\*\*, datë 10.12.2013, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili ka përcaktuar se: *“Kur në objektin e gjykimit kundërshtohet vendimi i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave apo Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, kjo çështje do të konsiderohet si mosmarrëveshje civile dhe do të shqyrtohet nga gjykata që ka kompetencë gjykimin e mosmarrëveshjeve civile”* është botuar në Fletoren Zyrtare në mars të vitit 2014, pra pas dy muajsh pasi subjekti kishte shpallur moskompetencën; (iii) subjekti deklaroi se në asnjë prej seancave gjyqësore, përveç seancës së datës 17.1.2013, (që gjykimi është shtyrë për arsye shëndetësore), nuk është shtyrë për shkakun e tij, por për shkak të kërkesave të palës paditëse dhe për shkak të kompleksitetit të çështjes. Nëse do të analizojmë historikun se si ka vijuar gjykimi i kësaj çështjeje rezultoi se pala paditëse Komuna L. ka qenë ajo që ka zvarritur gjykimin, pasi ka iniciuar një gjykim për të cilin pas 3 vjetësh pasi i është drejtuar gjykatës me kërkesëpadi ka bërë kërkesë për heqje dorë nga gjykimi. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti vendimin nr. \*\*\*, datë 6.5.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, ku është vendosur pushimi i gjykimit të çështjes civile, pasi Komuna L. ka kërkuar pushimin e gjykimit, pas 1 viti që çështja ishte regjistruar.

**271. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – neni 74 i ligjit për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, ligj tek i cili bazohet dhe vlerësimi profesional për efekt të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*, në pikat 2 dhe 3 citohet se: *“Aftësia për të përballuar ngarkesën e punës matet duke u bazuar në treguesit për respektimin e afateve ligjore, plotësimin e standardeve minimale kohore, kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore dhe kohën mesatare për marrjen e vendimit përfundimtar gjyqësor. [...] Në rastin e gjyqtarit, aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore matet duke u bazuar në treguesit për numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje, kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, për shmangien e seancave gjyqësore joproduktive, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e dërgimit pa vonesë të akteve të nevojshme të njoftimit. [...] Aftësia për të administruar dosjet gjyqësore ose të prokurorisë matet duke u bazuar në treguesit e rregullshmërisë, plotësisë dhe saktësisë së dokumentacionit të dosjes”*.

272. Pas analizimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura evidentohet se çështja paraqitet mjaft komplekse dhe bëhej fjalë për shfuqizimin e shumë vendimeve të Komisionit të Kthimit

---

shtyrë për shkaqe shëndetësore dhe përfaqësuesi i palës paditëse ka qenë dakord dhe përsëri nuk ka kërkuar që të shqyrtohet kërkesa për sigurim padie. Seanca e radhës e datës 21.2.2013 nuk është zhvilluar pasi përfaqësuesi i palës paditëse ka kërkuar vetë të shtyhet gjykimi. Nga provat e administruara në këtë gjykim nuk rezultoi se pala paditëse të ketë kërkuar dhe ripërsëritur kërkesën për sigurim padie edhe pse ka qenë prezent.



të Kompensimit të Pronave që kishin kthyer në natyrë një sip. 124 ha pyll dhe 273 ha kullotë. Në seancën e datës 17.1.2013 rezulton se gjykimi është shtyrë për arsye shëndetësore të subjektit, ndërsa seancat e tjera nuk pasqyrohen saktë në procesverbale se përse janë shtyrë.

273. Lidhur me kërkimin për sigurim padie rezulton se pala paditëse nëpërmjet përfaqësuesit të saj ka deklaruar se kërkon që gjykata të shprehet në seancë gjyqësore për masën e sigurimit të padisë, pasi të sjellin provat që e legjitimojnë këtë kërkim, provuar kjo me procesverbalin e seancës së datës 19.12.2012. Komisioni vëren se në procesverbal, gjykata, bazuar në nenin 125, ka vendosur të shprehet për kërkesën e sigurimit të padisë në seancë gjyqësore, kur palët e paditura të sjellin provat.

274. Më tej, Komisioni vlerëson se shpallja e moskompetencës nga subjekti me vendimin përfundimtar jo themeli nr. \*\*\*, datë 24.1.2014, ka ndikuar në zvarritjen e procesit gjyqësor. Kjo zvarritje e gjykimit ka ardhur si rezultat i mosorganizimit të punës nga subjekti duke u gjendur në kushtet e pikave 2, 3 dhe 5, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

275. Lidhur me ankesën e Bashkisë Konispol, e cila ankohet ndaj veprimtarisë gjyqësore të subjektit dhe zvarritje të qëllimshme të gjykimit në shqyrtimin e çështjes civile me objekt “anulimin e vendimit nr. ...”, si dhe shpalljen e moskompetencës me qëllim zvarritjen e gjykimit të çështjes. Pas analizimit, Komisioni konstatoi se *gjykimi i çështjes ka zgjatur në periudhën kohore prej 1 vit, 2 muaj e 29 ditë, tej afatit 1-mujor të përcaktuar në germën “c”, të nenit 5, të vendimit nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, të KLD-së “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”*.

**276. Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se janë caktuar 3 seanca përgatitore, prej të cilave 2 seanca nuk janë zhvilluar, një është shtyrë nga subjekti për arsye shëndetësore dhe një për mungesën e palës paditëse. Më tej, janë caktuar 17 seancat gjyqësore dhe nga këto janë zhvilluar 10 seanca, 7 seanca nuk janë zhvilluar dhe janë shtyrë për këto shkaqe: 3 seanca janë shtyrë për njoftimin e palës së paditur, 1 seancë i padituri ka paraqitur kërkesë për shtyrje seance; 1 seancë është shtyrë me kërkesë të palës paditëse, për mungesë avokati; 1 seancë është shtyrë pasi subjekti ndodhej në testimin për gjykatën administrative dhe 1 seancë është shtyrë pasi është kërkuar përjashtimi i saj. Nuk rezulton të ketë shtyrje të seancave për shkaqe të pamotivuara, por natyra e çështjes ka qenë komplekse dhe e lidhur me shumë palë ndërgjyqëse, si dhe sjelljet e palëve në proces kanë ndikuar në kalimin e afateve të gjykimit. Lidhur me pretendimin e shpalljes së moskompetencës lëndore, subjekti analizon sa më sipër u trajtua. Në përfundim subjekti deklaron se pasi çështja është kthyer për rigjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë është gjykuar për një afat 2 vjet e 2 muaj, çka tregon se kjo çështje është shumë komplekse dhe nuk mund të gjykohej brenda afatit 6-mujor, pasi kjo gjë do të cenonte kryerjen e një hetimi të plotë dhe gjithëpërfshirës. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 11.7.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.**

**277. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultateve të hetimit mbi zvarritjen e gjykimit të kësaj çështjeje, duke u gjendur në kushtet e pikave 2, 3 dhe 5, të nenit 74, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

278.Lidhur me ankesën e shtetasit A.B., i cili ankohet se subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështjen civile me objekt “detyrimin e ZVRPP-së Sarandë të korrigjojë HTP-në për pasurinë ...”, me paditës Q. Ç., në mungesë të tij si palë e paditur, në fshehtësi dhe pa e njoftuar për zhvillimin e gjykimit. Gjithashtu, ankuesi pretendon se subjekti, në dhënien e vendimit në kundërshtim me provat, ka marrë si dëmshtëpërblim një shumë parash nga ana e paditësit. Pas analizimit, Komisioni konstaton se: (i) kjo çështje ka zgjatur për një periudhë kohore prej 8 muaj e 13 ditë, tej afatit 6-mujor për gjykimet e mosmarrëveshjeve civile të karakterit të përgjithshëm; (ii) subjekti, me anë të vendimit nr. \*\*\*, datë 24.1.2013, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, ndërkohë që Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe pushimin e gjykimit të çështjes, duke arsyetuar se kjo padi nuk mund të ngrihet.

**279.Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se:** (i) janë kryer 4 seanca përgatitore dhe 10 seanca gjyqësore, për arsye të njoftimeve. Seanca e parë e datës 11.2.2013 është shtyrë për arsye se palët e paditura nuk kanë pasur dijeni për gjykimin. Seanca e dytë e datës 27.2.2013 është shtyrë përsëri për shkak se palët e paditura nuk kanë pasur dijeni për gjykimin. Në këtë seancë është urdhëruar që palët e paditura të njoftohen me shpallje, bazuar në nenin 133 të Kodit të Procedurës Civile. Seanca e tretë e datës 18.3.2013 është shtyrë pasi një nga palët e paditura S. K. nuk kishte dijeni. Seanca e katërt e zhvilluar në datën 5.4.2013 është zhvilluar dhe është urdhëruar të kalohet në seancë gjyqësore duke ripërsëritur edhe një herë njoftimet me shpallje për palët në mungesë. Seanca gjyqësore e datës 22.4.2013 është zhvilluar, por për arsye se pala paditëse i ka pasur provat jo në formën e kërkuar nga ligji i është dhënë mundësi t’i paraqesë sipas ligjit. Seanca e datës 16.5.2013 është zhvilluar, pala paditëse ka paraqitur provat në formën e kërkuar nga ligji dhe është vijuar me caktimin e ekspertit pasi për zgjidhjen e çështjes kërkoheshin njohuri të posaçme në fushën e topografisë. Kjo seancë është shtyrë për të thirrur ekspertin. Seanca e ardhshme datë 30.5.2013 është shtyrë pasi eksperti për arsye familjare nuk mund të paraqitej dhe të merrte detyrat dhe të bënte betimin. Seanca e radhës është caktuar në datën 13.6.2013, e cila është shtyrë me kërkesë të palës paditëse për të paraqitur disa prova që nuk i kishte paraqitur. Seanca e ardhshme është caktuar më 1.7.2013 dhe pala paditëse për arsye se nuk kishte mundur t’i paraqiste provat kërkoi nëpërmjet gjykatës që t’i drejtohet zyrtarisht, bazuar në nenin 223 të Kodit të Procedurës Civile që pala e paditur Komuna F. dhe Z. Sarandë të paraqiste AMTP-në e palëve të paditura. Seanca, për t’iu drejtuar këtyre institucioneve, është shtyrë 3 herë. Në seancën e datës 20.9.2013, ekspertit i janë caktuar detyrat dhe në seancën e datës 7.10.2013 është relatuar aktekspertimi, janë administruar provat dhe është tërhequr gjykata për vendimin përfundimtar; (ii) subjekti deklaroi se fakti që ky vendim është prishur nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë nuk mund të përbëjë shkak determinant në vlerësimin profesional, ku në total rreth 90 % e vendimeve të tij janë lënë në fuqi. Ngarkesa e punës ka qenë dyfishi i ngarkesë mesatare të përcaktuar nga KLD-ja. Kështu, vetëm për gjysmën e dytë të vitit 2012 (pasi në gjysmën e parë ka qenë me lejelindje) ka gjykuar 254 çështje, ndërsa për vitin 2013 ka gjykuar 394 çështje më shumë se gjithë gjyqtarët e tjerë të kësaj gjykate. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti evidencat statistikore për vitet 2012 dhe 2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë.

280.Lidhur me ankesën e shtetasit H.M., i cili në cilësinë e palës paditëse ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor me objekt “shfuqizim akti administrativ...”. Pas analizimit, Komisioni

konstatoi se: (i) çështja me objekt “shfuqizim akti administrativ...”, ka zgjatur tej afatit 1-mujor të përcaktuar në germën “c”, të nenit 5, të vendimit nr. \*\*\*, datë 14.4.2010, të KLD-së, “Mbi kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”; (ii) çështja me objekt “sigurim padie” është shqyrtuar 3 ditë me vonesë, jashtë afatit 5-ditor; (iii) duket se organizimi jo i mirë i punës nga subjekti, ka ndikuar në zvarritje të gjykimit.

**281.Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se:** (i) lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit, subjekti referon ngarkesë të lartë në punë dhe përmend faktin se në vitin 2015 ka përfunduar me vendim përfundimtar 770 dosje gjyqësore, tej mesatares prej 150 dosje të parashikuar nga KLD-ja. Dosja gjyqësore është hedhur në short në datën 14.7.2014, vetëm një ditë më pas, në datën 15.7.2014, janë kryer veprimet paraprake për çështjen, duke u caktuar në datën 22.7.2014 seanca e veprimeve përgatitore, ku gjykata mori në shqyrtim edhe kërkesën për sigurim padie të palës paditëse duke vendosur rrëzimin e kësaj kërkesë. Në intervalin kohor 22.7.2014 – 9.9.2014 është caktuar seanca e radhës pasi në muajin gusht gjyqtarët janë me leje vjetore. Në datën 9.9.2014 është zhvilluar seanca e veprimeve përgatitore, ku kanë marrë dijëni të gjitha palët ndërgjyqëse dhe është caktuar eksperti, për të cilët palët nuk kanë pasur kundërshtime. Në seancën gjyqësore të datës 23.9.2014 janë caktuar pyetjet për ekspertin topografe. Seanca e datës 9.10.2014 është shtyrë, pasi personi i tretë shoqëria “\*\*\*” nuk ka pasur dijëni. Edhe në seancën e datës 24.10.2014 kjo palë nuk ka pasur dijëni. Në këtë seancë është kërkuar edhe përjashtimi i subjektit dhe është vendosur pezullimi i gjykimit deri sa të shprehej një gjyqtar tjetër për këtë kërkesë. Në datën 4.12.2014 ka rifilluar përsëri gjykimi dhe nuk është pranuar kërkesa për përjashtim. Kjo seancë është shtyrë pasi palët ndërgjyqëse nuk kishin dijëni. Seanca e ardhshme e datës 22.12.2014 është shtyrë përsëri pasi palët nuk kishin marrë dijëni, po kështu, edhe seancat e datave 16.1.2015, 13.2.2015, 16.3.2015 dhe 20.4.2015, pasi nga QKR-ja nuk vinin konfirmimet për shpalljen për shoqërinë “\*\*\*”. Këto seanca janë shtyrë në zbatim të parimit kryesor, procesit të rregullt gjyqësor që ka të bëjë me dijëninë e palëve që ndaj tyre zhvillohet një proces gjyqësor nga i cili mund t’i cenohen interesa pasurore ose jopasurore. Seanca e datës 19.5.2015 është zhvilluar, por pala paditëse ka bërë kërkesë për zëvendësimin e ekspertes pasi nuk kishin besim dhe gjykata e ka pranuar kërkesën duke e zëvendësuar me një eksperte tjetër. Ekspertja tjetër për shkaqe shëndetësore është zëvendësuar. Me vendim është caktuar ekspertja T.J., e cila nuk ka qenë korrekte me detyrat e gjykatës dhe, për këtë arsye, është vendosur përsëri revokimi i saj duke u caktuar eksperti inxhinier urbanist E. K. Ky ekspert është caktuar në seancën e datës 23.7.2015 dhe seanca e ardhshme është caktuar pas pushimeve vjetore në datën 9.9.2015. Në seancën e datës 9.9.2015, eksperti ka marrë detyrat dhe seanca e radhës për kryerjen e aktekspertimit është caktuar data 29.9.2015. Në datën 29.9.2015 është kryer aktekspertimi dhe është relatuar ky akt.

Meqenëse pala e paditur Bashkia Fier nuk ishte prezent, gjykata i ka komunikuar një kopje të aktekspertimit. Seanca e radhës është caktuar data 9.10.2015, pas 10 ditësh dhe në këtë seancë janë administruar provat, i është dhënë fund hetimit gjyqësor dhe janë ftuar palët të japin pretendimet përfundimtare. Palët kanë kërkuar kohë të japin pretendime përfundimtare dhe për shkak të natyrës së çështjes gjykata u ka lënë afat deri në datën 13.10.2015, pra vetëm pas 4 ditësh. Në seancën e datës 13.10.2015, gjykata ka marrë pretendimet përfundimtare dhe bazuar në nenin 42 të ligjit nr. 49/2012, ka shtyrë shpalljen e vendimit të arsyetuar për shkak të kompleksitetit të çështjes brenda 5 ditëve siç parashikon ligji. Në datën 16.10.2015 është

shpallur vendimi dhe është vendosur rrëzimi i kërkesëpadisë; (ii) pretendimi se masa e sigurimit të padisë është shqyrtuar tri ditë me vonesë nuk qëndron, pasi dosja është marrë nga kryesekretarja në datën 15.7.2014 dhe seanca për të shqyrtuar kërkesën për sigurim padie është caktuar më 22.7.2014, pasi në llogaritje janë dhe dita e shtunë dhe e diel që është pushim, pra nuk është shqyrtuar tri ditë me vonesë, por 1 ditë me vonesë dhe kjo një ditë nuk përbën një cenim të së drejtës së paditësit duke marrë parasysh edhe ngarkesën që kisha unë si gjyqtare në vitin 2014.

**282. Arsyetimi ligjor i Komisionit** – Rezulton se në asnjë rast gjykimi nuk është shtyrë për shkak të subjektit. Zvarritja më së shumti ka qenë nga mosmarrja dijeni e palëve ndërgjyqëse dhe nga kërkesat e palës paditëse, si dhe zëvendësimi i ekspertëve, i cili ka qenë për arsye të justifikuar. Gjithashtu, në seancën e datës 24.10.2014 është kërkuar përjashtimi i subjektit dhe është vendosur pezullimi i gjykimit deri sa të shprehej një gjyqtar tjetër për këtë kërkesë. Gjykimi ka rifilluar përsëri në datën 4.12.2014, pasi nuk ishte pranuar kërkesa për përjashtim. Ky afat llogaritet në zgjatjen e gjykimit dhe nuk vjen si pasojë e subjektit. Lidhur me shqyrtimin e masës së sigurimit subjekti shpjegoi bindshëm se nuk është shqyrtuar tri ditë me vonesë, por 1 ditë me vonesë dhe kjo një ditë nuk përbën cenim të së drejtës së paditësit duke marrë në konsideratë ngarkesën e subjektit.

**283. Në përfundim**, Komisioni vëren se vetë pala paditëse që ankohet për zvarritje të gjykimit, në Gjykatën e Apelit Administrativ, me anë të kërkesës datë 23.5.2018, ka kërkuar të heqë dorë nga gjykimi i ankimit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. \*\*\*, datë 16.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.5.2018, ka vendosur të pushohet gjykimi duke marrë kështu formë të prerë vendimi i subjektit.

284. Lidhur me ankesën e shtetasit A.M., i cili ngre pretendime mbi formimin e gabuar të ndërgjyqësisë nga subjekti, duke çuar në zgjidhjen e gabuar të çështjes në procesin gjyqësor me objekt “detyrimin e ZVRPP-së Vlorë të bëjë korrigjimet e certifikatave të pronësisë së kartelave të pasurisë për pasuritë ...”. Pas analizimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 12.10.2015, Komisioni vëren se paditësi duhet të kishte ezauruar rrugët administrative pranë ZVRPP-së Vlorë dhe më pas të investonte gjykatën. Gjithashtu, nga vendimi nuk rezulton të jenë administruar deklaratat e kufitarëve. Për sa rezultoi, subjektit iu kërkua të paraqesë prova dhe shpjegime për sa konstatohet, si dhe ecurinë e mëtejshme të këtij gjykimi në shkallë të dytë.

285. Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se Kodi i Procedurës Civile parashikon në nenin 161 të tij se ndërgjyqësia krijohet nga pala paditëse dhe jo nga gjykata. Vetëm me ndryshimet e reja në Kodin e Procedurës Civile në vitin 2017 është parashikuar se kur është e nevojshme bashkëndërgjyqësia e detyrueshme, i lihet afat palës paditëse që ta rregullojë atë, në të kundërt gjykata vendos pushimin e gjykimit. Në rastin konkret, në seancën gjyqësore të datës 6.7.2015, pala paditëse ka kërkuar të shtojë si palë të paditur shtetasin S. M. në vend të të cilit kanë hyrë me zëvendësim shtetasit L. M. dhe M. M. Nga aktekspertimi rezulton se me regjistrimin e pasurisë, fituar me AMTP nga dy të paditurit kërkohej korrigjimi i certifikatës së pronësisë së palës paditëse. Sa për administrimin e deklaratave të kufitarëve, nga vendimi nr. \*\*\*, datë 12.10.2015, në faqen nr. \*\*\*, paragrafi \*\*\*, citohet se “rezulton se për këtë pasuri kanë deklaruar në deklaratën noteriale datë 23.8.2014 edhe palët e paditura kufitarët veriorë dhe

jugorë L. dhe M. M. se njohin si pronar të ligjshëm të pasurisë me nr. \*\*\* shtetasin P. M. Pra janë administruar në gjykim këto deklarata të kufitarëve veriorë dhe jugorë. Nga dosja e tërhequr rezulton se mbi ankimin e palës së paditur, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 31.1.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 123.10.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se paditësi nuk i është drejtuar më parë ZVRPP-së Vlorë me kërkesë për korrigjimin e certifikatës së pronësisë duke përmendur nenin 63 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Ky vendim është ankimuar dhe aktualisht ndodhet në Gjykatën e Lartë.

286. Subjekti deklaron se qëndrimi i Gjykatës Administrative është i gabuar sepse paditësi legjitimohet të kërkojë korrigjimin e certifikatës së pronësisë pasi nuk është para rastit që ka cituar Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, sipas nenit 63 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Kjo pasi paditësi pretendon për saktësim kufijsh, kërkim i cili zgjidhet vetëm nga gjykata duke thirrur kufitarët dhe ZVRPP-ja nuk ka kompetencë të korrigjojë certifikatat e pronësisë duke saktësuar kufijtë, por vetëm gabimet materiale të certifikatave që nuk cenojnë interesat e personave të tjerë.

287. **Arsyetimi ligjor i Komisionit** – subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se gjatë këtij gjykimi është administruar deklarata noteriale e datës 23.8.2014 nga kufitarët veriorë dhe jugorë. Ndërkohë pretendimet e tjera lidhen me zgjidhjen në themel të çështjes dhe që janë objekt shqyrtimi nga një gjykatë më e lartë.

### **Konkluzioni përfundimtar në lidhje me vlerësimin profesional**

288. Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit, ka mangësi në drejtim të aftësive organizative si: për të përballuar ngarkesën e punës; plotësimin e standardeve minimale kohore; kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje në rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore; moskryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor; për mosshmangien e seancave gjyqësore joproductive; për të mos miradministruar dosjet gjyqësore duke u bazuar në rregullshmërinë, plotësinë dhe saktësinë e dokumentacionit të dosjes, ka aftësi minimale kualifikuese. Mangësitë e konstatuara më lart, Komisioni vlerëson se nuk mund të ngrihen në nivelin e shkarkimit sipas pikës 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, por duhen marrë në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes, duke u gjendur në kushtet e pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

### **DENONCIME NGA PUBLIKU**

289. Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Gentiana Xhelili, janë administruar 12 denoncime nga publiku. Në 6 prej këtyre denoncimeve ngrihen pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta dhe nuk përmbanin fakte apo rrethana që mund të përbënin prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit të subjektit, respektivisht: (1) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017, i shtetasit M. Xh., i cili ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë, gjykim të njëanshëm dhe korrupsion nga subjekti i rivlerësimit; (2) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2018, i shtetasit F. M., i cili denoncon 13 subjekte rivlerësimi ndër ta përmendet edhe subjekti; (3) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2018, i shtetasit Dh. Ç., i cili ankohet për

dhënien e një vendimi të padrejtë, favorizim të palës kundërshtare nga subjekti i rivlerësimit; (4) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 15.10.2018, i shtetasit A. K., për dhënien e një vendimi të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit, gjë që ka sjellë pasoja financiare për denoncuesin; (5) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 9.3.2020, i shtetasve Zh. dhe T. K., nuk ngre asnjë pretendim ndaj subjektit Gentiana Xhelili, po ndaj disa subjekteve të tjera të rivlerësimit; (6) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2020, i Bashkisë Roskovec nuk ngre asnjë pretendim ndaj subjektit Gentiana Xhelili, po ndaj subjektit B. Sh.

**290.Në përfundim**, Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe me themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalia e fundit, e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 72, të ligjit nr. 96/2016. Në këto kushte, në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

291.Ndërkohë në 5 nga denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kërkoi shpjegime apo prova pasi konstatoi se kohëzgjatja e gjykimit është jashtë standardit kohor 1-mujor të parashikuar në germen “c”, të pikës 5, të Aneksit 1, të Sistemit të Vlerësimit, respektivisht: (1) denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.2.2018, të shtetasit Ll. M., i cili ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë, zvarritje dhe mungesë etike në gjykim nga subjekti i rivlerësimit; (2) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2018, i shtetas L. R., e cila ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë dhe për aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit; (3) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2019, i shtetas N. K., e cila ankohet për zvarritje të procesit gjyqësor, si dhe nuk e ka lejuar denoncuesen të paraqesë argumentet dhe provat e nevojshme në gjykim; (4) denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2019, i shtetas F. Rr., e cila ankohet për gjykim të padrejtë nga subjekti i rivlerësimit.

292.Pasi u analizuan shpjegimet dhe provat e paraqitura nga subjekti, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimit tej afatit standard nuk ka ardhur si rezultat i mosorganizimit të mirë të punës nga subjekti, si dhe nuk rezultoi të ketë shtyrje të seancave për shkaqe të pamotivuara. Konstatohet se me ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Civile, në nenin 399/2, përcaktohen afatet e arsyeshme të gjykimit, si dhe kriteret që duhet të mbahen parasysh për të konkluduar nëse janë respektuar apo jo. Bazuar në nenin 399/1, afate të arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit apo ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, do të konsiderohen në gjykimin administrativ në shkallën e parë dhe në apel, përfundimi i gjykimit brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë. Për sa rezultoi, këto denoncime nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriteret e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

293.Më tej, Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 19.2.2021, të shtetas R. Sh., e cila ankohet se është diskriminuar nga subjekti i vlerësimit gjatë ushtrimit të detyrës si zëvendëskryetare e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë. Sipas denoncueses, subjekti, në kushtet e presionit psikologjik, e ka detyruar të firmosë kërkesën për dorëheqje nga puna.

294. Subjekti paraqiti shpjegimet, duke sqaruar se shtetasja R. Sh. ka dhënë dorëheqjen nga puna pasi është kapur në flagrancë duke shpërdoruar detyrën dhe duke ndërhyrë në sistemin kompjuterik të sistemit të menaxhimit të gjykatës. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka ngritur kallëzimin penal nr. \*\*\* prot., datë 25.11.2020, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë. Aktualisht kjo çështje është duke u hetuar nga kjo prokurori dhe gjykata është në pritje që të zgjidhet me vendim përfundimtar të formës së prerë dhe më pas do të ndjekë procedurat ligjore edhe për kërkimin e dëmit civil për cenimin e imazhit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë<sup>102</sup>.

295. **Në përfundim**, Komisioni konstaton se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se ky denoncim nuk përmban fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

296. Mbështetur në konkluzionet e mësipërme, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, në kuptim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe nga vlerësimi tërësor në kuptim të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti, i rivlerësimit me anë të mangësive të gjetura në vlerësimin profesional, ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

## KONKLUZION PËRFUNDIMTAR

297. Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, vendosi që subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

## PËR KËTO ARSYE,

298. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neneve Ç, D, dhe Ë, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, si dhe në pikat 3 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

---

<sup>102</sup>Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, ku bëhet me dije se shtetasja R. Sh. është marrë në cilësinë e të pandehurës dhe i është njoftuar akuza për veprën penale të parashikuar nga neni 186/a i Kodit të Procedurës Civile për këto veprime. Procesverbalin me nr. \*\*\* prot., datë 23.7.2020 kërkesën për dorëheqje datë 23.7.2020, vendimi nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2020, shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2020, drejtuar KL Gj-së, urdhër nr. \*\*\* prot., datë 26.10.2020, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2020, drejtuar kancelares; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2020, e kancelares së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 19.11.2020, e kryesekretares së Gjykatës, kallëzim penal datë 25.11.2020, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, vërtetimi nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë.

## **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Gentiana Xhelili, gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 21.4.2021.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Pamela QIRKO**

**Kryesuese**

**Etleda ÇIFTJA**

**Relatore**

**Roland ILIA**

**Anëtar**

*Sekretare gjyqësore*

*Olsida Goxhaj*